



# EFEKTET SOCIALE DHE EKONOMIKE TË KOVID-19 NDAJ FËMIJËVE NË MAQEDONINË E VERIUT

Analizë e Përsheptuar dhe Propozime për  
Zhvillim të Politikave



**USAID**  
NGA POPULLI AMERIKAN

**FINANCE** **THINK**  
OUT OF THE BOX

**unicef**   
for every child


Studimi është realizuar në kuadër marrëveshjes për ofrim të shërbimeve midis Finance Think dhe Zyrës së UNICEF-it në Shkup. Konstatimet e shprehura në studim janë të autorëve dhe jo domosdoshmërisht e paraqesin qëndrimin e UNICEF-it.

Ky publikim është prodhuar nga Finance Think me mbështetje e popullit Amerikan përmes Agjencionit për Zhvillim Ndërkombëtar të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (USAID). Pikëpamjet e autorëve të shprehura në këtë publikim nuk reflektojnë medoemos pikëpamjet e Agjencionit për Zhvillim Ndërkombëtar të Shteteve të Bashkuara apo të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.



# PIKAT KRYESORE





**1. Kovid-19 e ka ashpërsuar varfërinë e fëmijëve të Maqedoninë e Veriut, madje ka të ngjarë t'i ketë vënë 16,000 fëmijë nën pragun e varfërisë.** Kjo është në përpjesëtim me një rritje të shkallës së varfërisë së fëmijëve nga 29.3 për qind në 33.3 për qind, një shkallë që nuk vërehet në vend, për shkak se Hulumtimi për të ardhurave dhe kushteve të jetesës është realizuar për herë të parë në vitin 2010. Rritja e parashikuar është më e fortë se ajo e vërejtur gjatë krizës globale të viteve 2009 dhe 2010.

Pjesa 3.3

**2. Efekti në rritje i varfërisë si rezultat i Kovid-19 është më i fuqishmi në mesin e fëmijëve që jetojnë në amvisëri me 3 ose më shumë fëmijë dhe ku është i ulët niveli arsimor i anëtarëve të rriturve,** pa dallime të rëndësishme në gjini dhe moshë.

Pjesa 3.3

**3. Varfëria e të ardhurave të fëmijëve është e kombinuar me ekzistimin e privimeve tjera materiale të amvisërive,** si qasja e pamjaftueshme në internet dhe kushtet e dobëta të strehimit, të cilat mund të jenë veçanërisht të rëndësishme për progresin e fëmijëve në mësim gjatë kohës së mbylljes shkollave dhe kufizimeve në lëvizje. Dobësitë e tilla janë veçanërisht të dukshme në mesin e fëmijëve romë.

Pjesa 3.4

**4. Fëmijët më të varfër mund të vuajnë më shumë gjatë pandemisë së Kovid-19, për shkak të efekteve të dominuara të reziqeve të shumëfishta dhe disavantazheve,** siç janë mungesa e ushqimit dhe rrëgjimi; ndjekja e ulët e edukimit parashkollor; dështimet në përvetësimin e aftësive themelore mësimore; qasja e kufizuar në hapësirat sanitare; dhe mbështetja më e madhe në karburantet ndotëse për gatimin dhe ngrohjen e amvisërisë.

Pjesa 3.4

**5. Fëmijët që jetojnë në amvisëritë me vetëm njërin prind dhe në amvisëritë, të cilat marrin ndihmë minimale të garantuar përballen me rezik të shtuar të varfërisë si rezultat i mungesës së ushqimit,** mes tjerash si rezultat i ndërprerjes së vakteve falas për shkak të mbylljes së institucioneve parashkollore dhe shkollave në përgjithësi. Njashtu mbyllja e qendrave të kujdesit ditor dhe kufizimet në lëvizje të ofruesve të kujdesit e përkeqësuan cilësinë e kujdesit për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Pjesa 3.1



**6. Dhuna në familje është rritur gjatë Kovid-19, me ç'rast fëmijët paraqesin afro 10 për qind të viktimave.** Rastet e dhunës nga bashkëmoshatarët janë raportuar në mesin e fëmijëve nën përkujdesje. Ata me sa duket kanë pësuar dhunë të rritur nga bashkëmoshatarët gjatë Kovid-19. Për shkak të bllokimeve të kufizimeve të lëvizjes, është rritur shkelja e së drejtës së fëmijëve për të kaluar kohë më prindin me të cilët ata nuk jetojnë.

Pjesa 3.1

**7. Masat e qeverisë ndaj Kovid-19, siç janë masat e ruajtjes së vendeve të punës, relaksimi i kritereve të ndihmës sociale, mbështetja financiare e njëhershme dhe zbutja e rasteve të varfërisë të fëmijët dhe të gjithë masat që janë në favor të fëmijëve.** Edhe pse të gjitha janë në favor të fëmijëve, megjithatë kanë tendencë të shpërndajnë një pjesë proporcionale më të madhe të fondeve në amvisëritë me fëmijët. Sidoqoftë, asnjë nga masat nuk është krijuar për t'i synuar drejtpërdrejt fëmijët, andaj efektet ndaj fëmijëve janë kryesisht të dirigjuara nga struktura e amvisërisë dhe ndërlidhja me të ardhurat e amvisërisë.

Pjesa 2.1

**8. Efekti më i fortë në favor të fëmijëve qëndron me kriteret e relaksuara për marrjen e të ardhurave minimale të garantuara.** Sidoqoftë, pagesat shtesë në prill dhe maj 2020 janë të papërfillshme në krahasim me potencialin teorik të masës, gjë që bën me dije së përpjekja për të arritur të më të prekur nga pandemia ka qenë e pamjaftueshme.

Pjesa 2.1

Pjesa 3.2

**9. Programet buxhetore që kanë të bëjnë me fëmijët kanë pësuar shkurtime në mes të rritjes së lehtë të shpenzimeve të përgjithshme të qeverisë përmes plotësimit të Buxhetit në maj të vitit 2020.** Në veçanti, disa programe zhvillimore, siç është arsimiti gjithëpërfshirës, janë përballë me shkurtime të mëdha, gjë që e përkeqëson edhe më tej vulnerabilitetin e fëmijëve dhe aftësinë e institucioneve (veçanërisht atyre parashkollore dhe shkollore) të përshtaten me krizën e vazhdueshme dhe valën e re të mundshme të pandemisë.

Pjesa 2.2

Pjesa 2.3

**10. Sistemi arsimor në vend u transformuar mjaft shpejt në mësimin nga distanca pas mbylljes fizike të shkollave dhe institucioneve parashkollore.** Sidoqoftë, sjellja e procesit iu ishte lënë vetë shkollave dhe arsimtarëve, pa asnjë unifikim të mjeteve dhe metodave të përdorura, të cilat krijuan mundësi të pabarabarta të mësimin për fëmijët.

Pjesa 4.3.1

**11. Ngecjet dhe mangësitë në mësim mund të jenë më të mëdha në mesin e fëmijëve nga amvisëritë e varfra, fëmijët rom dhe fëmijët me aftësi të kufizuara.** Ata u përballën me një qasje të pamjaftueshme në arsim, mungesë të cilësisë në përkrahjen e prindërve dhe mungesë të ndihmës shkollore, përgjatë burimeve të pamjaftueshme të shumë shkollave në zonat ku banojnë këta fëmijë.

Pjesa 4.3.3

Pjesa 4.3.5

**12. Stafit mësimdhënës nuk është i përgatitur në mënyrë të duhur për të zhvilluar mësim digjital në distancë, megjithatë përpjekjet selektive dhe individuale mundësuara fitime të shpejta.** Ndonëse arsimtarët duhet ta përdorin TIK-në në procesin e mësimdhënies dhe mësimin në klasë, pandemia zbuloi që ishin të pamjaftueshme shkathtësitë e tyre për TIK në lidhje me planifikimin, zbatimin dhe vlerësimin e mësimin dhe të arriturave të nxënësve për aplikimin e mësimin në distancë. Kjo e përforcoi nevojën për investime të shpejta në aftësimin e personelit mësimdhënës.

Pjesa 4.3.2

**13. Ishte i dukshëm mobilizimi i burimeve njerëzore brenda gjithë sistemit arsimor me qëllimin kryesor që të ndihmohet procesi i të mësuarit të fëmijëve.** Shembujt më të spikatur përfshijnë krijimin e TV klasës dhe platformës Edulno, të cilat synojnë përmirësimin e mësimin të fëmijëve të moshës parashkollore dhe atë të shkollës fillore. Përpjekjet vazhduan me krijimin e grupeve të punës për të hartuar një strategji për mësimin digjital.

Pjesa 4.2

Pjesa 4.5

**14. COVID-19 shkaktoi vonesa në qasjen e kujdesit spitalor për të porsalindurit, fëmijët dhe nënat.** Ofrimi i shërbimeve në të gjithë sistemin e kujdesit shëndetësor ka rënë me 39 për qind për të gjithë popullsinë, 33 për qind për fëmijët dhe 25 për qind për nënat dhe të porsalindurit. Megjithatë, arsyeja kryesore e uljes së kërkesës për shërbime jo urgjente ka qenë për shkak të frikës nga infeksioni, e jo për shkak të zhvendosjes së konsiderueshme të burimeve për luftimin e virusit.

Pjesa 5.2.1

**15. Burimet njerëzore u identifikuan si problemi kryesor në reagimin e autoriteteve shëndetësore ndaj krizës së shkaktuar nga Kovid-19.** Për më tepër, pandemia zbuloi mungesa të rënda në pajisjet mjekësore dhe mbrojtëse personale për personelin, që punon me personat e infektuar. Si rezultat i kësaj, niveli i stafit mjekësor të infektuar është rritur në nëntë për qind.

Pjesa 5.1

**16. Kryesisht gjatë pandemisë janë lënë pas dore diagnostifikimi dhe kontrolli i gjendjeve kronike dhe në një farë mase kujdesi ndaj shëndetit mendor.** Nga ana tjetër shëndeti riprodhues dhe kujdesi shëndetësor i foshnjave mbetën kryesisht të paprekura, duke i zbutur efektet e krizës ndaj fëmijëve të vegjël.


Pjesa 5.2

**17. Vaksinimi gjatë Kovid-19 është kryer me pothuajse asnjë vonesë, ndërsa janë shtyrë kontrollet mjekësore të fëmijëve në moshë shkollore.** Kjo mund të shkaktojë disa efekte afatshkurtra në shëndetin e fëmijëve, megjithëse pritet që preventiva të intensivikohet pasi që pandemia të vihet nën kontroll.

Pjesa 5.2.2

**18. Sistemi shëndetësor ka bërë përpjekje për ta shfrytëzuar plotësisht teknologjinë në dispozicion gjatë Kovid-19.** Mjekët, kryesisht mjekët e përgjithshëm, zgjodhën telemjekësinë si një alternative për ofrimin e shërbimeve të kujdesit të drejtpërdrejtë shëndetësor, po ashtu edhe sistemi informatik është përshtatur për ta lehtësuar testimin dhe monitorimin e rasteve të lehta me Kovid-19.

Pjesa 5.3



# AUTORË

**Marjan Petreski**

Universiteti "American College", Shkup

**Blagica Petreski**

Finance Think – Instituti për Hulumtim Ekonomik dhe Politika

**Ana Tomovska – Misoska**

Universiteti "American College", Shkup

**Maja Gerovska – Mitev**

Universiteti "Sh. Qirili dhe Metodij", Shkup

**Maja Parnardzieva – Zmejkova**

konsulent i pavarur

**Vladimir Dimkovski**

konsulent i pavarur

**Nicholas Morgan**

ekspert arsimor nga Skocia



# PËRMBAJTJA





1. SFONDI DHE SYNIMI I STUDIMIT	16
2. PËRGJIGJA E QEVERISË NDAJ KOVID-19 ME FOKUS NË FËMIJËT	27
2.1. PËRGJIGJA E POLITIKËS NDAJ KOVID-19 PËRMES MIRATIMIT TË VENDIMEVE ME FUQITË LIGJIT	28
2.1.1. Vendimet që i prekin fëmijët	28
2.1.2. Shpërndarja fiskale e shpenzimeve	34
2.2. PËRGJIGJA E POLITIKËS NDAJ KOVID-19 PËRMES RIALOKIMEVE TË BUXHETIT TË SHTETIT	39
2.3. KAPACITETI FISKAL PËR ZBUTJEN E EFEKTEVE TË KOVID-19	46
3. FËMIJËT QË PËRBALLEN ME RREZIQE SOCIALE DHE BIEN NË VARFËR	50
3.1. SHËRBYMET PËR FËMIJËT DHE FAMILJET GJATË KOVID-19	51
3.2. PËRGJIGJA FINANCIARE E SISTEMIT TË MBROJTJES SOCIALE DHE TË FËMIJËVE GJATË KOVID-19	61
3.3. SIMULIMI I IMPAKTIT TË KOVID-19 NDAJ VARFËRISË SË FËMIJËV	66
3.3.1. Qasja metodologjike	66
3.3.2. Supozimet	68
3.3.3. Rezultatet dhe diskutimet	71
Kutia 1: Karakteristikat e vijave të varfërisë të përdora në këtë studim	72
3.4. PRIVIMET TJERA QË E PËRKEQËSOJNË NDIKIMIN E KOVID-19 NDAJ FËMIJËVE	78
4. FËMIJËT QË PËRBALLEN ME HUMBJE TË MËSIMIT	85
4.1. NJË PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E PROCESIT ARSIMOR DHE SISTEMIT ARSIMOR	87
4.2. QASJA NË ARSIM	90
4.3. NDIKIMI I VIRUSIT KOVID-19 NË ARSIM DHE REZULTATET NDËR-SEKTORIALE	96

4.3.1. Një ndryshim praktik dhe i shpejtë pa unifikim	96
Kutia 2: Praktikrat premtuese që kanë siguruar vazhdim të arsimit për të gjithë	98
4.3.2. Gatishmëria e shkollave dhe mësuesve	100
4.3.3. Mësimi, materialet dhe vlerësimi	103
4.3.4. Gatishmëria e prindërve	104
4.3.5. Arsëimi i fëmijëve të cenueshëm	105
4.4. MBËSHTETJA E FAMILJEVE NË SIGURIMIN E PËRKUJDESJES DHE MBËSHTETJES NË MËSIM TË FËMIJËVE PARASHKOLLOR	106
4.5. KONTRIBUTE TË JASHTME POZITIVE	109
5. FËMIJËT OË PËRBALLEN ME RREZIK SHËNDETI	112
5.1. HEALTH SYSTEM CAPACITY UNDER COVID-19	113
5.2. NDIKIMI I KOVID-19 NË SHËNDETIMIN E FËMIJËVE	118
5.2.1. Dhënia e shërbimeve shëndetësore	118
5.2.2. Vaksinimi	126
5.2.3. Shëndeti mendor i fëmijëve	128
5.2.4. Nënmat dhe të porsalindurit	129
Kutia 3: Pabarazitë rajonale dhe etnike sa i përket qasjes në shërbimet gjinekologjike përkeqësohen gjatë Covid-19	131
5.3. PËRDORIMI I METODAVE ALTERNATIVE NË SISTEMIN SHËNDETËSOR GJATË PANDEMISË SË KOVID-19	132
6. PËRGJIGJE ME POLITIKA DHE REKOMANDIME	134
6.1. MBËSHTETJA E FËMIJËVE DHE PRINDËRVE NË NEVOJË	135
6.2. FORCIMI I PËRDPJEKJEVE PËR TË LUFTUAR VARFËRINË TE FËMIJË	138
Kutia 4: Garancia universale e fëmijëve si opsion afatgjatë	145
6.3. SIGURIMI I VAZHDIMIT TË PROCESIT MËSIMOR	145
6.4. ZBUTJA E PROBLEMEVE SHËNDETËSORE TË RËNDËSISHME PËR FËMIJËT	148
7. REFERENCAT	150



# LISTA E TABELAVE

<b>TABELA 1:</b> MASAT E POLITIKAVE QË KANË TË BËJNË ME FËMIJËT NË PËRBALLJE ME KOVID 19	31
<b>TABELA 2:</b> KOSTOJA FISKALE E MASAVE TË POLITIKËS KOVID-19	35
<b>TABELA 3:</b> IMPLIKIMET FISKALE TË ZBUTJE SË KRITEREVE TË PËRSHTATSHMËRISË PËR NMG, SIPAS NUMRIT TË FËMIJËVE NË AMVISËRI – TË DHËNAT VJETORE	37
<b>TABELA 4:</b> TABELA 4 – IMPLIKIMET FISKALE TË MASAVE TË RUAJTJES SË VENDEVE TË PUNËS SIPAS NUMRIT TË FËMIJËVE NË AMVISËRI – PËR MUAJ	38
<b>TABELA 5:</b> IMPLIKIMET FISKALE TË PËRGJITHSHME DHE SHPËRNDARËSE TË MBËSHTETJES FINANCIARE TË NJËHERSHME	38
<b>TABELA 6:</b> TË ARDHURAT MESATARE TË DISPONUESHME PËR ANËTARËT E RRI TUR TË AMVISËRISË	70
<b>TABELA 7:</b> EFEKTET E KOVID-19 NDAJ VARFËRISË SË FËMIJËS	74
<b>TABELA 8:</b> NDIKIMET E KOVID-19 NË VARFËRINË E FËMIJËVE SIPAS GJINISË DHE MOSHËS	76
<b>TABELA 9:</b> NDIKIMET E KOVID-19 NË VARFËRINË E FËMIJËVE SIPAS DISA KARAKTERISTIKAVE TË AMVISËRISË	77
<b>TABELA 10:</b> REZULTATET E PISA-S SA I PËRKET GJUHËS SË TESTIT	88
<b>TABELA 11:</b> QASJA NË RESURSET E SHITËPISË QË MUND TË NDIHMOJNË GJATË MËSIMIT NË DISTANCË	91
<b>TABELA 12:</b> NNDARJET NË PËRVOJAT E FËMIJËRISË BAZUAR NË AKTIVITETE QË PROMOVOJNË GATISHMËRINË NË SHKOLLË DHE MËSIMIN	107
<b>TABELA 13:</b> NUMRI I EPIDEMIOLOGËVE NË INSTITUCIONET E SHËNDETIT PUBLIK	114
<b>TABELA 14:</b> NUMRI I SPECIALISTËVE PËR SËMUNDJE NGJITËSE SIPAS RAJONIT	114
<b>TABELA 15:</b> SHPENZIME TË SIMULUARA DHE SHPENZIME TJERA PLOTËSUESE NË DISPOZITAT PËR SHITESË FËMIJËRORE	140
<b>TABELA 16:</b> HARXHIMET E MUNDSHME VJETORE SI PLOTËSIM I DISPOZITAVE PËR SHITESË FËMIJËRORE, SIPAS NUMRIT TË FËMIJËVE PËR AMVISËRI	140
<b>TABELA 17:</b> SIMULIMI I STRUKTURËS SË VARFËRISË PAS KOVID-19, ZBUTJA E MASAVE PËR SHITESË FËMIJËRORE	141
<b>TABELA 18:</b> HARXHIMET VJETORE TË SIMULUARA DHE SHITESË QË NEVOJITEN PËR PREZANTIMIN E GARANCISË UNIVERSALE TË FËMIJËVE (GUF)	142
<b>TABELA 19:</b> HARXHIMET E MUNDSHME VJETORE PËR PREZANTIMIN E GARANCISË UNIVERSALE TË FËMIJËVE, SIPAS NUMRIT TË FËMIJËVE NË AMVISËRI	142
<b>TABELA 20:</b> SIMULIMET E VARFËRISË SË GARANCISË UNIVERSALE TË FËMIJËVE PAS KOVID-19	143

# LISTA E GRAFIKËVE

<b>GRAFIKU 1:</b> SHPENZIMET BUXHETORE PËR PROGRAMET QË KANË TË BËJNË ME FËMIJËT	40
<b>GRAFIKU 2:</b> NDRYSHIMET E SHPENZIMEVE TË PARAPARA NË PLOTËSIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2020	40
<b>GRAFIKU 3:</b> NDRYSHIMET E SHPENZIMEVE TË PARAPARA NË ARSIM, PLOTËSIMIT I BUXHETIT NË MAJ TË VITIT 2020	41
<b>GRAFIKU 4:</b> NDRYSHIMET E SHPENZIMEVE TË PARAPARA NË PROGRAMET ARSIMORE, PLOTËSIMIT I BUXHETIT NË MAJ TË VITIT 2020	42
<b>GRAFIKU 5:</b> NDRYSHIMET E PLOTËSIMIT TË BUXHETIT NË SHPENZIMET E PLANIFIKUARA PËR MBROJTJE SOCIALE TË FËMIJËVE, PLOTËSIMIT I BUXHETIT NË MAJ TË VITIT 2020	44
<b>GRAFIKU 6:</b> NDRYSHIMET E PLOTËSIMIT TË BUXHETIT NË SHPENZIMET E PLANIFIKUARA PËR PROGRAMET SHËNDËTËSORE	45
<b>GRAFIKU 7:</b> RASTET E DHUNËS FAMILJARE TË RAPORTUARA NGA QENDRAT E PUNËS SOCIALE	55
<b>GRAFIKU 8:</b> PËRFITUESIT E NDIHMËS MINIMALE TË GARANTUAR (NMG), SHITESËS FËMIJËRORE DHE ASISTENCËS ARSIMORE, MARS-MAJ 2020	62
<b>GRAFIKU 9:</b> APLIKUESIT E RINJ PËR NMG SIPAS PËRKATËSISË ETNIKE, VETËM AMVISËRITË ME FËMIJË	63
<b>GRAFIKU 10:</b> APLIKUESIT E RINJ PËR NMG SIPAS NUMRIT TË FËMIJËVE PËR AMVISËRI	64
<b>GRAFIKU 11:</b> APLIKUESIT E RINJ PËR NMG SIPAS NUMRIT TË FËMIJËVE PËR AMVISËRI, MBI BAZË TË PËRKATËSISË ETNIKE	65
<b>GRAFIKU 12:</b> PJESA E FËMIJËVE ME LIDHJE INTERNETI NË SHTËPI	78
<b>GRAFIKU 13:</b> KUSHTE E AMVISËRISË (PJESA E FËMIJËVE TË PREKUR)	80
<b>GRAFIKU 14:</b> PABARAZITË NË MES FËMIJËVE VARËSISHT NGA PASURIA E AMVISËRISË	82
<b>GRAFIKU 15:</b> PRAKTIKAT DHE POLITIKAT E SHKOLLAVE QË PROMOVOJNË PËRDORIMIN E PAJISJEVE DIGJITALE	101
<b>GRAFIKU 16:</b> KAPACITETI I SHKOLLËS PËR TË PËRMIRËSUAR MËSIMDHËNIEN DHE MËSIMXËNIEN DUKE PËRDORUR PAJISJE DIGJITAL	102
<b>GRAFIKU 17:</b> NUMRI I PEDIATËRVE PËR ÇDO 10,000 FËMIJË DHE GJINEKOLOGËVE PËR ÇDO 10,000 GRA	115
<b>GRAFIKU 18:</b> VLERËSIMI I MJEKËVE TË PËRGJITHSHËM SA I PËRKET EFEKTEVE TË KOVID-19 NË SHËRBIMET THEMELORE SHËNDËTËSORE	119
<b>GRAFIKU 19:</b> REDUKTIMI I SASISË SË SHËRBIMEVE SIPAS LLOJIT TË KUJDESIT SHËNDËTËSOR, LLOJIT TË PRONËSISË SË OFRUESIT (TË SHËRBIMEVE) DHE MOSHËS	121
<b>GRAFIKU 20:</b> REDUKTIMI SIPAS LLOJIT TË OFRUESVE TË KUJDESIT SHËNDËTËSOR, ATIJ TË PËRGJITHSHËM DHE PËR FËMIJË	122
<b>GRAFIKU 21:</b> NUMRI I SHËRBIMEVE NË DHJETË GRUPET MË TË ZAKONSHME TË SHËRBIMEVE (KKD)	123
<b>GRAFIKU 22:</b> NUMRI I FËMIJËVE-SHËRBIMET E KUJDESIT SPITALOR (KKD)	124
<b>GRAFIKU 23:</b> SHKALLA E VDEKSHMËRISË TE NËNAT DHE FËMIJËT	125
<b>GRAFIKU 24:</b> SHKALLA E IMUNIZIMIT, SIPAS LLOJIT	127
<b>GRAFIKU 25:</b> NUMRI I SHËRBIMEVE PËR NËNA DHE FOSH NJA TË PORSALINDUR	130



**SHKURTESAT**



BZHA	Byroja për Zhvillimin e Arsimit
EBRD	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
EMIS	Sistemi Inforamtiv i Menaxhimit të Arsimit
ESA	Agjencia e Punësimit
EU	Bashkimi Evropian
EUR	euro
FMN	Fondi Ndërkombëtar Monetar
GDP	Bruto Prodhimet Vendore
GMA	Ndihma Minimale e Garantuar
GUF	garancie universale të fëmijëve
HIF	Fondi i Sigurimit Shëndetësor
ILO/OBP	Organizata Botërore e Punës
IPH	Instituti i Shëndetit Publik
Kovid-19	Sëmundja e virusit korona e vitit 2019
KSK	Kategoritë e sëmundjes kryesore
MASH	Ministria e Arsimit dhe Shkencës
MCEC	Qendra Maqedonase për Edukim Qytetar
MICS	Hulumtimi në Klaster me më Shumë Indikatorë
MK-MOD	Modeli i Mikrosimulimit të Taksave dhe Përfitimeve për Maqedoninë e Veriut
MPPS	Ministria e Punës dhe Politikës Sociale
MSH	Ministria e Shëndetësisë
NJKI	Njësia e kujdesit intensiv
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
OECD	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
OJQ	Organizatë Joqeveritare
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian
PPP/BFB	Barazia i Fuqisë Blerëse
QAPT	Qendra për Arsimit Profesional dhe Trajnim
QPS	Qendra e Punës Sociale
QSHP	Qendra e Shëndetit Publik
SILC/SAKJ	Sondazhi mbi të Ardhurat dhe Kushtet e Jetës
SHA	Shtesë Arsimore
SHF	Shtesë Fëmijërore
TIK	Teknologjia Informatike Kompjuterike
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
UNICEF	Fondi për Fëmijë i Kombeve të Bashkuara
USAID	Agjencia e SHBA-ve për Zhvillim Ndërkombëtar



## 1. SFONDI DHE SYNIMI I STUDIMIT

Pandemia e shkaktuar nga përhapja globale e koronavirusit (Kovid-19)- në tekstin e mëtejshëm: pandemia ose Kovid-19- po e dëmton mirëqenien sociale, arsimore dhe shëndetësore të fëmijëve, të cilat kategoria e prekur më. Fëmijët janë drejtpërsëdrejti të ndikuar nga mbyllja e shkollës, objekteve jashtëkurrikulare dhe mbylljes së institucioneve të kujdesit të fëmijëve, distancimit shoqëror dhe mbylljes, gjë që shkakto ngarkesë në zhvillimin e tyre arsimor, kognitiv dhe emocional, duke shkaktuar rrezik për rritjen e nivelit të ankthit dhe stresit. Fëmijët ndikohen në mënyrë indirekte, përmes zvogëlimit të të ardhurave të familjes, gjë që e zvogëlon mirëqenien e tyre materiale dhe sociale, si dhe e dëmton qasjen në kujdesin shoqëror dhe shëndetësor, ndërsa

si goditje më e rëndë është rreziku nga kequshqyerja. Me rëndësi thelbësore është të kuptohet se ndikimi negativ i krizës së Kovid-19 mund të jetë veçanërisht i fortë për disa grupe fëmijësh, përfshirë ata që jetojnë në varfëri, fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët e privuar nga kujdesi prindëror, fëmijët në e ndaluar në ente korrektuese/ndëshkuese etj. Për më tepër është e rëndësishme të theksohet se një ndikim i tillë negativ mund të shtrihet përtej vitit 2020, me çka do të përhapet varfëria e fëmijëve për më shumë vite të fëmijërisë ose më gjerë (Elder, 1999).

Përvojat e krizave të kaluara ekonomike, të cilat goditën rëndë fëmijët në Maqedoninë e Veriut, japin të kuptohet se kriza aktuale do të ketë efekte të pafavorshme afatgjata për fëmijët. Hulumtimi dhe të dhënat që e vlerësojnë

Krizën Globale Financiare të vitit 2009 treguan se fëmijët janë prekur në mënyrë indirekte, pasi "më shumë se gjysma e amvisërive (56.4 për qind) në Maqedoninë e Veriut nuk ishin në gjendje t'i siguronin plotësisht nevojat shkollore të fëmijëve të tyre, 8.8 për qind të fëmijët po përjetonin probleme me qasjen në arsim, ndërsa 9.3 për qind nuk kishin qasje në kontrolle të rregullta shëndetësore" (Gerovska Mitev, 2010). Po ashtu, varfëria e çifteve me fëmijë ndërmjet viteve 2008 dhe 2010 është rritur me 3.4 pikë përqindje, ndërsa e amvisërive të tjera me fëmijë me 5.5 pikë përqindje, mes një rritje më të ngadaltë të varfërisë së llogaritur prej 2.2 pikë përqindje për të njëjtën periudhë. Varfëria e fëmijëve është rritur nga 34.1 për qind në 2009 në 36.9 për qind në 2010.<sup>1</sup>

Përgjigja e autoriteteve shëndetësore ndaj Covid-19 shkaktoi humbje të rënda ekonomike dhe humbje të vendeve të punës në Maqedoninë e Veriut. Me shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme në 18 mars të vitit 2020 nga Presidenti i shtetit, qeveria<sup>2</sup> teknike vendosi masa të rrepta bllokimi, përfshirë edhe masën e orës policore. Si rezultat i kësaj një pjesë e veprimtarisë ekonomike kaloi në tkurrje të induktuar pasi që u detyruan të mbyllën kafenetë, restorantet dhe qendrat tregtare. Një pjesë tjetër e veprimtarisë

ekonomike në mënyrë të konsiderueshme u zvogëluar me mbylljen e kufijve dhe kufizimin e lëvizjes, veçanërisht ofrimi i shërbimeve të hotelerisë dhe tregtia. ILO / EBRD (2020) vlerëson se një ekuivalent me kohë të plotë me rreth 85,000 vende pune janë humbur (11.5 për qind e punësimit të përgjithshëm) deri në mesin e tremujorit të dytë të vitit 2020. Për fat të mirë, të dhënat paraprake sugjerojnë që humbjet aktuale të punës janë minimizuar, veçanërisht për shkak të skemave të qeverisë për mbështetje të ekonomisë. Sidoqoftë, një sasi e konsiderueshme e të ardhurave është humbur. Me parashikimet se ndikimi më i madh në ekonomi dhe në tregun e punës ka ndodhur në tremujorin e dytë të

---

<sup>1</sup>Këto numra të varfërisë bazohen në Anketën e buxhetit të amvisërisë, llogaritja e cila është braktisur në vitin 2010 me aktivizimin e Anketës mbi të ardhurat dhe kushtet e jetesës. Prandaj, këto nuk duhet të krahasohen me vlerësimet tona të mëvonshme bazuar në (Statistika e të ardhurave dhe kushteve jetësore) SILC.

<sup>2</sup>Qeveria në detyrë nga 3 janar 2020, me një mandat prej 100 ditësh për të përgatitur dhe zhvilluar zgjedhje të drejta dhe demokratike të planifikuara për 12 prill 2020. Kjo do të thoshte që në kohën kur goditi kriza, ndërlikur edhe me mbylljen e shkollës në 11 mars 2020, Maqedonia e Veriut nuk kishte një parlament funksional, kështu që shpallja e gjendjes së jashtëzakonshme nga Presidenti ka qenë mënyra e vetme ligjore dhe legjitime për ta rikthyer pushtetin politikëbërës të qeverisë.

vitit 2020<sup>3</sup>(që është në rrjedhë e sipër), të ardhurat dhe humbjet e vendeve të punës mund vërtet të përkeqësohen edhe më shumë.

Kjo gjendje ka shumë gjasa të përkeqësojë varfërinë. Me një shkallë varfërie të fëmijëve prej 29.3 për qind, pothuajse çdo fëmijë i tretë (0-17 vjeç) në Maqedoninë e Veriut rritet i varfër (të dhëna për vitin 2018 nga Sondazhi mbi të ardhurat dhe kushtet e jetesës, SILC). Shkalla e varfërisë së familjeve me tre ose më shumë fëmijë qëndron në shkallën tronditëse 50.2 për qind, e ndjekur nga një normë prej 33.5 për qind e prindërve të vetëm. Përqindja e fëmijëve me privime të rëndë materiale, d.m.th. popullata e fëmijëve që nuk mund të përballojë të paktën 4 nga 9 nevoja themelore, ka qenë më e larta në mesin e fëmijëve me 33.5 për qind. Në përgjithësi, 9.4 për qind e të gjithë fëmijëve në Maqedoninë e Veriut vuajnë nga rrezikut i bazuar në: varfëria si rezultat i të ardhurave, privimi material dhe jetesa në familje pa punë. Kjo shifër dallon gati katërfish krahasuar me mesataren e BE-28. Provat<sup>4</sup> ekzistuese sugjerojnë se familjet etnike shqiptare përbëjnë më shumë se 40 për qind të kuintilit më të varfër, me të ardhura të disponueshme vetëm në dy të tretat e atyre të bashkëmoshatarëve maqedonas, ndërsa popullsia rome nuk është e përqendruar vetëm në 40

përqindëshin e ulët, por është gjithashtu shumë më poshtë se grupet e tjera etnike në rezultatet e tregut të punës, kapitalin njerëzor dhe treguesit e tjerë të varfërisë jo-monetare.

Sistemi i mbrojtjes sociale dhe fëmijëve në Maqedoninë e Veriut ka kaluar përmes një reforme gjithëpërfshirëse në qershor të vitit 2019 me qëllim që ta ul më tej varfërinë përmes rritjes së transferimeve të parave dhe synimit të përmirësuar. Ndryshimet në ligj e thjeshtuan mbrojtjen sociale dhe të fëmijëve duke imponuar dy ndryshime të mëdha: (a) futjen e të ardhurave minimale të garantuara për familjet e varfra dhe (b) heqjen e shumicës së kushteve që kanë të bëjnë me shtesat fëmijërore, duke e rritur në mënyrë të konsiderueshme mbulimin e tyre. Ndryshimet përfshijnë integrimin e avancuar dhe të përmirësuar të shërbimeve sociale, përfshirë ato që synojnë t'i trajtojnë rastet e dhunës ndaj fëmijëve. Paralelisht me këtë,

---

<sup>3</sup>Shih, p.sh. [FT Opinion No. 44 for the expected economic recession and projection of GDP decline.](#)

<sup>4</sup>Nuk ka ndarje statistikore nacionale sipas përkatësisë etnike. Prandaj, përdoren burime alternative. Burimi kryesor për ndarjen etnike këtu është Vëzhgimi i cilësisë së jetës në Maqedoni, i cili është hartuar dhe mbledhur nga Financial Think në maj-qershor të vitit 2017. Shihni [Survey of Quality of Life in Macedonia](#)



procesi i deinstitutionalizimit, që mundësoi të mos ketë më fëmijë në institucione, kontribuoi në sigurimin e cilësisë së përmirësuar të kujdesit në ambiente alternative brenda bashkësive lokale. Fëmijët romë mbeten në rrezikun më të lartë të përjashtimit, duke përfshirë këtu vazhdimësinë e lypësve të vegjël në rrugë<sup>5</sup>. Shpenzimet për mbrojtjen sociale kanë pasur një trend në rritje në 15.5 për qind të BPV-së në vitin 2019, përfshirë shpenzimet për ndihmë sociale, ndonëse ndihma sociale përbënte vetëm 1.4 për qind të BPV-së. Për më tepër, vetëm një e katërta i shpenzimeve të tilla kanë të bëjnë me fëmijët (Petreski dhe Petreski, 2018).

Varfëria, përjashtimi social dhe pabarazitë kanë një ndikim të madh në masën në të cilën fëmijët janë të ekspozuar ndaj pasojave sociale të Kovid-19. Amvisëritë më të varfra janë më pak financiarisht rezistente, më të ekspozuara ndaj intensitetit të ulët të punës, punës joformale dhe humbjeve të vendeve të punës. Puna joformale, e cila në Maqedoninë e Veriut është vlerësuar të jetë 18.5 për qind në vitin 2018 (Anketa e Forcës së Punës, AFP), mund të rrezikojë veçanërisht qasjen e personave të cilëve iu varet siguri shëndetësor dhe sociale përmes punës që bëjnë (OECD / ILO 2019). Rritja dhe jeta në varfëri si dhe të qenit të përjashtuar nga shoqëria ndikon njashtu në

një varg privimesh jo-monetare siç është kequshqyerja, objekti i dobët i banimit, çështjet e hapësirave sanitare, hapësira për të luajtur ose studiuar dhe mundësitë për t'u përfshirë në mësimin në internet (OECD, 2020a). 18.2 për qind e familjeve në Maqedoninë e Veriut nuk kishin qasje në internet (të dhëna për vitin 2019 nga Hulumtimi në klaster me më shumë indikator, MICS).

Masat shëndetësore ndaj Kovid-19 sollën në mbyllje të shkollave në Maqedoninë e Veriut më 11 mars 2020, duke përfshirë të gjitha aktivitetet jashtëkurrikulare për fëmijë, qoftë publike ose private. Shkollat nuk do të hapen sërish, të paktën jo deri në fillim të vitit të ardhshëm shkollor, ndërsa planet e tanishme për rihapjen e kopshteve më 1 korrik ka të ngjarë që të shtyhen. Mbyllja e shkollave është pasuar nga një reagim mjaft i shpejtë i Qeverisë, duke mundësuar kalimin në mësimin nga distanca, me qëllim që parandalohen humbje të mëdha në mësim, të cilat nga ana tjetër, mund të shndërrohen në plagë më afatgjata të kapitalit njerëzor. Ligjëratat në internet u inkurajuan, ndonëse nuk ishin të detyrueshme, ndërsa një platformë nacionale arsimore

---

<sup>5</sup>[Raporti i Komisionit Evropian për Maqedoninë e Veriut](#)

Eduino (<http://www.eduino.gov.mk/>) është zhvilluar me shpejtësi, duke integruar mësim, video, burime, lojëra dhe aktivitete të ndryshme në mbështetje të procesit arsimor. Televizioni kombëtar transmetonte orë të drejtpërdrejta të TV për çdo ditë deri në fund të vitit shkollor më 10 qershor. Qeveria solli vendim që një prind për fëmijë deri në dhe përfshirë klasën e katërt në shkollën fillore të lirohet në pushim me pagesë, në barrë të punëdhënësit, me qëllim që të kujdeset kujdesur për fëmijën/fëmijët.

Situata para Covid-19 me arsimin ende mund t'i përkeqësojë humbjet e pritshme të mësim. Edhe pse arsimi fillor dhe ai i mesëm janë të detyrueshëm, disa tendenca e potencojnë se është duke u përkeqësuar cilësia e arsimit. Maqedonia e Veriut përballet me rënie të pjesës së shpenzimeve në arsim sipas BPV-së, e cila e pasqyron pjesërisht numrin në rënie të nxënësve dhe studentëve (të përcaktuara nga tendencat demografike). Në të njëjtën kohë, numri i mësuesve është në rritje e sipër, ndërsa dhe rezultatet janë duke u përkeqësuar (Petreski dhe Petreski, 2018). Me decentralizimin fiskal, komunat janë përgjegjëse për administrimin e shpenzimeve rrjedhëse për arsim, gjë që ka çuar në pabarazi të konsiderueshme, pasi komunat më të mëdha i kanë shfrytëzuar avantazhet e përmasës ekonomitë

dhe efikasitetin e përmirësuar (Banka Botërore, 2019). Sidoqoftë, mungesa e burimeve arsimore dhe kushteve të dobëta të mësimit ka qenë e dukshme, veçanërisht në drejtim të zbulimit dhe diagnostikimit të nevojave mësimore të nxënësve nga mësuesit.

Sipas vlerësimit të PISA 2018 (OECD, 2019c), nxënësit në Maqedoninë e Veriut kanë ngec shumë mbrapa nga bashkëmoshatarët e tyre ndërkombëtarë, pavarësisht progresit të fundit. Në tre fushat e renditjes- matematikë, lexim dhe shkencë- nxënësit e Maqedonisë së Veriut kanë rezultate dukshëm më të ulëta në krahasim me mesataren ndërkombëtare dhe madje edhe më të ulët se mesatarja e OECD. Nxënësit e klasës I në Maqedoninë e Veriut kanë vetëm 552 orë kohë mësimdhënie dhe në kohën kur janë 14 vjeç, ata grumbullojnë mesatarisht 900 orë më pak mësim sesa nxënësit në vendet e tjera të OECD (OECD, 2019a). Vajzat arritën rezultate më të larta se djemtë me shtatë pikë në matematikë dhe me 19 pikë në shkencë, këto boshllëqe gjinore ishin më të gjëra ose të kundërta me ato të OECD. Rezultatet e PISA 2018 tregojnë se 11 për qind e variacionit në suksesin e nxënësve në matematikë, dhe 10 për qind në shkencë shpjegohet mbi bazë të prejardhjes socio-ekonomike, d.m.th. nxënësit me

prapavijë të pafavorshme kanë më keq sesa bashkëmoshatarët e tyre me më shumë avantazhe, ndera gjithçka tjetër është e barabartë.

Në fakt pabarazitë në qasjen dhe arsimin cilësor janë të dukshme që nga edukimi parashkollor. Dhe mund të vërehen brenda gjithë sistemit. Pjesëmarrja e përgjithshme në edukimin parashkollor është e ulët, duke qëndruar në 36.8 për qind, me pabarazi të konsiderueshme: 7.4 për qind e fëmijëve nga kuintili më i varfër janë të përfshirë në edukimin parashkollor në krahasim me 67.4 për qind të atyre nga kuintili më i pasur; 53.9 për qind midis etnisë maqedonase krahasuar me vetëm 14.1 për qind midis shqiptarëve dhe vetëm 11.4 për qind midis etnisë rome (MICS, 2019). Nivele të ulëta të përfshirjes në edukimin parashkollor nënkupton që fëmijët hyjnë në shkollë të papërgatitur, pa aftësi themelore të shkrim-leximit dhe numeracionit. Indikatorë tjerë të lidhura me arsimin zbulojnë mospërputhje të konsiderueshme midis nxënësve që banojnë në amvisëri të varfra dhe ata që jetojnë në amvisëri me mirëqenie të mirë. Për shembull, 22.5 për qind e të rinjve të moshës për shkollë të mesme që jetojnë në amvisëri më të varfra janë jashtë procesit mësimor, në krahasim me asnjë prej atyre më të pasur. Në mënyrë të ngjashme, pavarësisht se është i detyrueshëm arsimi i mesëm,

normat për përfundimin e arsimit të mesëm të lartë janë alarmante midis segmenteve më të varfra, ku 64.4 për qind e përfundojë shkollimin, krahasuar me segmentet e pasura, ku të gjitha e përfundojnë shkollimin (MICS, 2019). Këto numra veçanërisht janë të larta në vendbanimet rome.

Mësimi në distancë i imponuar nga kriza Kovid-19 mund të ndikojë në mësimin përmes të paktën dy kanaleve. Së pari, fëmijët me qasje të kufizuara ose aspak në burime mësimore dhe internet, si dhe që jetojnë në vendbanime joformale ose të mbushura me njerëz, preken veçanërisht. Si ilustrim, 58.8 për qind e fëmijëve kishin tre ose më shumë libra në shtëpi, përqindja shënon rënie në 17.9 për qind midis më të varfërve dhe 12.4 për qind midis romëve (MICS, 2019). Një mjedis i tillë sfidues mund të jetë rasti për amvisëritë rurale, amvisëritë me shumë fëmijë dhe etnitë e veçanta- veçanërisht romët- të cilat tashmë kanë vuajtur nga disavantazhet (p.sh., rreth 18.7 për qind e fëmijëve nga komunitetet rome nuk kanë ndjekur rregullisht shkollën fillore edhe para Kovid-19). Në veçanti është vështirë t'u mundësohet shërbim adekuat fëmijëve me aftësi të kufizuara në kuadër të mësimin nga distanca, madje ata edhe ashtu kishin më pak të ngjarë të kenë qasje në arsim cilësor dhe të përparojnë me sukses përmes

sistemit arsimor. Kanali i dytë është rritja e ndikimit të sfondit socio-ekonomik të prindërve në rezultatet e të mesmit të fëmijëve. Për shkak të përfshirjes së mësimin në distancë, prindërit jo vetëm që duhet të përfshihen në ndihmën e fëmijëve të tyre dhe në sigurimin e cilësisë së procesit mësimor, por edhe duhet të përkujdesen që të sigurojnë një kalim të qetë në mësimin në distancë, gjë që mund të rezultojë veçanërisht joefektive në rastet me sfond të pafavorshëm (qoftë financiar ose arsimor), duke rrezikuar kështu përkeqësimin e rezultateve arsimore, pastaj braktisjet e mësimin, veçanërisht në arsimin e mesëm të lartë.

Si kudo tjetër, fëmijët në Maqedoninë e Veriut janë prekur më pak nga infektimi me Kovid-19 drejtpërdrejt. Megjithatë qeveria e prezantoi një bazë të të gjitha informacioneve nacionale në lidhje me Kovid-19 (<https://koronavirus.gov.mk/>), prapëseprapë nuk jepej kategorizimi i personave të infektuar sipas moshës së tyre. Sidoqoftë, dëshmitë reale vërtetojnë statistikën globale që zbulojnë se nivelet e shtrimit në spital të fëmijëve simptomatikë kanë qenë 10 dhe 20 herë më të ulëta se të atyre të moshës së mesme dhe 25-100 herë më të ulët sesa të personave të moshuar (Verity et al. 2020). Megjithatë, efektet më të gjera të pandemisë në shëndetin e fëmijëve mund të jenë domethënëse dhe të

përkeqësohen nga mangësitë ekzistuese të sistemit shëndetësor.

Rezultati i Maqedonisë së Veriut në Indeksin Global të Sigurisë së Shëndetit (2019) është 39.1, gjegjësisht në pozitën e 90-të nga 195 shtete. Kapaciteti për zbulimin dhe raportimin (i cili i përfshin sistemet laboratorike, mbikëqyrjen dhe raportimin në kohë reale, fuqinë punëtore epidemiologjike dhe integrimin e të dhënave në sektorët e shëndetit njerëzor/të kafshëve/mjedisit jetësor) konsiderohet i moderuar, kur kihet parasysh vendin që shënon nën mesataren (41.7 përballë mesatares prej 41.9). Fatkeqësisht, aftësia e vendit për rezultate të reagimit të shpejtë është 33.1 në mënyrë të konsiderueshme nën mesataren e 38.4, andaj edhe renditen në pozitën e 112-të.

Para shpërthimit të pandemisë, Maqedonia e Veriut përballëj me vdekshmërinë më të lartë perinatale në Evropë me 16 % në vitin 2016, përkundër faktit që pothuajse të gjitha gratë shtatzëna merrnin kujdesin para lindjes dhe pothuajse të gjitha lindjet bëheshin në prezencë të personelit të aftë shëndetësor (MICS, 2019). Vdekshmëria e foshnjave ka qenë në një rritje të qëndrueshme në 10.8 % në vitin 2015, por më pas kjo tendencë është përmbysur. Në periudhën 2005-2018, shkalla e imunizimit kundër fruthit, shytave dhe

rubeolës (MMR) për fëmijët e moshës 1-2 vjeç ka rënë nga 96% në 83%. Mbulimi i imunizimit të fruthi mbetet i ulët, ndërsa shpërthime të mëdha dhe viktima janë regjistruar në vitet 2018 dhe 2019<sup>6</sup>, mirëpo autoritetet arritën të vënë nën kontroll me përpjekjet e vaksinimit, pavarësisht nga situatën e rënduar nga hezitimi për marrje të vaksinave (ISHP, 2019). Mbulimi i vaksinimit është në rënie, siç rezultat i lëvizjeve kundër vaksinimit. Në Maqedoninë e Veriut kanë qenë të përhapura ushqimi i dobët dhe aktiviteti i pamjaftueshëm fizik i fëmijëve. Për shembull, 13.1 për qind e djemve dhe 9 për qind e vajzave nën moshën 5 vjeç ishin mbipesha (MICS 2019).

Sipas të dhënave administrative të Fondit të Sigurimit Shëndetësor në vitin 2019 mbi 1.8 milion<sup>7</sup> individë ishin të mbuluar me sigurim shëndetësor. Kjo tregon një mbulim të lartë me 90 për qind të sigurimeve shëndetësore. Edhe ë dhënat e MICS-ë e vërtetojnë këtë, duke treguar që mbi 95 për qind e fëmijëve janë të mbuluar me sigurim shëndetësor (MICS, 2019).

Sidoqoftë, 20.5 për qind e njerëzve kanë pasur një vështirësi të madhe në shfrytëzimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor (SILC, 2018), duke sugjeruar një ndërlidhje të fortë midis vështirësisë së tillë dhe varfërisë si rezultat i të ardhurave. Shpenzimet

shtetërore për shëndetësinë kanë rënë vazhdimisht gjatë 15 viteve të fundit, nga 9 për qind në 2002 në 6.1 për qind në vitin 2017. Shpenzimet shtetërore për kujdesin shëndetësor të fëmijëve kanë rënë nga 0.68 për qind e BPV-së në 2010 në 0.63 për qind në vitin 2017 (Parnardzieva-Zmejkova dhe Dimkovski, 2018). Pagesat e participimit në shpenzimet totale të shëndetit kanë rënë me kalimin e kohës, megjithëse niveli prej 31.9 për qind në vitin 2017 ishte ende në mënyrë të konsiderueshme i lartë (të dhënat e Bankës Botërore). Në të vërtetë, pabarazitë në qasjen dhe cilësinë e kujdesit shëndetësor janë gjithëpërfshirëse. Petreski (2020) dokumenton se nevoja e pakënaqur për një mjek dhe barra financiare për të vizituar një mjek kanë qenë më të larta në decilet më të varfëra. Pabarazitë etnike në kujdesin shëndetësor janë veçanërisht të theksuara për komunitetin rom, që gjithashtu përballen me jetëgjatësi të zvogëluar (AECOM, 2019).

<sup>6</sup>Shihni po ashtu diskutimin këtu: [link](#)

<sup>7</sup><http://www.fzo.org.mk/WBStorage/Files/GODISEN%202019%20.pdf>

Pandemia e Kovid-19 mund t'i përkeqësojë dobësitë dhe t'i cenojë fitimet e fundit në kujdesin shëndetësor të fëmijëve. Ulja e të ardhurave të amvisërisë mund t'i detyrojë amvisëritë e varfra t'i shkurtojnë shpenzimet thelbësore të kujdesit shëndetësor ose të përkeqësojnë cilësinë e ushqimit që përkeqëson kequshqyerjen dhe mbipeshën te fëmijët. Ndikimi afatgjatë mund të jetë më i vështirë për t'u vlerësuar saktësisht dhe varet nga shkalla në të cilën pandemia mund ta zvogëlojë mundësinë e përdorimit të ndërhyrjeve thelbësore riprodhuese të nënave, të porsalindurve dhe të fëmijëve, siç është kujdesi para lindjes, prezenca e personit të aftë gjatë lindjes dhe mjekimi për sëmundje të ndryshme që ndërliken me fëmijët. Për më tepër, përpjekjet dhe përfitimet e fundit në imunizimin e fruthit mund të kufizohen për shkak të përqendrimit të humbur nga autoritetet. Në fund, fëmijët mund të përballen me kërcënime ndaj shëndetit e tyre mendor, nëse mbyllja dhe distanca fizike e rritin ankthin e tyre dhe atë të prindërve të tyre. Kjo e fundit në veçanti përjetësohet me presionin që buron nga ulja e të ardhurave dhe rreziqet e humbjes së vendit të punës. Për fëmijët e lënë pas, akumulimi i privimeve mund të rrisë nivelin e stresit dhe të dëmtojë zhvillimin e tyre kognitiv. Qëllimi i përgjithshëm i këtij

studimi është të zhvillojë një vlerësim të shpejtë socio-ekonomik të ndjeshëm për fëmijët dhe çështjet gjinore për impaktin afatmesëm dhe afatgjatë të krizës së shkaktuar nga pandemia e Kovid-19 në mirëqenien e fëmijëve në Maqedoninë e Veriut. Në veçanti, vlerësimi përqendrohet në tre fusha plotësuese:

**(i)** ndikimi në sektorë specifike të lidhur me fëmijët: mbrojtja sociale dhe mbrojtja e fëmijëve, arsimi dhe kujdesi shëndetësor;

**(ii)** ndikimi nga varfërisë së fëmijëve; dhe

**(iii)** ndikimi ndaj financave publike, në veçanti kapaciteti i Qeverisë për t'u kundërpërgjigjur dhe për ta zbutur ndikimin e krizës përmes i investimeve publike në sektorët kyç, që kanë të bëjnë me fëmijët.

Metodologjia e përdorë në këtë studim i përfshin këto qasje:

**a. Grumbullimi i të dhënave parësore përmes intervistave.** Për qëllimin e këtij studimi u realizuan 28 intervista të thella, me një spektër të gjerë të palëve të interesuara në të tre sektorët (mbrojtje sociale dhe mbrojtja e fëmijëve, arsimi dhe shëndetësia), që përfshinin zyrtarë qeveritarë, profesionistë, praktikues, përfaqësues të OJQ-ve,

mësues, psikologë, pedagogë dhe mjekët. Përgjatë pyetjeve që kanë të bëjnë me sektorin e përfaqësuar, të intervistuarit janë pyetur gjithashtu për nevojat financiare shtesë të imponuara nga efektet më të gjera të krizës Covid-19.

#### **b. Grumbullimi i të dhënave parësore përmes një studimi.**

Hulumtuesit e realizuan një studim me mjekë të përgjithshëm (mjek amë, përfshirë mjekë të familjes, pediatër dhe gjinekologë), i cili rezultoi në 236 përgjigje, dhe mbuloi 14.8 për qind të tërë popullatës së synuar. Përderisa përfaqësimi i plotë nuk pretendohet, shkalla e përgjigjes së sondazhit sigurojnë heterogjenitet të mjaftueshëm për të siguruar përgjigje të forta totale.

#### **c. Grumbullimi i të dhënave administrative.**

Të dhëna të kufizuara dhe të zgjedhura administrative janë mbledhur nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale për të marrë përshtypjen fillestare të efekteve sociale të krizës ndaj amvisërive dhe fëmijëve. Të dhënat administrative janë mbledhur gjithashtu për shpenzimet fiskale të planifikuara dhe të ekzekutuara nga Ministria e Financave, si dhe për një varg indikatorësh që kanë të bëjnë me shëndetin nga Ministria e Shëndetësisë. Të dhënat që kanë të bëjnë me

reagimin e tregut të punës dhe realizimin e subvencioneve qeveritare për masat e ruajtjes së vendeve të punës janë mbledhur nga Agjencia e Punësimit dhe Zyra e të Ardhurave Publike.

#### **d. Grumbullimi i të dhënave sekondare përmes anketës.**

Për pjesë të ndryshme të studimit, janë përdorur dy sondazhe kryesore: Sondazhi mbi të ardhurat dhe kushtet e jetesës (SILC) 2018 është përdorur në dhomën e sigurt të Entit Shtetëror të Statistikës përmes përdorimit të të dhënave në nivelin individual. Hulumtimi i ri në klaster me më shumë indikatorë (MICS) 2019 është përdorë përmes të dhënave të përgjithshme të publikuara nga Enti Shtetëror i Statistikës<sup>8</sup>.

**e. Mikrosimulimi.** Simulimi është bazuar në konturat e Modelit të Mikrosimulimit të Taksave dhe Përfitimeve të MK-MOD, i cili është zhvilluar fillimisht dhe mirëmbahet nga Financial Think<sup>9</sup>. Për qëllimin

---

<sup>8</sup>Gjendet në: [link](#)

<sup>9</sup>MK-MOD është një model statik, që zbaton në mikro të dhëna rregullin e definuar të taksave dhe politikave të përfitimeve për përdoruesin si për individët, po ashtu edhe për amvisëritë, njashtu i përlogarit ndikimet e këtyre rregullave ndaj të ardhurave të amvisërive dhe pastaj i prodhon rezultatet në mikro nivel. Modeli është i bazuar në modelin STATA. Shihni më shumë në: [link](#)



e këtij studimi, janë përdorur tipare të zgjedhura të modelit dhe është rikalibruar në SILC-në më të fundit 2018. Sipas supozimeve të caktuara, ushtrimi i modelimit i simulon efektet e pandemisë mbi varfërinë e fëmijëve, si dhe shërben për të vlerësuar varfërinë dhe efektet fiskale të disa politikave të propozuara.

#### **f. Analiza e dokumenteve.**


Përderisa aktualisht literatura globale është akoma e pakët në lidhje me vlerësimin përkatës të ndikimit të Kovid-19 ndaj mirëqenies së fëmijëve, e le të mos flasim për literaturën vendore, janë përdorur pak raporte të disponueshme gjatë gjithë analizës, qoftë për krahasimin e pritjeve globale, ose për t'i krahasuar efektet tjera të pritura (më së shumti ato kanë të bëjnë me rritjen e BPV-së dhe zhvillimet e tregut të punës) në Maqedoninë e Veriut. Buxheti i shtetit dhe plotësimi i tij, si dhe të gjitha vendimet e Qeverisë mbi shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme gjithashtu kanë qenë objekt e kësaj analize.

Struktura e studimit është si më poshtë. Pjesa 2 i shqyrton reagimet e Qeverisë së Maqedonisë së Veriut ndaj Kovid-19, me një referencë të veçantë për lëvizjet e politikës që ndikojnë drejtpërdrejt dhe

tërthorazi në mirëqenien e fëmijëve. Kjo pjesë e siguron një vlerësim të përqendruar tek fëmijët për implikimet fiskale të masave më të fundit të politikave. Po ashtu iu kushton vëmendje të veçantë programeve të lidhura me fëmijët në buxhetin e shtetit dhe i vlerëson prioritetet e ndryshuara në shpenzimet aktuale dhe investuese, të rëndësishme për fëmijët, siç përcaktohet nga plotësimi i fundit i buxhetit. Pjesa 3 e vlerëson ndikimin e pandemisë në sektorin e mbrojtjes sociale dhe fëmijëve. Ajo gjithashtu e simulon ndikimin në varfërinë e fëmijëve, përfshirë një diskutim të shkurtër në lidhje me një sërë indikatorësh të varfërisë jomonetare. Pjesa 4 merret me vlerësimin e ndikimit të pandemisë në rezultatet arsimore të fëmijëve, ndërsa Pjesa 5 në ato shëndetësore. Pjesa 6 krijon hapësirë për reagim ndaj politikave dhe i diskuton implikimet fiskale të simuluar dhe të mundshme të disa propozimeve të politikave, aty ku është e mundur.



## 2. PËRGGJIGJA E QEVERISË NDAJ KOVID-19 ME FOKUS NË FËMIJËT



Me shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme më 18 mars të vitit 2020, pushteti ligjvënës kaloi në kompetencat e qeverisë. Kjo nënkuptonte që të gjitha masat dhe ndryshimet e politikave që përndryshe kërkonin ndryshime në ligj ose ndryshime nga parlamenti janë bërë nga qeveria përmes miratimit të vendimeve, që kanë fuqinë e ligjeve. Kjo pjesë i shqyrton vendimet e Qeverisë që janë drejtpërdrejt ose tërthorazi të rëndësishme për fëmijët dhe i vlerëson implikimet e tyre fiskale. Pastaj, shpaloset një diskutim mbi plotësimin e Buxhetit të miratuar njësoj si mënyrë e kundërpërgjigjes ndaj pandemisë.

## 2.1. PËRGJIGJA E POLITIKËS NDAJ KOVID-19 PËRMES MIRATIMIT TË VENDIMEVE ME FUQI TË LIGJIT

### 2.1.1. Vendimet që i prekin fëmijët

Qeveria i ka miratuar tre pako të masave të politikave për t'u përballuar me pasojat negative të Kovid-19. Këto pako janë krijuar për t'u përballur me katër rreziqe kryesore: rreziku i përhapjes së infeksionit; rreziku ekonomik, përfshirë humbjen e të ardhurave dhe përkeqësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve më të prekur; rreziku i qasjes së cenuar në shërbime; dhe rrezik si pasojë e rrezikimit të përkeqësimit të procesit mësimor. Përgjigjet e politikave të grupuar rreth këtyre rreziqeve janë veçanërisht të rëndësishëm për fëmijët, qoftë drejtpërsëdrejti ose tërthorazi. Vendimet përkatëse me fuqi të ligjit janë analizuar në **Tabelën 1**.

Masat e zbatuara për të penguar përhapjen e infeksionit përfshijnë: mbylljen e kufijve, inkurajimin e distancimit shoqëror, vendosjen e kufizimeve të rrepta të udhëtimit, ndalimin e lëvizjes së qytetarëve duke përfshirë orën policore, mbajtjen e maskave dhe dezinfektimet, etj. Gjatë periudhave të caktuara, ora policore ka qenë më kufizues për fëmijët sesa për grupmoshat tjera. Kjo është bërë me qëllim

që të shmanget kontakti me të moshuarit dhe të parandalohet bartja e mundshme e infeksionit të personat e vjetër nga bartësit asimptomatikë të viruseve nga radhët e fëmijëve. Në të vërtetë, shumica e masave të drejtpërdrejta kanë pasur për qëllim mbrojtjen e fëmijëve nga rreziku i infeksionit. Këto më tej kanë përfshirë: i) zgjatjen pushimit prindërore në dobi të të porsalindurve, ii) zgjatjen e afateve për dorëzimin e kërkesës për ndihmë financiare për të porsalindur, për dhënien e të drejtës për ndihmë prindërore (për fëmijën e tretë dhe të katërt) dhe për ndihmën e veçantë të fëmijëve, si dhe lehtësimin e kriterit për ndjekje të mësimit nga fëmijë si kusht për dhënien e ndihmës arsimore, (iii) mbylljen e objekteve shkollore, parashkollor dhe objektet shkollore jashtëkurrikulare, dhe iv) anulimin e Provimit të maturës shtetërore. Si rezultat i këtyre masave, sistemi arsimor është prekur më ashpër, duke rritur kështu rrezikun e përkeqësimit të procesit të mësimit. Për të përballuar këtë të situatë, Qeveria filloi qasjen e mësimit nga distanca, ndonëse pa ndonjë strukturë të unifikuar dhe të fortë nëpër shkolla. Platforma nacionale e arsimit (<http://www.eduino.gov.mk/>) dhe transmetimi ditore të mësimëve të strukturuar në televizion u iniciuan me shpejtësi, me qëllim që të mbështetet mësimi në internet (onlajn). Ndalimi i qasjes

në shërbime të përkujdesjes dhe shkollimit ishte shkas për vendimin e qeverisë për lirim të prindërve të punësuar në pushim të paguar nga punëdhënësi (një prind për familje) për fëmijët deri në moshën 10 vjeçare.

Qeveria ka hartuar dy lloje të ndërhyrjeve politike për ta parandaluar humbjen e të ardhurave dhe për ta përmirësuar cilësinë e jetës së qytetarëve. E para kishte për qëllim t'i mbronte vendet e punës dhe likuiditetin e kompanive më të prekura dhe përfshinte subvencionimin e pagave të sektorit privat dhe kontributet sociale, shtyrjen e parave të paguara të tatimit mbi fitimin, kreditë me kushte të favorshme dhe garancitë e kredisë dhe disa mbështetje specifike sektoriale. Dy masa kryesore të ruajtjes së vendeve të punës përfshinin subvencion për kompanitë me rënie prej 30+ për qind të të ardhurave gjatë pandemisë në krahasim me mesataren e vitit 2019, për punëtorët e këtyre kompanive që marrin pagë neto 3939 denarë, siguroi mbështetje me një shumë prej 14,500 denarë për punëtor; si dhe një subvencion prej 50 për qind të kontributeve sociale deri në nivelin e pagës mesatare. Të dy ishin masat e vendosura ishin me karakter ekskluziv, andaj nuk mund të kompensoheshin për njëra tjetrën, me përjashtim të kompanive në sektorin e turizmit, transportit dhe hotelierisë, të

cilëve iu lejohej t'i kombinojnë këto subvencionime. ILO / EBRD (2020) sugjeron që masa e parë ka pasur një avantazh të qartë për sa i përket qasjes bujare të qeverisë për mbështetje të ekonomisë.

Lloji i dytë i intervenimit ka pasur për qëllim ruajtjen e stabilitetit shoqëror të qytetarëve më të prekur përmes rritjes së qasjes në shërbime dhe relaksimit të kriterëve të pranueshmërisë për ndihmë minimale të garantuar (NMG/GMA) dhe për përfitim nga papunësia. Relaksimi i kriterëve të NMG-së mundësoi të përfshihen edhe amvisëritë që posedonin e një pasurie të patundshme, ku banon amvisëria, një makinë më të vjetër se 5 vjet dhe një ngastër (truall) ndërtimi nën 500 m<sup>2</sup>, të gjitha këto kriterë më parë ishin pengesë për realizim të së drejtës për këtë lloj të mbështetjes sociale. Për më tepër, kriteri i të ardhurave duhej të vlerësohej në arkëtimet e të ardhurave për muajin e kaluar, e jo në tre muajt e kaluar si ishte më parë. Kjo masë mundësonte përfshirjen e shpejtë të amvisërive në sistemin NMG, pasi që të ardhurat e tyre kishin rënë si rezultat i Kovid-19. Relaksimi i kriterëve për sigurimin e përfitimeve për shkak të papunësisë përfshinte zgjerimin e përshtatshmërisë për të gjithë individët që e kanë humbur punën për ndonjë arsye (vetë ose nga punëdhënësi) në mars dhe prill, kriterë të cilat më parë kishin qenë dukshëm më

të rrepta. Ky grup përfshin më tej një mbështetje financiare të njëhershme për marrësit e NMG-së dhe të papunët të regjistruar në mënyrë aktive me 9,000 denarë dhe punëtorë me pagë të ulët (të cilët gjatë vitit 2019 dhe 2020 kanë pasur të ardhura nën 15,000 denarë në muaj) dhe të rinjtë (16-29) në arsim të rregullt me 3.000 denarë. Sidoqoftë, vetëm një masë që lidhet me të ardhurat drejtpërdrejt ishte e synuar për fëmijë (0-17 vjeç) edhe atë vetëm në mënyrë marginale.

Meqenëse janë të disenjaura në këtë mënyrë, masat e drejtpërdrejta që kanë të bëjnë me fëmijët mbeten të pakta dhe nuk mbulojnë të gjitha rreziqet që prekin potencialisht fëmijët. Për më tepër, vetëm dy nga tetë masat e drejtpërdrejta kanë implikim fiskal: pushimi i zgjatur i prindërve nga puna për shkak të shtatzënisë, lindjes së fëmijëve, pushim prindëror dhe pushimi për adoptim të fëmijës; dhe mbështetja e njëhershme financiare për të rinjtë (mosha 16-29 vjeçare). Një pjesë e rreziqeve të zbuluara me masat e drejtpërdrejta të lidhura me fëmijët janë mbuluar përmes masave indirekte, duke synuar punëtorët dhe familjet në tërësi. Subvencione për rrogat dhe kontributet sociale, relaksimi i kriterëve të përshtatshmërisë për të marrë ndihmë minimale të garantuar dhe ndihma e njëanshme financiare kanë

siguruar të ardhura minimale për jetesë, ndërsa fëmijët në këto amvisëri janë mbrojtur tërthorazi nga privimi material.

Për më tepër, masat indirekte e kanë mbuluar rrezikun e (mos) qasjes në shërbime për amvisëritë materialisht të privuara, përfshirë këtu edhe fëmijët, duke e: i) zgjeruar mbulimin shëndetësor për personat, të cilëve u është mohuar e drejta për sigurimi të detyrueshëm shëndetësor, që të mund t'i përdorin shërbimet shëndetësore që kanë të bëjnë me diagnostikimin dhe mjekimin nga koronavirusi përmes Fondit të Sigurimeve Shëndetësore, ii) prolonguar detyrimin e pagesës së qirasë për banesa sociale, dhe iii) siguruar para të gatshme për ta mbuluar një pjesë të kostos së konsumit të energjisë nga muaji prill deri në shtator të vitit 2020. Të gjitha këto masa i prekin fëmijët në mënyra të shumta: duke parandaluar që familja të bjerë në varfëri, duke siguruar që fëmijët të kenë qasje në testim dhe mjekim nga Covid-19, dhe duke siguruar qasje minimale në shërbime. Përgjatë mbulimit më të gjerë të rreziqeve, masat indirekte kanë implikime fiskale më të forta pasi gjysma e tyre nënkupton një lloj pagese nga qeveria.

**Tabela 1:** Masat e politikave që kanë të bëjnë me fëmijët në përballje me COVID 19

Rreziqet	Masa e politikave	Që synojnë (fëmijët)	Implikimet fiskale	Sektori (i fëmijëve)
<b>Masat e drejtpërdrejta të politikave të lidhura me fëmijët</b>				
<b>Rreziku i përhapjes së infeksionit</b>	Mbyllja e shkollave	Fëmijët e moshës shkollore	X	Arsimi
	Anulimi i provimit të Maturës shtetërorë	Të diplomuar nga shkolla e mesme	X	Arsimi
	Mbyllja e objekteve parashkollore	Fëmijët e moshës parashkollore	X	Arsimi
	Mbyllja e aktiviteteve jashtëmësimore	Të gjithë fëmijët	X	Arsimi
	Zgjatja e pushimit prindëror të paguar nga puna për shkak të shtatzënisë, lindjes së fëmijëve, prindërimit dhe adoptimit vazhdon të paguhet deri në skadimin e masave të përkohshme kundër përhapjes dhe parandalimit të COVID-19.	Të porsalindurit dhe fëmijët	√	Mbrojtja sociale
	Zgjatja e afateve të përcaktuara në ligjin për mbrojtjen e fëmijëve për lëshimin e kërkesës për ta përmbushur të drejtën për ndihmë financiare të njëhershme për të porsalindurin, kërkesës për përmbushjen/zgjatjen e të drejtës për ndihmë prindërore (fëmija i tretë dhe i katërt) dhe për ndihmën e veçantë të fëmijëve, si dhe për kriteret e kontrollimit të shkuarjes në shkollë për pagimin e shtesës arsimore.	Fëmijët	X	Mbrojtja sociale

<b>Rreziqet</b>	<b>Masa e politikave</b>	<b>Që synojnë (fëmijët)</b>	<b>Implikimet fiskale</b>	<b>Sektori (i fëmijëve)</b>
<b>Humbja e të ardhurave</b>	Mbështetje e njëhershme financiare përmes dhënies së një karte pagesore për blerjen e produkteve vendase në shumë prej 3,000 denarë	Të rinjtë e moshës 16-29 vjeçare të përfshirë në arsimin e rregullt (vetëm shkolla shtetërore)	√	Mbrojtja sociale
<b>Zvogëlimi i qasjes në shërbime</b>	Dispozitë për prindërit e punësuar (njëri prind nga çdo amvisëri) të fëmijëve deri në moshën 10 vjeç të lëshohen në pushim me pagesë	Prindërit e punësuar të fëmijëve të moshës 0-10 vjeçare	X	Mbrojtja sociale
<b>Përkeqësimi i procesit të mësimin</b>	Kalimi në mësim nga distanca	Fëmijët	X	Arsimi
	Arsimi përmes realizimit të mësimin në televizionin nacional	Children Fëmijët	X	Arsimi
<b>Masat e tërthorta të politikave të lidhura me fëmijët</b>				
<b>Rreziku i përhapjes së infeksionit</b>	Mbyllja e kufijve	Të gjithë qytetarët	X	Shëndeti
	Mbyllja e pjeseshme	Të gjithë qytetarët	X	Shëndeti
	Izolimi – karantina	Të infektuarit dhe persona që kanë qenë në kontakt me personat e infektuar	X	Shëndeti
<b>Humbja e të ardhurave</b>	Mbrojtja sociale gjatë gjendjes së jashtëzakonshme përmes kritereve të relaksuara të përshtatshëm për NMG	Amvisëritë materialisht të privuara me të ardhura më të ulëta se NMG	√	Mbrojtja sociale
	Ruajtja e punësimit përmes subvencionimit të kontributeve sociale për kompanitë e cenuara nga COVID-19, për muajt prill dhe maj 2020	Punonjësit në ndërmarrjet e prekura (afërsisht, ata me humbje të të ardhurave > 30%)	√	Mbrojtja sociale



<b>Reziqet</b>	<b>Masa e politikave</b>	<b>Që synojnë (fëmijët)</b>	<b>Implikimet fiskale</b>	<b>Sektori (i fëmijëve)</b>
	Ruajtja e punësimit përmes mbështetjes financiare për kompanitë e prekura nga kriza shëndetësore dhe ekonomike e shkaktuar nga KOVID-19, për pagimin e pagave për prill dhe maj të vitit 2020 në maksimum prej 14,500 denarë për punëtor	Punonjësit në ndërmarrjet e prekura (afërsisht, ata me humbje të të ardhurave > 30%), me pagë mesatare tre-mujore nën 39,900 denarë	√	Mbrojtja sociale
	Mbështetje financiare e njëhershme përmes dhënies së një karte pagesore për blerjen e produkteve vendore me vlerë prej 3.000 denarë (punëtorë me pagë të ulët) dhe 9,000 denarë (shfrytëzues të NMG-së dhe persona të papunë)	Individë me të ardhura të ulëta, shfrytëzues të NMG-së dhe të papunë	√	Mbrojtja sociale
	Zgjerimi i mbulimit të përfitimit të papunësisë përmes rregullave të relaksuara të pranueshmërisë	Të gjithë individët që kanë humbur vendin e punës nga 11 mars deri më 30 prill	√	Mbrojtja sociale
<b>Zvogëlimi i qasjes në shërbime</b>	Prolongimi i pagesës së qirasë për banesa sociale	Qiramarrësit e banesave sociale	X	Mbrojtja sociale
	Pagesa e parave të gatshme për të mbuluar një pjesë të koston të konsumit të energjisë për prill-shtator 2020	Amvisëri materialisht të privuara me të ardhura më të ulëta se NMG-ja	√	Mbrojtja sociale
	Mbulimi i zgjeruar shëndetësor	Të gjithë qytetarët	X	Shëndeti
<i>Burimi: Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut</i>				

## 2.1.2. Shpërndarja fiskale e shpenzimeve

Siç është potencuar në Tabelën 1, disa masa të politikave të Covid-19 kanë implikime financiare.

Zgjatja e lejes prindërore nga puna për shkak të shtatzanisë, lindjes së fëmijëve, prindërimit dhe adoptimit të fëmijës është masa e vetme e drejtpërdrejtë me implikime fiskale (përveç implikimit marginal për fëmijët 0-17 vjeçar e përkrahjes së njëanshme financiare për të rinjtë e moshës 16-29 vjeçare).

**Tabela 2** i paraqet të dhënat ekzistuese në lidhje me mbulimin dhe fondet e planifikuara ose të shpenzuara për masat Covid-19. Ajo sugjeron që afërsisht 1,6 milion euro janë shtuar në buxhet nga Fondi i Sigurimit Shëndetësor për ta mbuluar koston e zgjatjes së pushimit përkatës; kjo kosto mund të rritet nëse një shtrirje shtesë mandatohet në fillim të qershorit të vitit 2020. Rreth 2,200 përfitues janë duke u mbuluar me këto mjete. Shumica e fondeve janë shpenzuar për masat e mbajtjes së punës, të cilat gjithashtu kanë një mbulim të madh. Nga ana tjetër, mbulimi shtesë dhe shpenzimi për NMG mbetet shumë i ulët, të paktën deri në fund të majit, përkundër intensifikimit të dorëzimit të aplikimit në qershor të vitit 2020.

Tri tabelat e ardhshme e thellojnë analizën e efekteve të masave të politikave Covid-19 të fëmijët, duke parë shpërndarjen

e pagesave shtesë ndërmjet amvisërive me numër të ndryshëm të fëmijëve. Ne kemi simuluar kostot e tre grupeve të masave të politikave që i prekin fëmijët në mënyrë të tërthortë, siç janë: zbutja e kriterëve të NMG-së, masave për ruajtjen e vendeve të punës dhe mbështetja e njëhershme financiare. Për këtë simulim janë përdorë të dhënat e SILC-së për vlerësimin e ndikimit të shpërndarjes. Nuk janë bërë llogaritjet në lidhje me zgjerimin e përfitimit si rezultat i papunësisë, pasi që nuk janë observuar në SILC tranzicionet e tregut të punës (humbja e një vendi të punës) për lloje të veçanta të mbarimit të kontratës.

Siç potencon për llogaritja në **Tabelën 3** shpenzimet vjetore të simuluar nga NMG-ja para Covid-19 (përfshirë subvencionimin për energji) kanë arritur rreth 22 milion euro, ndërsa fuqia e kriterëve të zbutura vlerësohet në 6,6 milion euro mjete shtesë në nivel vjetor, pjesa më e madhe e rritjes shpjegohet me uljen e të ardhurave të individëve, sesa me kriteret e zbutjes së pronësisë. Duhet të theksohet se këto numra janë maksimumi teorik që nënkupton se të gjithë përfituesit e rinj aplikojnë për NMG. Për më tepër, është vërejtur menjëherë që shpenzimi i simuluar i NMG-së është më i ulët se realizimi, kryesisht për shkak të paaftësisë së simulimit

**Tabela 2:** Kostoja fiskale e masave të politikës Kovid-19

Masa e politikës	Periudha e mbuluar	Numri i përfituesve për shkak të Kovid-19	Kostoja mesatare për përfitues (denrë)	Shpenzimet totale për shkak të Kovid-19 (milion denrë)
Zgjatja e pushimit prindëror nga puna për shkak të shtatzënisë, lindjes së fëmijëve, prindërimit dhe adoptimit	11 mars – derisa të shfuqizohet	2,200 individë *	45,455	100*
Relaksimi i kriterëve për NMG-së, përfshirë zgjerimin e subvencionit për energji	1 prill – 31 maj 2020	231 amvisëri	10,767	2.5
Relaksimi i kriterëve për fitimin e të drejtës për përfitim si i papunë	11 mars – 30 prill 2020	3,796 individë **	17,327	49.8***
Ruajtja e vendeve të punës përmes mbështetjes financiare të kompanive me 14,500 denarë për punëtor	1–30 prill 2020	134,201 punëtorë	13,986	1,877.0
	1–31 maj 2020	124,054 punëtorë	13,792	1,733.2
	1-30 qershor 2020	79,219 punëtorë	13,935	1,103.9
Ruajtja e punësimit përmes subvencionimit të kontributeve sociale	1–30 prill 2020	2,531 kompani	n.a.	n.a.
	1–31 maj 2020	2,463 kompani	n.a.	n.a.
	1-30 qershor 2020	2,101 kompani	n.a.	n.a.
Mbështetje e njëhershme për individët me të ardhura të ulëta	Asistencë e njëhershme nga 1 qershori i vitit 2020	324,479 individë *	5,307	1,722*

*Burimi: Fondi i Sigurimit Shëndetësor; Zyra e të Ardhurave Publike; Ministria e Punës dhe Politikës Sociale; Agjencia e Punësimit.*  
 \* I referohet numrit të vlerëuar nga Qeveria.  
 \*\* iu referohet kërkesave për përfitimin e së drejtës për përfitim si rezultat i papunësisë vetëm për shkak të Vendimit përkatës, të paraqitur në AP. 2.957 kërkesa janë aprovuar deri më 2 korrik të vitit 2020, 1 është refuzuar, ndërsa 838 janë përpunuar.  
 \*\*\* Numrat i referohen vetëm kostos së aplikimeve të aprovuara.

për t'i kapur saktësisht kushtet e pronës dhe për t'i simuluar lejimet e njëfishta të lidhura me NMG-në. Sidoqoftë, me interes të veçantë është ndikimi diferencial, dhe jo vetë niveli si i tillë. Fondet shtesë të parapara për këtë masë janë shumë më lart se realizimi prill-maj 2020, i cili ka të ngjarë të jetë rezultat i vetëdijes shumë të ulët në lidhje me mbulimin e zgjeruar, veçanërisht midis më palëve vulnerable. Tabela gjithashtu paraqet ndikimin shpërndarës të fondeve shtesë që duhet të shpenzohen dhe zbulon se këto janë mjaft proporcionale me shpërndarjen e amvisërive sipas numrit të fëmijëve të tyre, me përjashtim të amvisërive me tre ose më shumë fëmijë. Këto amvisëri marrin ndjeshëm më shumë nga fondet shtesë në krahasim me hisen e tyre në kuadër të gjithë amvisërive, andaj masa e kësaj politikës mund të konsiderohet si e favorshme për fëmijët. Duke marrë parasysh që varfëria është më e larta në mesin e amvisërive me 3+ fëmijë, zgjerimi i NMG-së mund të konsiderohet fuqimisht në favor të të varfërve.

**Tabela 4** simulon koston mujore të masave të mbajtjes së punës, duke marrë parasysh rregullat e përcaktuara në vendimet përkatëse. Aktualisht, ato janë në fuqi për tre muaj, në mënyrë që kostoja totale e vlerësuar të jetë trefishi i asaj të paraqitur në tabelë. ILO / EBRD (2020)

e përdor klasifikimin e ndikimit sektorial prej 15 për qind, 35 për qind dhe 90 për qind për kompanitë e ndikuara mesatarisht, mbi mesatare dhe më lartë, përkatësisht kanë përjetuar ulje të të ardhurave që tejkalojnë 30 për qind. Për më tepër, supozohet se të gjitha kompanitë kanë zgjedhur ndihmën financiare prej 14,500 denarë për punëtor, ndërsa vetëm kompanitë për turizëm, për shërbime të hotelierisë dhe transportit i kanë shfrytëzuar të dy masat e parapara me vendimin qeveritar. Rezultatet sugjerojnë që masa përfshin rreth 181,000 punëtorë, që përfaqësojnë maksimumin teorik, mirëpo janë disi më lart se shifra e realizuar<sup>10</sup> nga rreth 124,000- 134,000 punëtorë. Në të njëjtën mënyrë, kostoja mujore e vlerësuar e cila dallon midis 37 dhe 43 milion euro, është mbi koston e realizuar prej 28.2 milion EUR për prill 2020 dhe 30.5 milion euro për maj 2020. Me rihapjen e ekonomisë, numrat ranë më tej në qershor 2020. Mbulimi i subvencionimit për kontribute sociale vlerësohet në rreth 20,000 punëtorë (rreth

<sup>10</sup>Mes tjerash shifra e realizuar ndryshon nga maksimumi teorik sepse nuk merr parasysh ndonjë efekt të sjelljes, siç mund të jetë një vendim i kompanive për të mos aplikuar edhe pse i plotëson kriteret, ose kompani të refuzuar për shkak të aplikimit me vonësë ose aplikimit të pakompletuar e kështu me radhë.

**Tabela 3:** Implikimet fiskale të zbutje së kritereve të përshtatshmërisë për NMG, sipas numrit të fëmijëve në amvisëri – të dhënat vjetore

Nuk ka fëmijë në amvisërinë përfituese	Hiseja e amvisërive	Shpenzim i simuluar bazuar në rregullat e vitit 2020 (mil. denarë)	Shpenzimet e simuluar me kritere të relaksuara (mil. denarë)	Fonde shtesë të nevojshme për shkak të Covid-19 (mil. denarë)	Hise e ndihmës sociale së Covid-19
<b>0</b>	62.4%	628.8	874.5	245.7	60.6%
<b>1</b>	17.0%	197.1	263.7	66.6	16.4%
<b>2</b>	14.2%	124.8	146.2	21.4	5.3%
<b>3</b>	4.5%	331.7	363.3	31.6	7.8%
<b>4 ose më shumë</b>	1.9%	82.8	123.2	40.4	10.0%
<b>GJITHSEJ</b>	<b>100.0%</b>	<b>1,365.2</b>	<b>1,770.9</b>	<b>405.7</b>	<b>100.0%</b>


*Burimi: Kalkulimet e autorëve të bazuar në SILC të dhënat e vitit 2018.*

3,000 ndërmarje) dhe 0,7 milion euro në muaj, që është gjithashtu mbi realizimin, megjithëse nuk u morrën informacioni mbi koston.

Analiza e shpërndarjes së ndikimit të masave të ruajtjes së punës, të paraqitura në Tabela 4 sugjeron që këto masa janë pak në favor të fëmijëve, pasi amvisëritë me një dhe dy fëmijë marrin hise më të madhe të fondeve kur krahasohen me pjesën e tyre në amvisëritë e përgjithshme. Ky rezultat nuk buron nga përcaktimi i vetë masave (dispozitat e të cilave nuk kanë lidhje me fëmijët), por me siguri nga fakti që prindërit janë të punësuar (në krahasim me beqarët e punësuar) të dhënë në pjesën e majtë të shpërndarjes së pagave.

Në fund, **Tabela 5** e paraqet koston e masës së pagesës së njëhershme. Kostoja e përgjithshme vlerësohet rreth

31 milion euro, duke qenë mbi parashikimin e qeverisë prej 28 milion EUR. Për sa i përket shpërndarjes, masa është po ashtu në favor të fëmijëve, pasi që pjesët më të larta proporcionale të fondeve shkojnë për familjet me fëmijë.



**Tabela 4:** Implikimet fiskale të masave të ruajtjes së vendeve të punës sipas numrit të fëmijëve në amvisëri – për muaj

Nuk ka fëmijë në amvisërinë përfituese	Hiseja e amvisërive	Punëtorët e prekur	Prej të cilëve: Punëtorë në sektorin e turizmit, transportit dhe shërbimeve të hotele-ri-së	Kosto-ja e masës 14,500 denarë (kufiri i ulët, mil. denarë)	Kosto-ja e masës 14,500 denarë (kufiri i lartë, mil. denarë)	Kosto-ja e ndihmës SIC50% në sektorët më të prekur (mil. denarë)	Hiseja e ndihmës për mbrojtje të punë-simit si rezultat i Kovid-19 (mesa-tarja)
<b>0</b>	62.4%	97,232	11,064	1,233.6	1,409.9	23.2	53.6%
<b>1</b>	17.0%	39,494	4,794	501.1	572.7	10.0	21.8%
<b>2</b>	14.2%	32,094	3,586	407.2	465.4	7.9	17.7%
<b>3</b>	4.5%	8,056	519	102.2	116.8	1.2	4.4%
<b>4 dhe më shumë</b>	1.9%	4,608	144	58.5	66.8	0.1	2.5%
<b>GJITHSEJ</b>	<b>100%</b>	<b>181,483</b>	<b>20,107</b>	<b>2,302.6</b>	<b>2,631.5</b>	<b>42.5</b>	<b>100%</b>

*Burimi: Llogaritjet e autorit të bazuara në SILC.*

*Shënim: Masa pre 14,500 denarë ka kufi më të ulët dhe më të lartë sepse nëse punëdhënësi vendosi të pushojë nga puna përkohësisht për shkak të forcës madhore, ai do të kishte të drejtë të paguante 50 për qind deri në 80 për qind të pagës. Për ta thjeshtësuar shpjegimin, në kufirin e ulët përdoret supozimi që gjysma e punëdhënësve do të kërkojnë 75 për qind të ndihmës financiare.*

**Tabela 5:** Implikimet fiskale të përgjithshme dhe shpërndarëse të mbështetjes financiare të njëhershme

Nuk ka fëmijë në amvisërinë përfituese	Hiseja e amvisërive	Fondet e shpenzuara për mbështetje njëhershme	Hiseja e mbështetjes së njëhershme për Kovid-19
<b>0</b>	62.4%	956.8	49.4%
<b>1</b>	17.0%	448.4	23.2%
<b>2</b>	14.2%	275.9	14.3%
<b>3</b>	4.5%	148.6	7.7%
<b>4 dhe më shumë</b>	1.9%	106.1	5.5%
<b>GJITHSEJ</b>	<b>100%</b>	<b>1,935.8</b>	<b>100%</b>

*Burimi: Llogaritjet e autorit të bazuara në SILC.*

## 2.2. PËRGJIGJA E POLITIKËS NDAJ KOVID-19 PËRMES RIALOKIMEVE TË BUXHETIT TË SHTETIT

Reagimi fillestar financiar i qeverisë ndaj shpërthimit të Kovid-19 përbëhej nga rialokimet e mjeteve brenda buxhetit ekzistuese. Më i rëndësishëm ishte fakti që Ministria e Shëndetësisë menjëherë i transferoi fondet nga programet preventive në masat e përgjigjes ndaj Kovid-19 të drejtuara nga Ministria e Shëndetësisë. Në këtë mënyrë u mundësua blerja e papenguar e materialeve mjekësore dhe pajisjeve për ofruesit. Fondi i Sigurimeve Shëndetësore gjithashtu ndau fonde për institucionet më të prekura të shëndetit publik në një shumë totale prej 1.3 milion euro. Kjo mbështetje përfshinte ofruesit e vijës së parë si Klinika e Sëmundjeve Infektive, Instituti i Shëndetit Publik, Qendrat e Shëndetit Publik, spitalet që ofrojnë mjekim të pacientëve të infektuar dhe ofruesit e tjerë që janë prekur drejtpërsëdrejti ose tërthorazi nga lëkundja fillestare.


Më vonë, në mes të majit 2020 u miratua plotësimi i buxhetit, duke imponuar rialokime më të mëdha ku u integruan rialokimet e mëparshme. Sigurisht meqenëse që ishin ruajtur, madje ishin rritur fondet për ta mbështetur reagimin e autoriteteve shëndetësore ndaj krizës, mes tjerash ishte

parashikuar një rritje dy-mujore prej 20 për qind të pagave të punëtorëve të kujdesit shëndetësor, rezultoi të ketë shkurtime të rëndësishme, të cilat i prekin fëmijët.

Një studim i kohëve të fundit (Petreski dhe Petreski, 2018) zbuloi se shpenzimet qeveritare për fëmijët para pandemisë nuk e kanë ndjekur rritjen e përgjithshme të shpenzimeve qeveritare. **Grafiku 1** konfirmon se fondet e përgjithshme të buxhetit të alokuara për programet për fëmijë janë rritur midis viteve 2000 dhe 2019, megjithëse përmasa e tyre në BPV dhe në shpenzimet totale të qeverisë kanë ngecën në rastin më të mirë. Megjithatë, plani i buxhetit para Kovid-19 për vitin 2020 ka parashikuar një rritje të shpenzimeve për fëmijë në 538.1 milion euro, që përfaqëson 4.9 për qind të BPV-së. Në mënyrë zhgënjyese plotësimi i Buxhetit në maj (2020) i mënjanoi fondet e alokuara për programet që kanë të bëjnë me fëmijët. Me tkurrjen e ekonomisë, shkurtimeve e tilla duken të vogla si një pjesë e BPV-së dhe në shpenzimet totale.


**Grafiku 2** e portretizon një fotografi më të qartë të plotësimit të buxhetit. Shpenzimet totale publike janë rritur si rezultat i nevojave urgjente për financimin e masave të politikave për t'u përballur me Kovid-19, por shpenzimet e planifikuara kanë rënë me 2.6 për qind për

**Grafiku 1:** Shpenzimet buxhetore për programet që kanë të bëjnë me fëmijët



*Burimi:* Ministria e Financave: Buxheti i shtetit për vitet 2010-2020.


**Grafiku 2:** Ndryshimet e shpenzimeve të parapara në plotësimin e buxhetit të vitit 2020



*Burimi:* Ministria e Financave: Buxheti i shtetit për vitin 2020 – Plani fillestar dhe plotësimi i buxhetit.



**Grafiku 3:** Ndryshimet e shpenzimeve të parapara në arsim, plotësimin i buxhetit në maj të vitit 2020



**Vërejtje:** Reduktimi i alokimeve në milion denarë është dhënë me ngjyrë të kuqe

**Burimi:** Ministria e Financave: Buxheti i shtetit për vitin 2020 – Plani fillestar dhe plotësimi i buxhetit.

programet arsimore dhe 0.6 për qind për mbrojtje sociale. Shpenzimet për programet shëndetësore për fëmijë janë rritur për 0.4 për qind.

**Grafiku 3** i jep në detaje rialokimet në arsim. Arsimi fillor ka qenë më i prekur me 26 për qind reduktim. Shpenzimet në arsimin e mesëm janë ulur për 14 për qind, ndërsa fondet për investime dhe për standardin e nxënësve për 12 për qind, gjegjësisht për 7 për qind. Sidoqoftë, duhet të theksohet se ulja e kostos mund të jetë gjithashtu rezultat i mbylljes së shkollës. Në fakt është shqetësuese që përkundër një nevojë të ngutshme për

zhvillimin e kapaciteteve të stafit, buxheti i Byrosë për Zhvillimin e Arsimit është ulur me 8 për qind, përfshirë shpenzimet për zhvillimin profesional të stafit në arsimin fillor dhe të mesëm. Megjithatë, pagat e stafit mbetën të paprekura, gjë që është veçanërisht sugjестive duke pasur parasysh që 85 për qind e shpenzimeve totale në arsim bëjnë pjesë në këtë kategori.


Kalimi në mësimin nga distanca dhe ndryshimi dramatik në shpërndarjen e mësimdhënies pas shpërthimit të Covid-19 mbetet një sfidë thelbësore për vitin e ardhshëm shkollor 2020/2021, veçanërisht pasi që shkurtime

në shpenzimet e planifikuara e mbajnë gjallë rrezikun e mungesës së fondeve në rast se rritet nevoja për investimet në mënyra alternative të mësimdhënies në shkollat fillore dhe të mesme.

Petreski dhe Petreski (2018) kanë paraqitur se edhe investimet para Kovid-19 në programet e zhvillimit (investime në infrastrukturë, arsim gjithëpërfshirës dhe projekte<sup>11</sup>) veç më ishin të

<sup>11</sup>Në dekadën e kaluar janë zbatuar masa të ndryshme; për shembull: një tablet për çdo fëmijë, internet në çdo shkollë, kompjuter për çdo fëmijë, testim të jashtëm, etj. Megjithatë, nuk është plotësisht e qartë nëse këto lloje të projekteve janë financuar nga “projektet” e linjës buxhetore.

**Grafiku 4:** Ndryshimet e shpenzimeve të parapara në programet arsimore, plotësimi i buxhetit në maj të vitit 2020





*Burimi:* Ministria e Financave: Buxheti i shtetit për vitin 2020- Plani fillestar dhe plotësimi i buxhetit.

margjinalizuara dhe nuk kishte ndryshime strukturore ndër vite për të përmirësuar këtë situatë. Ndryshimet e bëra nga plotësimi i buxhetit për vitin 2020 përsëri i lënë jashtë programet zhvillimore. Megjithëse uljet e shpenzimeve nuk janë dramatike, shkurtimeve në komponentin e zhvillimit janë të rëndë (**Grafiku 4**). Ulja më e madhe në terma absolute buron që nga programet me fonde më të mëdha të alokuara. Investimet në infrastrukturën e shkollave fillore dhe të mesme janë reduktuar ndjeshëm. Kjo sigurisht e ngushton aftësinë e Qeverisë për të investuar në nevoja të reja dhe urgjente për përshtatjen fizike të shkollave si rezultat i pandemisë. Për më tepër arsimit gjithëpërfshirës ka pësuar një goditje të rëndë nga Kovid-19, pasi që zvogëlimi i fondeve të alokuara fillimisht ka qenë në shkallë befasuese prej 95 për qind. Si rezultat, nxënësit e cenueshëm mund të humbasin qasjen në shërbimet e ofruara në atë program të veçantë. Shpenzimet për mbrojtje sociale për fëmijë janë ulur për 0.6 për qind (**Grafiku 5**, tabloja e sipërm). Sidoqoftë, për dallim nga shkurtimeve në shpenzimet e arsimit, shpenzimet e përgjithshme të mbrojtjes sociale kryesisht janë ruajtur. Përderisa ky duket se është një hap pozitiv, ai në të vërtetë mund të jetë një reflektim i mungesës së masave të drejtpërdrejta të politikave për fëmijët, që përmbajnë implikime

fiskale (shiko Tabelën 1). Për më tepër, shtesat fëmijërore dhe rrogat e stafit janë ruajtur në bazë të komponentit për zhvillim të mbrojtjes sociale të fëmijëve: fondet për ndërtimin, pajisjen dhe mirëmbajtjen e institucioneve parashkollore dhe atyre të mbrojtjes së fëmijëve janë zvogëluar për 24 për qind (Grafiku 5, tabloja e poshtme). Ashtu si në rastin e sektorit të arsimit, shkurtimeve të tilla të shpenzimeve i tkurrin kapacitetet e financimit të institucioneve parashkollore për t'u përshtatur në mes të krizës së vazhdueshme dhe valës së dytë të mundshme të pandemisë gjatë vjeshtës.

Shpenzimet shëndetësore për fëmijët janë ulën për 0.4 për qind (**Grafiku 6**), kryesisht për shkak të rialokimit të rritjes së buxhetit të Fondit të Sigurimit Shëndetësor. Grafiku i pasqyron shpenzimet gjatë Kovid-19, përfshirë masën e politikës për zgjatjen e pushimit të prindërve me pagesë nga puna për shkak të shtatzënisë, lindjes së fëmijëve, prindërimit dhe adoptimit. Shpenzimet për sëmundje të rralla kanë qenë pika e vetme që kanë shënuar ulje.


**Grafiku 5:** Ndryshimet e plotësimit të buxhetit në shpenzimet e planifikuara për mbrojtje sociale të fëmijëve, plotësimit i buxhetit në maj të vitit 2020



**Vërejtje:** Reduktimi i alokimeve në milion denarë është dhënë me ngjyrë të kuqe.


**Burimi:** Ministria e Financave: Buxheti i shtetit për vitin 2020 – Plani fillestar dhe plotësimi i buxhetit.

**Grafiku 6:** Ndryshimet e plotësimit të buxhetit në shpenzimet e planifikuara për programet shëndetësore



**Vërejtje:** Reduktimi i alokimeve në milion denarë është dhënë me ngjyrë të kuqe.

**Burimi:** Ministria e Financave: Buxheti i shtetit për vitin 2020 – Plani fillestar dhe plotësimi i buxhetit.



### 2.3. KAPACITETI FISKAL PËR ZBUTJEN E EFEKTEVE TË KOVID-19

Pandemia e Kovid-19 e ka nxitur qeverinë të vë në zbatim masa politike për ta përmirësuar dhe zbutur efektet negative të pandemisë. Sipas ILO/EBRD (2020), shërbimet ushqimore dhe të pijeve, shitja me pakicë, transporti, deponimi, shërbimet personale, prodhimi i ushqimit, ndërtimi dhe aktivitetet e specializuara përkatëse, si dhe shërbimet ndaj ndërtesave kanë qenë sektorët më të prekur. Tre të katërtat e punonjësve dhe kompanive në Maqedoninë e Veriut janë goditur. Bizneset e vetëpunësimit dhe mikrobizneset janë në një situatë kritike (Financial Think, 2020), pasi ato ose janë mbyllur plotësisht ose është dashur ta zvogëlonin në mënyrë drastike aktivitetin e tyre, përderisa kishte amortizim të ulët të krizës. Zhvillime të tilla ndikuan negativisht në buxhetin e shtetit. Për shkak të zvogëlimit të aktivitetit ekonomik, të ardhurat buxhetore janë ulur ndjeshëm në prill dhe maj, me një parashikim të një rënie vjetore prej 11.5 për qind në krahasim me planin fillestar të buxhetit 2020 (Ministria e Financave, 2020). Nga ana tjetër, qeveria i ka rritur shpenzimet buxhetore që ndërliken me krizën e Kovid-19. Efekti i dyanshëm e goditi fuqishëm deficitin buxhetor në 6.8 për qind

të BPV-së, krahasuar me planin fillestar prej 2.4 për qind, duke e bërë atë një rritje absolute prej 529 milion euro. Për më tepër, ekziston një nevojë financiare e ngurtë që rrjedh nga shlyerja e borxhit të huamarrjes së huaj që arrin në 1.2 miliardë euro, gjatë dy viteve të ardhshme, nga të cilat 477 milion euro për vitin 2020. Ishte e qartë që në fillim të krizës në mars se nevoja për huamarrje ishte rritur menjëherë, dhe se huazimi në vend e kufizon ndjeshëm hapësirën për zhvillimin e politikës monetare të lirshme. Prandaj pasi përpjekja e parë për të marrë hua nga tregjet private (e ashtuquajtura kredi "urë-për-obligacion") prej rreth 400 milion euro dështoi për shkak të kushteve të shtrëngimit të shpejtë, u bë e mundur që Maqedonia e Veriut ta shfrytëzojë kuotën e saj brenda FMN-së prej 176 milion dollarë. Menjëherë, Banka Botërore e riorganizoi dritaren e saj të huamarrjes prej 140 milion dollarë, si dhe pasuan veprime të tilla nga EBRD dhe BE-ja. Pas përmirësimit të kushteve të tregut, Ministria e Financave lëshoi në fund të majit një eurobond në vlerë prej 700 milion euro. Ndonëse i siguruan nevojat për financim, këto lëvizje e rritën borxhin publik, me vlerësimet që shkonin nga 56 në 58 për qind deri në fund të vitit 2020, nga 48 për qind që ishte një vit më parë. Këto masa në fakt paraqesin një barrë të konsiderueshme, pasi që një rezultat i tillë e kufizon

hapësirën fiskale për investime të rëndësishme publike dhe ofrimin e shërbimeve publike në planin afatmesëm.

Pasoja të tilla fiskale të krizës Kovid-19 do ta kufizojnë hapësirën fiskale afatmesme për programet që kanë të bëjnë me fëmijët.

Duke marrë parasysh modelin e sjelljes së hartimit të buxhetit dhe përparësisë së investimeve në dekadën e fundit, komponenti zhvillimor i lidhur me fëmijët është në rrezikun më të lartë për të pësuar shkurtime dhe rialokim, veçanërisht investimet në ndërtimin dhe rindërtimin e objekteve parashkollore dhe shkollore, si dhe fondet e synuara në ngritjen e cilësisë së ofrimit të shërbimit. Për më tepër, do të ketë nevoja të intensifikuara për burime shtesë (burime njerëzore, materiale, aftësi të buta, digjitalizim) për t'u përballur me çdo efekt të vazhdueshëm të Kovid-19 në edukimin e hershëm të fëmijëve, shkollimin dhe kujdesin shëndetësor të fëmijëve.

Vlerësimi i nevojave identifikoi bazat e ndryshme për secilin sektor. Përfaqësuesit nga sektori arsimor nxorën në pah nevojat për qasje më efektive në internet dhe aftësi të buta për stafin mësimdhënës që duhet të mbajë mësim nga distanca. Për shkak të strukturës së moshës së stafit mësimdhënës, që shpesh anon kah moshë më e vjetër, mbetet një sfidë kryesore pajisja e pamjaftueshme e stafit me

aftësi digjitalizimi- përdorimi dhe ndërrimi nga njëra në platformën tjetër të internet, përgatitja dhe ngarkimi i materialeve, si dhe shpërndarja në kohë reale e mësimdhënies. Një punonjës arsimor deklaroi:

“TË GJITHË KEMI DISA NJOHURI PËR INTERNETIN, POR KEMI NEVOJË PËR NJË TRAJNIM TË THELLUAR DHE GJITHËPËRFSHIRËS TË MËSIMIT NË DISTANCË. PËR T’IA SIGURUAR PERSONELIT MËSIMDHËNËS ATË ... NUK MJAFTON NJË SEMINAR NJË OSE DY DITËSH, POR NEVOJITET NJË TRAJNIM AFATGJATË”.

Një ekspert i fushës pajtohet që përmirësimi i kapaciteteve dhe aftësive për arsimin në distancë është përparësia më e lartë, megjithëse theksoi se realizimi i mësimin në distancë duhet të jetë i unifikuar në të gjithë sistemin:

“AKTUALISHT, KEMI RASTE TË IZOLUARA KUR, PËR SHEMBULL, NË PËRLEP DHE STRUMICË, MËSUESIT MBAJTËN KLASA TË VËRTETA NË INTERNET DHE FËMIJËT E DININ SE ATA DO TË JENË “NË KLASË” MIDIS ORËS 9 TË MËNGJESIT DHE 12 TË DARKËS. SIDOQOFTË, KY NUK ËSHTË RASTI ME TË GJITHA SHKOLLAT, ME TË GJITHË MËSUESIT DHE ME TË GJITHË FËMIJËT!”

I njëjti përfundim doli nga Byroja për Zhvillimin e Arsimit, i cili thotë:

“NË DUHET TË JEMI TË PËRGATITUR PËR ZGJATJEN E MUNDSHME TË MËSIMDHËNIES NË DISTANCË, NË MËNYRË QË ME KOHË T’I TRAJNOJMË MËSUESIT, NDËRSA TRAJNIMI I TILLË DO TË FILLONTE TANI DHE DO TË ZGJASË DERI SA TË NISË VITI TJETËR SHKOLLOR”.

Oasja në internet dhe pajisjet teknike janë të rëndësishme për fëmijët dhe stafin mësimdhënës. Po aq e domosdoshme është të sigurohet që të gjithë ata të kenë qasje në një platformë të licencuar dhe të unifikuar në internet. Kjo nënkupton investime të vazhdueshme për azhurnimin e platformës ekzistuese. Për më tepër, duhet të përmirësohet mekanizmi i koordinimit midis të gjithë palëve të përfshira në procesin e mësimin në distancë. Sigurisht që mësimi në distancë duhet ta rritë nevojën për burime shtesë gjatë muajve të verës së vitit 2020, që ka të ngjarë të krijojë një presion të mëtejshëm fiskal ndaj buxhetit pas shkurtimeve në sektorin e arsimit, si rezultat i ndryshimit dhe plotësimit të buxhetit të majit të vitit 2020.

Në sektorin e mbrojtjes sociale janë identifikuar lloje të ndryshme të nevojave, mirëpo prioriteti kryesor është nevoja për t'i përshtatur objektet parashkollore sipas protokolleve të mësimin nga distanca. Palët e interesuara të përfshira në hartimin e politikave i potencuan sfidat kryesore:

"NË KOPSHTET E FËMIJËVE, GRUPE JANË TË MËDHA, VEÇANËRISHT PËR FËMIJËT E MOSHËS 3-6 VJEÇARE. SIPAS PROTOKOLLIT, DUHET TË RUHET DISTANCË PREJ 1.5 DERI NË 2 METRA MIDIS TAVOLINAVE. PRANDAJ, PËRSHTATJA E HAPËSRËS SË KOPSHTETEVE PËR LE TË THEMË GRUPE MË 20 FËMIJË MBETET NJË SFIDË KRITIKE".

Përshtatja do të jetë veçanërisht sfiduese duke marrë parasysh shkurtimeve e investimeve në infrastrukturën arsimore në plotësimin e buxhetit të vitit 2020.

Përpos kësaj, mbyllja e objekteve parashkollore ndikon në ofrimin e shërbimeve sociale në vend, për shkak të mungesës së stafit. Përfaqësuesi i Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale (MPPS) përmend se ka pasur vështirësi në ofrimin e shërbimeve si rezultat i burimeve të kufizuara njerëzore të nënkuptuara nga shfrytëzimi i pushimit të prindërve të fëmijëve deri në moshën 10 vjeçare. Përveç kësaj, si burimet njerëzore ashtu edhe ato financiare janë identifikuar si të pamjaftueshme për dispozitat dhe shërbimet tjera të mbrojtjes sociale.

"BURIMET NJERËZORE JANË GJITHMONË TË NEVOTSHME, VEÇANËRISHT GJATË KOHËS SË PANDEMISË. PËR SHEMBULL, KA PASUR RASTE KUR TË GJITHA EKIPET KANË SHKUAR TË PUNOJNË JASHTË OBJEKTIT, GJË QË NUK KISHTE NDODHUR KURRË MË PARË".

Disa sektorë social të radhës së parë për përballje me krizën e Covid-19, veçanërisht Sektori për mbrojtje sociale brenda MPPS-së dhe Qendrat e Punës Sociale, i identifikuan nevojat për një koordinim më të madh institucional dhe bashkëpunim me autoritetet lokale. Prandaj burimet e theksuara të Qendrave të Punës Sociale duhet ta menaxhojnë ndikimin e krizës të fëmijët më të rrezikuar.




Nevoja për pajisje mbrojtëse personale për parandalimin e infeksionit është më e lartë në sektorin e shëndetësisë. Pajisjet mbrojtëse kryesisht përbëhen nga rrobat e veshura për të mbrojtur punonjësit e kujdesit shëndetësor, siç janë: dorezat, maska, manteli ose kominosheja, mburoja e fytyrës, mbulesat e kokës, çizmet e gomës, dezinfektuesit. Mjekët e përgjithshëm të anketuar për këtë analizë përmendën se sasia e pajisjeve mbrojtëse thelbësore të ofruara nga Ministria e Shëndetësisë ka qenë e pamjaftueshme. Për më tepër janë rritur çmimet e këtyre mallrave ndërsa punonjësit e shëndetësisë shpeshherë kanë qenë në situatë që vetë t'i blejnë këto pajisje:

**“NE VETË I KEMI SIGURUAR PAJISJET MBROJTËSE DHE VËRTETË KA QENË E VËSHITËRË, ... NUK KEMI DONACIONE, NDËRSA ÇMIMET E MASKAVE JANË SHUMË TË LARTA. PRANDAJ, RRIJTJA RROGAVE TONA PËR 15 PËR QIND SHKON NË SHPENZIME PËR MBROJTJE NGA KORONA”.**

Sidoqoftë, në këtë pikë, vlen të përmendet se janë intensifikuar donacionet nga BE, vendet e tjera, agjencitë e zhvillimit, sektori i korporatave dhe qytetarët (kryesisht për artikujt që mungojnë). Deri në fillim të qershorit të vitit 2020 shuma totale e donacioneve ka arritur në 3,3 milion euro.

Nga diskutimi në fjalë nënkuptohet që në përgjithësi do të intensifikohet presioni financiar, veçanërisht mbi shpenzimet dhe programet kanë të bëjnë me fëmijët, veçanërisht nëse kriza zgjatet edhe në vjeshtë. Nevojat financiare në rritje në të tre sektorët (arsimi, kujdesi shëndetësor dhe mbrojtja sociale) do të përballen me hapësirën e kufizuar fiskale dhe rritjen e deficitit buxhetor dhe borxhit publik. Vendosija e synimeve të shpenzimeve për vitet e ardhshme në fushat kryesore të ndërlidhura me fëmijët mund të ndihmojë në planifikimin afatmesëm dhe zbutjen e efekteve negative të krizës Covid-19 te fëmijët. Në veçanti, politikëbërësit duhet të synojnë në ruajtjen e shpenzimeve në linjat buxhetore, që korrespondojnë me shpenzimet e ndërlidhura me fëmijët, të paktën në nivelin e buxhetit fillestar të vitit 2020.





### 3. FËMIJËT QË PËRBALLEN ME RREZIQE SOCIALE DHE BIEN NË VARFËRI

Rreziqet sociale dhe sfidat e përjetuara nga fëmijët në Maqedoninë e Veriut gjatë pandemisë Kovid-19 janë të drejtpërdrejta dhe të tërthorta. Rreziqet e drejtpërdrejta sociale janë shkaktuar nga mbyllja e ambienteve të kujdesit ditor, përfshirë objektet parashkollore, shkollat, si dhe qendrat e kujdesit ditor, siç janë ato për fëmijët me aftësi të kufizuara. Lëvizshmëria e kufizuar ka ndikuar gjithashtu drejtpërdrejt në të drejtat dhe nevojat e fëmijëve pa prindër dhe përkujdesje prindërore ose fëmijë nga prindërit e divorcuar për të vendosur kontakte të rregullta me të afërmit e tyre ose me prindin,

i cili e ndan të drejtën prindërore. Rreziqet indirekte shoqërohen me humbjen e vendit të punës ose uljen e mundësive ekonomike në mesin e anëtarëve të familjes, duke çuar në rritjen e pasigurisë financiare si dhe rrezikun e varfërisë dhe privimit material midis fëmijëve.

Ky kapitull e vlerëson ofrimin e shërbimeve sociale, si dhe kërkesën për dhe përfitime në para dhe shpërndarjen e tyre për fëmijët dhe/ose familje me fëmijë gjatë muajve të parë të pandemisë Kovid-19 (mars-maj 2020). Kapitulli synon ta përcaktojë llojin e rreziqeve sociale, si dhe profilin

e kategorive të cenueshme të fëmijëve në Maqedoninë e Veriut gjatë pandemisë, në mënyrë që këto rreziqe dhe dobësi të mbështeten lehtësisht gjatë valës së dytë të pritur të kësaj pandemie, ose gjatë krizës së ardhme, që përfshin rreziqe të shumta për mirëqenien e fëmijëve. Në një pjesë të veçantë, kapitulli bën një vlerësim sasior të asaj se si shkalla e varfërisë së fëmijëve mund të ketë evoluar si rezultat i Kovid-19.

### 3.1. SHËRBIMET PËR FËMIJËT DHE FAMILJET GJATË KOVID-19

**Edukimi dhe kujdesi në fëmijëri të hershme.** Që nga 11 marsi i vitit 2020 janë mbyllur të gjitha objektet parashkollore për kujdesin dhe edukimin e fëmijëve në Maqedoninë e Veriut (kopshtet, qendrat për zhvillimin e hershëm të fëmijëve), me qëllim të parandalimit të përhapjes së Kovid-19. Kjo prek gati 40,000 fëmijë, të cilët janë të përfshirë në këtë formë të kujdesit dhe edukimit në 109 institucione parashkollore (Enti Shtetëror i Statistikës, 2019).

Mbyllja e objekteve parashkollore për shkak të pandemisë ka ndodh në një periudhë kur Qeveria është përpjekur të zgjerojë infrastrukturën parashkollore dhe përfshirjen e fëmijëve në këto institucione të edukimit dhe kujdesit, veçanërisht në zonat

rurale dhe në mesin e romëve, duke përshtatur infrastrukturën publike në dispozicion me programe të shkurtra për fëmijët e moshës parashkollore (Programi për zhvillimin e mbrojtjes së fëmijëve në vitin 2020). Të dhënat nga Hulumtimit në klaster me më shumë indikatorë (MICS) për 2018-19 tregojnë se vetëm 45.8 për qind e fëmijëve në Maqedoninë e Veriut, një vit më të vegjël se moshë zyrtare për regjistrim në shkollë filllore e ndjekin programin për edukim në fëmijëri të hershme. Përfshirja ulët në edukimin në fëmijëri të hershme është evidente në mesin e fëmijëve të zonave rurale (27.9 për qind), fëmijët nga amvisëritë më të varfra (10.4 për qind) dhe fëmijët, kryeamvisi i të cilëve është i etnisë shqiptare (5.4 për qind). Përderisa amvisëritë më të rrezikuara e kanë vështirë t'ia dalin gjatë pandemisë, përkeqësimi i mëtutjeshëm i qasjes në edukimin kujdesin fëmijëri të hershme, veçanërisht në mesin e këtyre amvisërive, ngel një rrezik immanent.

Përveç pengimit të qasjes së penguar në objektet parashkollore, pandemia e ka përkeqësuar edhe sigurimin e ushqimit dhe/ose varfërinë ushqimore të fëmijët. Sipas Eurostat, në vitin 2018, 49.5 për qind e fëmijëve të moshës 16 vjeçare e më të rritur janë përballë me varfëri ushqimore (ose paaftësi për t'u furnizuar me ushqim me mish, pulë, peshk ose

barasvlerë të tyre vegjetariane për çdo të dytën ditë). Kjo përqindje ishte edhe më e lartë në mesin e grupmoshës 16 deri në 24 vjeç me 57 për qind. Qasje falas në kopshtet e fëmijëve, përfshirë vaktet falas, u sigurohet fëmijëve nga familjet që janë prekur nga një fatkeqësi natyrore (d.m.th. zjarri, përmytja ose tërmeti), si dhe për fëmijët nga familjet me një prind të vetëm që janë përfitues të NMG-së. Për më tepër, rreth 200 fëmijë romë janë gjithashtu përfitues të shërbimit të qasjes falas në arsimin parashkollor, bazuar në një projekt midis Fondit Rom, Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale dhe komunave në vend. Të dhënat e fundit të dipsonueshme nga Enti Shtetëror i Statistikës tregojnë se në vitin 2017 nga të gjithë fëmijët në institucione parashkollore dhe qendrat për zhvillimin e hershëm të fëmijëve vetëm 1.75 për qind ishin përfitues të një asistence të tillë (Enti Shtetëror i Statistikës, 2018). Burim i njëjtë tregon se 19.2 për qind e fëmijëve ishin nga amvisëritë, në të cilat punonte vetëm njëri prind, ndërsa 3.4 për qind ishin me të dy prindërit e papunë.

Për ta ndihmuar kujdesin e fëmijëve gjatë pandemisë, Qeveria e miratoi një vendim për lirim nga puna (mes tjerash) të: prindërve të vetëm, njërit nga prindërit e punësuar të fëmijëve deri në moshën 10 vjeçare, si dhe prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara që i frekuentojnë

qendrat e kujdesit ditor. Për më tepër, Qeveria e miratoi një vendim (Gazeta Zyrtare nr.90/2020) për zgjatjen e pushimit të lehonisë deri në fund të masave për parandalimin e Kovid-19 për të gjitha nënat që janë të punësuar (shiko Pjesën 2.1.1).

Përgatitjet për rihapjen e sigurt të institucioneve parashkollore sipas protokolleve të përcaktuara shëndetësore dhe në kushte të një infrastrukture të kufizuar, përfshinin një hulumtim të realizuar anekënd vendit nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale me prindërit e fëmijëve të të gjitha kopshtet publike. Sondazhi vlerësoi strukturën e fëmijëve që kanë nevojë të kthehen menjëherë në kopsht dhe fëmijët që do të ktheheshin pas përfundimit të masës për lirim e një prindi nga puna. Shefi i Sektorit për mbrojtjen e fëmijëve në Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale prezantoi rezultatet, sipas së cilave vetëm 22 për qind të prindërve me fëmijë në kopshte për fëmijë e kanë potencuar nevojën e menjëhershme për shërbimet e kujdesit në kopsht, ndërsa 45 për qind janë përgjigjur se fëmijët e tyre do të ktheheshin pas pezullimit të masës për lirim të njërit prind. Rezultati i këtij sondazhi tregon se shqetësimet për shëndetin midis prindërve mund të kontribuojnë në ulje të mëtutjeshme të përfshirjes në institucione për edukim dhe kujdes në fëmijëri të hershme.

**Qendrat ditore.** Si me rastin e me institucionet dhe ente tjera, pandemia i mbylli edhe qendrat ditore në vend. Për dallim nga transferimet e parave të gatshme, këtu mungon një bazë e të dhënave të harmonizuara nacionale të përfituesve dhe ofruesve të shërbimeve sociale, gjë që e pamundëson analizën e profilit të fëmijëve (d.m.th. përkatësinë etnike, vendndodhjen, moshën, etj.) të prekur nga bllokimi. Sipas një hulumtimi për vitin 2018 (Bogoevska et al. 2019), kishte 370 ofrues të shërbimeve sociale në Maqedoninë e Veriut, nga të cilat 47.8 për qind për familjet kujdestare, 18.6 për qind qendra ditore, 9 për qind për shërbime të këshillimit dhe 1.9 për qind për qendrat e strehimit. Bazuar në të dhënat<sup>12</sup> e Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale, ekzistojnë 25 qendra ditore për fëmijë me aftësi të kufizuara, me afro 400 përfitues, përfshirë edhe të rritur me aftësi të kufizuara. Ata vizitohen nga fëmijë të moshës 5-18 vjeçare, duke u siguruar një kujdes 8-orësh për çdo ditë.

Ndër ato që u mbyllën ishin qendrat ditore dhe klubet shoqërore për adoleshentë dhe të rritur me aftësi të kufizuara intelektuale të mbështetur nga Qendra e Republikës "Poraka" në Shkup (Aerodrom dhe Kapishtec), Radovish, Përlep dhe Shtip. Pas mbylljes ata i adaptuan aktivitetet e tyre, në mënyrë që të kryheshin në shtëpi përmes telefonit,

videove dhe komunikimit online. Një përfaqësuesi i Qendrës për Mbështetjen e Personave me Aftësi të Kufizuara "Poraka" mes tjerash shpjegoi se këto aktivitete përfshinin:

"KRYERJEN E AKTIVITETEVE PROGRAMORE NË SHËTËPI PËRMES UDHËZIMEVE DHE DETYRAVE QË I MBAJNË NË FUNKSION AFTËSITË DHE MUNDËSITË E PËRFITUESVE, TË MONITURUARA INDIVIDUALISHT PËR SECILIN PËRFITUES PËRMES TELEFONATAVE OSE VIDEO THIRRJEVE; MBËSHTETJEN E DREJTPËRDREJTË PSIKOSOCIALE (KËSHILLA, ARSYETIM, INKURAJIM PËR KËPTIM MË TË LEHTË DHE PËRBALLJE ME SITUATËN) PËR PËRFITUESIT DHE PRINDËRIT E TYRE PËRMES VIDEOVE OSE KOMUNIKIMIT TELEFONIK; SI DHE MBËSHTETJEN PSIKOSOCIALE PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA INTELEKTUALE DHE FAMILJET E TYRE, PËRMES NJË LINJE TELEFONIKE".

<sup>12</sup>Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Qendrat e kujdesit ditor për fëmijët me paaftësi,: [link](#), qasur më 5 qershor, 2020.

Përveç mbylljeve, fëmijët që i përdorin qendrat ditore janë prekur edhe nga kufizimi i lëvizjes, që u është caktuar në orë të veçanta të ditës. Përderisa qeveria iu përgjigj kërkesës fillestare për t'i përjashtuar organizatat e personave me aftësisë së kufizuar nga kufizimet e lëvizjes, megjithatë një lëvizje e tillë e kufizuar bie ndesh me nevojat terapeutike të fëmijëve të shoqëruar me aktivitet fizik dhe detyra në natyrë. Lëvizshmëria e kufizuar ndikoi gjithashtu në lëvizjen e rregullt të ofruesve të kujdesit dhe ndihmësve personalë, gjë që përkeqësoi më tej sigurimin e kujdesit për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Përgjatë krizës së pandemisë, qendrat ditore morën mbështetje aktive nga organizata ndërkombëtare qeveritare, donatorët e huaj si dhe OJQ-të e vendit. Në këtë drejtim, partneriteti i vazhdueshëm midis UNICEF-it, OJQ-së Open the Windows (Hapni dritaret) dhe Ambasadës Britanike në Shkup, rezultoi në trajnime për stafin e qendrave të kujdesit ditore që kanë të bëjnë me hartimin e procesit të tranzicionit të qendrave të kujdesit ditore në qendrat e mbështetjes së komunitetit për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe familjet/kujdestarët e tyre.

## Qendrat për strehim të viktimave të dhunës familjare.

Rritja e rasteve të raportuara të dhunës në familje që nga marsi i vitit 2020 është ndër pasojat më të dukshme të masave të bllokimit. Sipas statistikave të Ministrisë së Brendshme, "krahasimi midis rasteve të raportuara gjatë muajve prill-maj në vitin 2020 dhe atyre periudha në vitin 2019 tregon për një rritje prej 44.6 për qind."<sup>13</sup> Nga të gjitha rastet e dhunës në familje të raportuara në 30 Qendrat e Punës Sociale nga 15 mars deri në 7 qershor të vitit 2020, fëmijët përbëjnë 9.6 për qind të rasteve/viktimave (**Grafiku 7**).

Nga puna e Ekipit të Specializuar për trajtimin e rasteve urgjente të kategorive të cenueshme, nën juridiksionin e Qendrës Ndërkombëtare për Punë Sociale të Shkupit u zbulua se

"90 PËR QIND E RASTEVE NË DY MUJTT E FUNDIT KANË TË BËJNË ME DHUNËN NË FAMILJE, NË TË CILAT FËMIJËT NUK ISHIN DREJTPËRDREJT VIKTIMA, POR MEGJITHATË KËRKUAN MBROJTJE."


Të dhënat e ekipit treguan gjithashtu se rritja është e konsiderueshme në krahasim me rastet e raportuara në të kaluarën,

"KUR KISHTE NJË OSE DY THIRRJE NË JAVË, NDËRSA TANI KISHTE 4-5 THIRRJE NË DITË QË KANË TË BËJNË ME DHUNËN NË FAMILJE."

<sup>13</sup>Pravdiko, Komunikatë për shtyp, : [link](#), qasur më 10 qershor, 2020.



**Grafiku 7:** Rastet e dhunës familjare të raportuara nga Qendrat e Punës Sociale



*Burimi:* Ministry of Labour and Social Policy, June 2020

Gjithashtu edhe OJQ-të që ofrojnë këshillime dhe mbështetje për grupet e cënueshme raportuan raste të neglizhencës, abuzimit dhe sulmeve seksuale të fëmijëve. Sipas të anketuarit nga OJQ-ja Shoqata Maqedonase e Avokatëve të Rinj, profili i fëmijëve që raportohet se vuajnë nga pakujdesia dhe abuzimi është nga 0 deri në 5 vjeç, ndërsa mosha e fëmijëve viktime të sulmit seksual është nga 13 deri në 15 vjeç. Ata po ashtu konstatuan se shumica

e rasteve ishin të personave me prejardhje etnike rome dhe maqedonase, ndërsa për sa i përket lokacionit shumica e rasteve ishin raportuar në Shkup.

Për t'iu përgjigjur rritjes së dhunës familjare, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale (MPPS) hapi linja falas të telefonit<sup>14</sup> dhe vuri në dispozicion për publikun telefonat dhe adresat e Qendrave të Këshillimit për Viktimat e Dhunës në Familje në tetë rajone statistikore në vend. Njashtu MPPS-ja në bashkëpunim me Misionin e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) në Shkup në maj dhe qershor të vitit 2020 dhuruan pako ushqimore për 329 viktima të regjistruara të dhunës familjare.<sup>15</sup>

Qendrat dhe strehimoret për viktimat e dhunës në familje janë dezinfektuar rregullisht, sipas protokolleve dhe praktikave shëndetësore për ta minimizuar përhapjen e Kovid-19. Nga të gjitha rastet e raportuara të dhunës familjare gjatë marsit deri në qershor 2020, vetëm një numër i vogël (11 gra dhe 5 fëmijë) i kanë shfrytëzuar shërbimet e qendrës për strehim. Nga përvoja e qendrës për strehim nga dhuna në familje, pjesë e Qendrës së Punës Sociale në Shkup, gjatë tre javëve të para të pandemisë, qendra për strehim ka ofruar mbështetje për viktimat vetëm përmes telefonit. Pastaj me vetëm një të tretën kapaciteteve njerëzore personeli i qendrës u kthye dhe vazhdoi të sigurojë këshillime dhe shërbime edhe me kontakte fizike. Me mbështetjen e donatorëve, qendra për strehim siguroi pako

ushqimore për viktimat aktuale dhe ish viktimat e regjistruar të dhunës në familje. Rastet e dhunës në familje janë raportuar përmes policisë, përmes OJQ-ve dhe vetë viktimave. Raportet që kanë të bëjnë me dhunën ndaj fëmijëve zakonisht shoqëroreshin me dhunë ndaj nënave me fëmijë të mitur, të cilët sipas Ligjit konsiderohen gjithashtu viktima të drejtpërdrejta. Njëra nga sfidat e identifikuar në punën me viktimat e dhunës në familje gjatë pandemisë ishte mungesa e bashkëpunimit me autoritetet shëndetësore, të cilët nuk i pranonin klientët e tyre për trajtim psikologjik ose mjekësor, përveç nëse ata kishin një urdhër gjyqësor (siç tregohet në një intervistë me një të anketuar nga një Qendër për Punë Sociale, Shkup).

---

<sup>14</sup>Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Njoftim për shtyp për viktimat e dhunës në familje: [link](#), qasur më 10 qershor të vitit 2020.

<sup>15</sup>Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Njoftim për shtyp për mbështetjen e viktimave të dhunës në: [link](#), qasur më 10 qershor të vitit 2020.



OJQ-të që punojnë në fushën e parandalimit të dhunës në familje i kanë përkrahur masat qeveritare për heqjen e kufizimeve të lëvizjes për viktimat e dhunës në familje, si dhe masat speciale për mbrojtjen nga kryerësi i aktit të dhunës në familje.<sup>16</sup> Janë mbajtur takime të koordinuara në internet midis OJQ-ve dhe MPPS-së për t'i raportuar dhe ndjekur nga afër zhvillimet aktuale në lidhje me dhunën në familje.

### **Qendra për Punë Sociale.**

Përkundër transformimit të punës dhe deri diku edhe zvogëlimit të burimeve njerëzore (për shkak të shfrytëzimit të masave qeveritare për lirim nga puna), Qendrat e Punës Sociale (QPS-të) vazhduan të ofrojnë shërbime sociale gjatë krizës. Klientët ishin në gjendje të paraqisnin aplikime të reja, si për përfitimet në para, po ashtu edhe për shërbimet sociale. QPS-të ishin të qasshme si fizikisht po ashtu edhe përmes telefonit. Përvojat e tyre zbulojnë se protokollin e kufizimit të pandemisë dhe lëvizshmërisë e ka theksuar cenueshmërinë e fëmijëve në disavantazh, por edhe e ka penguar realizimin e të drejtave shoqërore veç më të përvetësuar. Shumica e ankesave gjatë pandemisë kishin të bënin me pamundësinë e realizimit të drejtës së prindërve për të kaluar kohë me fëmijën, në rastin e prindërve të divorcuar. QPS-të nuk ishin në gjendje të ndikojnë në

situatën e tillë përmes thirrjeve telefonike, kështu që thirrjet për ndërgjegjësimin publik u bënë përmes MPPS për mbështetje më të madhe të ndërgjegjësimit shëndetësor të prindërve (të divorcuar) që përballeshin me sfidën për të kaluar kohë me fëmijën gjatë pandemisë.

QPS-të iu ndihmuan fëmijëve nga amvisëritë përfituese të asistencës financiare, veçanërisht atyre nga vendet rurale që nuk ishin në gjendje të marrin pjesë në procesin e mësimin të distancë, për shkak të mungesës së internetit dhe kompjuterëve. Në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, janë shpërndarë kartelat e internetit me parapagim për ta ndihmuar përfshirjen e këtyre fëmijëve në procesin arsimor. Mbështetje të njëjtë u mundësua edhe përmes QPS-ve në bashkëpunim me Kryqin e Kuq dhe komunitet. Paketat ushqimore iu janë shpërndarë amvisërive përfituese të ndihmës financiare që janë me njërin prind, si dhe viktimave të dhunës në familje.

<sup>16</sup>Rrjeti nacional kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, Vlerësimi i masave të ndërmarra: [link](#), qasur më 10 qershor, 2020.

Ekipi i specializuar për trajtimin e rasteve urgjente të kategorive të cenueshme nga Qendra Ndër-Komunale për Punë Sociale në Shkup tregoi se kanë e pranuar thirrjet për intervenim gjatë orëve të lëvizjes së kufizuar kishin të bënë me fëmijët e moshës 12-16 vjeçare, kryesisht nga komuniteti rom dhe nga amvisëritë në rrezik shoqëror.

Gjatë pandemisë, ka pasur ankesa nga qytetarët që nuk kanë pasur mundësi t'i kontaktojnë disa QPS përmes telefonit. Sipas Zëvendës Avokatit të Popullit, ankesat kishin të bënin me pamundësinë për të marrë informacion në lidhje me kriteret për të drejtat e zgjeruara financiare nga sistemi i mbrojtjes sociale, për pagesat e vonuara të të drejtave financiare, pamundësinë për t'i paraqitur dokumentet e aplikimit si dhe pamundësinë për ta realizuar të drejtën për të kaluar kohë me fëmijën, në rastin e prindërve të divorcuar. Si përgjigje ndaj çështjes që prindërit të kalojnë kohë me fëmijën, Avokati i Popullit e dorëzoi një Rekomandim për Qeverinë, në të cilin theksohet që:

- MPPS-ja dhe QPS-ja duhet ta monitorojnë rregullisht dhe në mënyrë të vazhdueshme mënyrën dhe dinamikën e ushtrimit të së drejtës për marrëdhënie personale dhe kontakte ndërmjet fëmijëve dhe prindit me të cilët nuk jetojnë, dhe të veprojnë në përputhje me rrethanat, duke e

respektuar parimin e interesit më të mirë të fëmijës; dhe

- në rastet kur prindërit janë të penguar në ushtrimin e së drejtës për ta parë fëmijën me të cilin nuk jetojnë, për shkak të lëvizjes së kufizuar, do të marrë masa dhe për t'iu lejuar atyre t'i marrin fëmijët dhe t'i kthejnë te prindi me të cilin jeton fëmija, duke e bërë këtë në përputhje me vendimin e autoriteteve për kohën e prindërimit dhe duke i respektuar protokollet për sigurimin e standardeve higjienike dhe standardeve tjera.<sup>17</sup>

Për më tepër, Avokati i Popullit ua dërgoi një kërkesë me shkrim të gjitha QPS-ve, si dhe të gjitha objektet rezidenciale dhe jo-rezidenciale, të cilat ofrojnë akomodim dhe shërbime për fëmijët, për të marrë informacione në lidhje me realizimin e të drejtave të fëmijëve gjatë pandemisë, përfshirë kontaktet e tyre, protokollet e miratuar të sigurisë, numrin e personelit, etj. Të dhënat e marra aktualisht janë duke u analizuar dhe do të vihen në dispozicion të publikut përmes zyrës së Avokatit të Popullit dhe kanaleve të tij zyrtare të komunikimit.

<sup>17</sup>Avokati i Popullit i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Rekomandime të Avokatit të Popullit për realizimin e të drejtave të fëmijëve gjatë gjendjes së jashtëzakonshme: [link](#), qasur më 10.06.2020

## Shërbimet për mbështetje, këshillim dhe zhvillim të fëmijëve.

Pandemia ka bërë presion të konsiderueshëm edhe për familjet kujdestare, duke prekur edhe prindërit kujdestarë dhe fëmijët. Raportet bëjnë me dije raskapitje të prindërve kujdestarë për shkak të nevojës së jashtëzakonshme për mbështetje arsimore gjatë mësimin nga distanca. Gjithashtu janë raportuar raste të dhunës nga bashkëmoshatarët në mesin e fëmijëve nën kujdestari, siç zbulohet nga përfaqësuesi i Programit SOS Fshati i Fëmijëve. Vizitat e drejtpërdrejta të fëmijëve të adoptuar ishin të ndaluar gjatë pandemisë. Ndonëse kjo masë ishte rezultat i protokolleve qeveritare të shëndetit kundër përhapjes së Covid-19, prapëseprapë kjo e pengoi realizimin e të drejtave të fëmijëve dhe të drejtat e prindërve dhe farefisit të tyre biologjik. Gjatë pandemisë nuk janë realizuar vizitat nga QPS-të për ta monitoruar gjendjen e fëmijëve në kujdestari, gjë që mund ta pengojë identifikimin e rreziqeve në kohë të duhur.

Në njësitë e banimit për jetesë të mbështetur, të rinjve pa prindër dhe pa përkujdesje prindërore u është dhënë gjithashtu ndihmë nga edukatorët. Ata iu ofruan ndihmë të rinjve në bërjen e detyrave të shtëpisë dhe në projektet shkollore. Njashtu është siguruar këshillimi psikosocial

në përputhje me nevojat e tyre. Të rinjtë që jetojnë në këto njësi banimi morën pjesë në trajnime online lidhur me aftësitë e jetës, me qëllim që të kenë kohë të lirë cilësore dhe t'i përforcojnë aftësitë e tyre.

Qendrat e këshillimit për prindërit dhe fëmijët kanë qenë aktive gjatë pandemisë. Nga përvoja e këtyre qendrave në komunat Gazi Baba dhe Shuto Orizari shërbime e ofruara përfshijnë (intervistë me përfaqësuesit e OJQ-së Megjashi - Ambasada e Parë e Fëmijëve dhe koordinatori i linjës telefonike falas të SOS Megjashi):

- Ndihmë për linjën telefonike për mbështetje psikologjike dhe sociale dhe këshillime për të gjithë anëtarët e familjes;


- Dorëzimi i paketave humanitare (produkte themelore ushqimore, produkte të higjienës personale, si dhe dezinfektues);

- Dhurimi i pelenave, qumështit të përshtatur dhe artikujve të higjienës bazë për të porsalindurit;

- Dhurimi i tabletave për fëmijët e moshë shkollore për ta lehtësuar mësimin në distancë.

Linja telefonike SOS e siguruar nga OJQ Megjashi- Ambasada e Parë e Fëmijëve, e cila ekziston që nga themelimi i kësaj

organizate, ka shënuar rritje të thirrjeve telefonike nga prindërit dhe fëmijët. Nga të dhënat e kësaj organizate, lloji i ndihmës së kërkuar gjatë pandemisë përfshinte informacione në lidhje me ndarjen e kohës së prindërve (të divorcuar), lëvizjen e lejuar për prindërit me fëmijë autikë gjatë orës policore, ndihmën në tejkalimin e barrierave me punëdhënësit në marrjen e lejeve për lirim nga puna, si dhe ndihmë për prindërit e papunë që i kanë humbur punën gjatë pandemisë.



### 3.2. PËRGJIGJA FINANCIARE E SISTEMIT TË MBROJTJES SOCIALE DHE TË FËMIJËVE GJATË KOVID-19

Përhapja e pandemisë Kovid-19 ka ndodhur pothuajse një vit pas miratimit të ligjit të ri për mbrojtjen sociale dhe ndryshimit të ligjit për mbrojtjen e fëmijëve. Kjo mund t'i dëmtojë pritjet e parashikuara të sistemit të reformuar të mbrojtjes sociale dhe të fëmijëve, siç është ulja e nivelit të varfërisë, veçanërisht varfëria e fëmijëve, si dhe rritja e aktivizimit midis përfituesve të garantuar të ndihmës minimale. Në fakt, pandemia e ka rritur kërkesën për mbrojtje sociale dhe mbrojtje të fëmijëve në kontekstin e zvogëlimit të kapaciteteve të Qendrave të Punës Sociale.

Siç është paraqitur në Pjesën 2.1.1, qeveria e ka miratuar vendimin për: ta zbutur kriterin për fitimin e së të drejtës për ndihmë minimale të garantuar, subvencionimin e energjisë, asistencën mbi bazë të aftësisë së kufizuar dhe asistencën me para për ndihmën dhe kujdesin e një personi tjetër; zgjatjen e kohëzgjatjes së të drejtave financiare të skaduara nga mbrojtja e fëmijëve; dhe zgjerimin e kriterit për personat e papunë, puna e të cilëve është ndërprerë me marrëveshje, me kërkesë ose ndërprerje të kontratës së punës

dhe të personave të papunë me regjistrim të parregullt në Agjencinë e Punësimit.

QPS-të kanë ngelë të hapura përgjatë gjithë pandemisë, duke pranuar vazhdimisht aplikime për të drejtat financiare nga mbrojtja sociale dhe e fëmijëve. Dy persona nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale ishin pjesë e Qendrës për thirrje telefonike në kudër të Sekretariatit të Përgjithshëm të Qeverisë; ata ishin në dispozicion në telefon për t'iu përgjigjur kërkesave dhe nevojave për informacion shtesë rreth procedurave dhe dokumenteve të dorëzuar për aplikim për të drejtat rreth mbrojtjes sociale dhe mbrojtjes së fëmijëve.


Që nga miratimi i kriterëve të modifikuar për ta fituar të drejtat e mbrojtjes sociale dhe të mbrojtjes së fëmijëve ka pasur 3,690 kërkesa të reja për ndihmën minimale të garantuar, që është 13.3 për qind e përfituesve aktual; 40.3 për qind e tyre kanë qenë amvisëri me fëmijë. Kërkesa për shtesë fëmijërore ka qenë më e ulët me 800 kërkesa, që përfaqësojnë 4.5 për qind të përfituesve realë. Kërkesa është rritur në qershor të vitit 2020 kur përkatësisht janë dorëzuar 3.525 aplikime për NMG dhe 1.522 për shtesë fëmijërore, me gjasë për shkak të një grupi faktorësh si rritja e numrit të personave të papunë, skadimi i kompensimit financiar nga

sigurimi i papunësisë, fundi i masave bllokuese, ndërjegjësimi më i madh në lidhje me kriteret e ndryshuara të NMG-së midis aplikuesve të rinj, etj.

Sidoqoftë, rritja e kërkesës nuk është përcjellë automatikisht nga rritja e përfituesve realë (të aprovuar), andaj numri i amvisërive që marrin NMG është rritur vetëm me 231 (0.8 për qind e përfituesve të hises, Grafiku 8). Arsyet e marrjes më të ulët mund të jenë të shumta: procedurat më të gjata administrative të verifikimit të pranueshmërisë së aplikuesit, aplikimi për të drejta tjera financiare (p.sh. ndihma për


papunësi nga AP-ja), mungesa e vetëdijes për ndryshimin e kriterëve të kushteve midis popullatës më të ndjeshme, etj. Ngjashëm rregullat e pandryshuara për shtesë fëmijërore dhe pezullimi i kërkesave për asistencë arsimore gjatë pandemisë bënë që të ngelin këto shifra, edhe pse ato ishin rritur në mënyrë të konsiderueshme me reformën qershorit të vitit 2019. Analiza e profilit të aplikuesve të rinj për NMG sipas përkatësisë etnike (**Grafiku 9**) tregon se numri më i madh i kërkesave të reja që u trefishuan midis marsit dhe majit 2020 ishte nga radhët e amvisërive shqiptare.

**Grafiku 8:** Përfituesit e ndihmës minimale të garantuar (NMG), shtesës fëmijërore dhe asistencës arsimore, mars-maj 2020




**Burimi:** Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Sistemi i Informimit për Përfitimet në të holla, qershor 2020 \* Aplikimi për asistencë arsimore nuk ka qenë i mundshëm për tremujorin e fundit (prill-qershor)


**Grafiku 9:** Aplikuesit e rinj për NMG sipas përkatësisë etnike, vetëm amvisëritë me fëmijë



**Burimi:** Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Sistemi i Informimit për Përfitimet në para, qershor 2020



**Grafiku 10:** Aplikuesit e rinj për NMG sipas numrit të fëmijëve për amvisëri



*Burimi:* Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Sistemi i Informimit për Përfitimet në para, qershor 2020


Po ashtu, në prill është rritur edhe numri i aplikuesve të rinj romë. Zhvillime të tilla mund të lidhen me përhapjen e lartë të punës joformale midis disa etnive, si dhe me shkallën shumë të ulët të aktivitetit të tregut të punës midis grave shqiptare.

Mbi bazë të observimeve të numrit të fëmijëve në amvisëri (**Grafiku 10**), shumica e kërkesave të reja (49.6 për qind) burojnë nga amvisëritë me një fëmijë. Kjo disi sugjeron që përpara pandemisë amvisëritë e tilla të janë shfaqur më rrallë në sistem, gjë që deri në një farë mase përputhet me nivelet e varfërisë

pasi ato janë më të lartat midis 3+ amvisërive. Familjet me një prindër përfaqësonin vetëm 1.6 për qind të të gjithë aplikuesve për NMG dhe asistencë në të holla. Shumica e tyre kanë aplikuar për të drejtën e shtesës fëmijërore, ndërsa numri i aplikimeve të tyre është rritur në maj të vitit 2020. Më tej numrat zbulojnë një rritje të vazhdueshme të kërkesave për ndihmë të fëmijëve midis amvisërive maqedonase me një fëmijë (**Grafiku 11**). Nga ana tjetër, amvisëritë e përkatësisë etnike shqiptare treguan kërkesë të madhe në fillimin e krizës në mars të vitit 2020, ashtu që



**Grafiku 11:** Aplikuesit e rinj për NMG sipas numrit të fëmijëve për amvisëri, mbi bazë të përkatësisë etnike




**Burimi:** Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Sistemi i Informimit për Përfitimet në para, qershor 2020

kërkesat e tyre përfaqësonin 36 për qind të të gjitha aplikimeve në amvisëritë me numër të caktuar të fëmijëve. Megjithatë, për dallim nga amvisëritë maqedonase, amvisëritë e etnisë shqiptare me tre dhe më shumë fëmijë dorëzuan numër më të madh të kërkesave. Situata ka qenë e përzier në mesin e amvisërive rome.

Në bazë të vendbanimeve, shumica e aplikuesve për NMG vinin nga Gostivari (14.5 për qind), Tetova (9 për qind)- të dy zonat kryesisht të banuara me shqiptarë; pastaj nga Shuto Orizari (7,8 për qind)- zonë e banuar me romë; dhe nga Kisella Voda, komunë e Shkupit (7.5 për qind). Sipas të dhënave nga QPS në Shuto Orizarë, shumica e aplikuesve

romë gjatë pandemisë kanë qenë punëtorë joformalë, të cilët- për shkak të bllokimit- kishin ngelë pa punë dhe pa të ardhura. Shumica e kërkesave për përfitim në të holla janë pranuar në Kumanovë (10.5 për qind), Veles (8.8 për qind) dhe Manastir (7.9 për qind).



### 3.3. SIMULIMI I IMPAKTIT TË KOVID-19 NDAJ VARFËRISË SË FËMIJËVE

Kjo pjesë vlerëson se si shkalla e varfërisë së fëmijëve mund të ketë evoluar si rezultat i Kovid-19. Nën pjesë e parë e përshkruan qasjen metodologjike; e dyta i përcakton supozimet e modelit; e treta i paraqet rezultatet; kurse e katërta i diskuton efektet e mundshme të pandemisë në disa indikatorë të varfërisë jomonetare.

#### 3.3.1. Qasja metodologjike

TKy vlerësim i varfërisë së fëmijëve nën Kovid-19 e përdor modelin e taksave dhe përfitimeve nga MK-MOD për Maqedoninë e Veriut. Ky është një model statik sipas së cilit sjellja individuale (veprimtaria e tregut të punës, punësimi, kujdesi i fëmijëve, kursimi, etj.) supozohet të jetë me burim të jashtëm ndaj sistemit të përfitimeve tatimore. Ky i përket grupit të modeleve statike “standarde” ku individët/amvisëritë zgjedhin të furnizojnë me punë (orë pune) deri në pikën kur “pabarazia margjinale e punës është e barabartë me barazinë margjinale të të ardhurave të disponueshme (neto të taksës)” (Saez, 2010, f.180). Në këtë kontekst, taksat dhe transferimet sociale ndikojnë në sjelljen e tregut të punës, duke ndryshuar vlerën relative të punës në raport

me kohën e lirë. Vlerësimi i MK-MOD është prezantuar në Petreski dhe Mojsoska-Blazevski (2017).

MK-MOD mundëson simulimin e ndihmës sociale, shtesat fëmijërore, përfitimet e papunësisë, taksat e drejtpërdrejta dhe kontributet e sigurimeve sociale. Me qëllim të ushtrimit të modelimit në këtë studim, mbështetemi në një grup të kufizuar të veçorive të MK-MOD, ku arsyeja kryesore është se ne rivendosim modelin në SILC 2018<sup>18</sup>. Prandaj, i simulojmë pagat nga punësimi, përfshirë pagat joformale; të ardhurat nga vetëpunësimi; dhe modelimin e tyre të taksave dhe kontributit shoqëror; pastaj edhe të ardhura e garantuara minimale dhe shtesën fëmijërore dhe arsimore. Kjo do të thotë që kategoritë e mëposhtme të të ardhurave dhe taksat e shoqëruara nuk janë modeluar nga modelimi aktual, por janë marrë siç raportohet në SILC 2018: të ardhura nga kapitali (qiratë dhe dividendët); pensionet; përfitimet e papunësisë; dhe transferimet e parave në amvisëri. Nuk ka pasur ndonjë ndryshim në trajtimin tatimor të të ardhurave nga kapitali midis viteve 2018 dhe 2020, ndërsa shkalla e kontributit pensional është rritur me një kumulativ të një pikë përqindje, andaj ne e trajtojmë këtë si efekt i papërfillshëm në të ardhurat nga paga dhe aktualisht e injorojmë.

<sup>18</sup>MK-MOD origjinale është ndërtuar sipas Sondazhit të vetë mbi cilësinë e jetës 2017.

Sidoqoftë, ekzistojnë dy vërejtje të rëndësishme. E para lidhet me përfitimin e papunësisë, të cilën ne nuk e simulojmë sepse supozon informacione mbi angazhimin dhe rrogën e kaluar e punonjësit, i cili e ka humbur vendin e punës. Përveç kësaj kriteri i përfitimit për shkak të papunësisë është mjaft i rreptë dhe nëse përfundimi i kontratës ndodh me kërkesë të punonjësit ose me marrëveshje të ndërsjellë, personi i papunë nuk e përmbush kriterin e duhur. Asnjë nga këto informacione nuk gjendet në SILC dhe nuk e parandalon simulimin. Së dyti, MK-MOD është një model statik, andaj nuk vëzhgohet kalim nga punësimi në papunësi. Nga ana pozitive, të dhënat ekzistuese administrative nga Agjencia Punësimit sugjerojnë se numri i të papunëve të regjistruar është rritur nga 105.816 në shkurt të vitit 2020 në 121,187 në maj të të njëjtit vit, që në fakt është një numër relativisht i papërfillshëm i njerëzve që e kanë humbur vendin e punës: më pak se 2 për qind e të gjithë të punësuarve në Maqedoninë e Veriut. Gjatë së njëjtës periudhë, kërkesat për përfitime për shkak të papunësisë janë rritur nga 4,719 në 7,186, madje rritja është arritur në fillim të majit, pasi qeveria e kishte përcaktuar ripunësimin e stafit të liruar nga puna gjatë pandemisë si kusht i pranueshmërisë për ndihma qeveritare për bizneset.

Vërejtja e dytë ka të bëjë me skemën e reformuar të ndihmës sociale, siç prezantohet në Seksionin 1. Ndryshimi strukturor ka ndodhur në maj të vitit 2019, duke supozuar potencialisht çdo rezultat që e bazojmë në SILC 2018. Prandaj, në model, ne nuk i marrim parasysh përfitimet sociale të shpërndara në vitin 2018 dhe i zbatojmë rregullat e sistemit aktual të ndihmës sociale për t'i zëvendësuar ato në të ardhurat e disponueshme të familjeve. Pengesa qëndron në faktin që nuk mund të kapet saktësisht kërkesa për amvisëritë e privuara materialisht por mbështetemi në indikatorin nëse familja ka të ardhura nga qiraja, andaj e përdorim atë si kriter kufizimi të përjashtimit. Disavantazhi i kësaj qasjeje është se duhet t'i lëmë jashtë simulimit të gjitha shtesat që kanë të bëjnë me aftësinë e kufizuar (përveç korigjimit të NMG-së për aftësinë e kufizuar dhe prindërit e vetëm) dhe përfitimet njëhershme, pasi ne nuk kemi informacion në SILC, që të mund t'i simulojmë kriteret e tyre të pranueshmërisë. Përderisa e simulojmë shtesën prindërore (shtesën për fëmijën e tretë) me testin e mjeteve të prezantuar me reformën e vitit 2019, ne nuk e përfshijmë shtesën e vjetër jo-të testuar që do largohet gradualisht, deri në vitin 2029. Sidoqoftë ne jemi në gjendje të vëzhgojmë shumë efekte të reformës së ndihmës sociale dhe, mbi të gjitha, efektin e Kovid-19.

### 3.3.2. Supozimet

Pakoja vijuese e supozimeve është përdorë në një ushtrim simulues.

Komponenti kyç i të ardhurave të amvisërive janë të ardhurat nga rrogat (formale). Supozimi kritik në lidhje me sjelljen e tyre gjatë Kovid-19 mbështetet në ekspozimin e sektorëve ndaj ndikimit të krizës. Ky informacion është marrë si i gatshëm në ILO/EBRD (2020), Shtojca 2, përmes së cilës sektorët në nivel 2-shifrom të Klasifikimit statistikor të aktiviteteve ekonomike (NACE<sup>19</sup>, Rev.2) janë dhënë si vlera numerike nga 1 deri në 5, ku 1-shi potencon se nuk ka ndikim aspak, ndërsa 5- a ndikim të plotë (mbyllje e plotë). Skema e supozimeve vijuese zbatohet:

- Të gjithë sektorët e prekur më së shumti (5) janë mbyllur, si rezultat i kësaj punonjësit marrin 50 për qind të pagës minimale mbi 2 muaj, ndërsa për pjesën tjetër merret paga minimale;

- Të gjithë sektorët e goditur mbi nivelin mesatar (4) i kanë ulur pagat në nivelin e pagës minimale gjatë 2 muajve, ndërsa për pjesën tjetër paga është ulur për 20 për qind;

- Të gjithë sektorët e prekur në nivelin mesatar (3) përballen me ulje të pagave 20 për qind për 2 muaj, ndërsa për pjesën tjetër pagat janë ulur për 5 për qind;

- Të gjithë sektorët me nën nivelin mesatar (2) përballen me ulje të pagave prej 10 për qind gjatë 2 muajve, ndërsa për pjesën tjetër nuk ka ulje pagash;

- Të gjithë sektorët e goditur më së paku (1) mbeten të paprekur.

Duhet të theksojmë se ILO / EBRD (2020) e raporton ndikimin për 39 nga 89 sektorët 2 shifrorë të NACE Rev.2, megjithëse mbulon pothuajse 92% të të gjithë të punësuarve. Kjo do të thotë që edhe pse ndikimi nuk është vlerësuar për 50 sektorë, ata sektorë punësojnë vetëm 8% të numrit të përgjithshëm të të punësuarve. Prandaj, ne bëjmë një supozim arbitrar që ndikimi për këta sektorë ka qenë nën mesatarisht (2), në mënyrë që ato të paraqiten në simulimin tonë pa shkaktuar ndonjë dëm ose dobi statistikore.

Skema tjetër është supozim për të vetëpunësuarit:

- Të gjithë të vetëpunësuarit në sektorët e goditur më shumti (5) janë mbyllur (të ardhurat nga vetëpunësimi janë ulur në zero) gjatë 2 muajve, ndërsa për pjesën tjetër të ardhurat janë ulur me 30 për qind;

<sup>19</sup>Shkurtesa NACE buron nga frëngjishtja Nomenclature statistique des activités économiques dans la Communauté européenne.

- Të gjithë të vetëpunësuarit në sektorët e goditur mbi mesatare (4) i kanë përgjysmuar të ardhurat për mbi 2 muaj dhe 20 për qind për pjesën tjetër;

- Të gjithë të vetëpunësuarit në sektorë të goditur mesatarisht (3) i kanë ulur të ardhurat për 25 për qind gjatë 2 muajve dhe 10 për qind për pjesën tjetër;

- Të gjithë të vetëpunësuarit në sektorë të prekur në nivelin mesatar (2) i kanë ulur të ardhurat me 10 për qind gjatë 2 muajve dhe nuk kanë pasur asnjë zvogëlim për pjesën tjetër;

- Të gjithë të vetëpunësuarit në sektorë e goditur më së paku (1) kanë ngel të paprekur.

Për një numër të vogël të rasteve, për të cilat sektori i vetëpunësimit nuk ishte dhënë në SILC, supozohej një ulje arbitrare prej 10 për qind e të ardhurave.

Të gjithë të punësuarit të sektorit joformal (siç vlerësohet për ekzistimin e kontratave me shkrim dhe me gojë) supozohet se janë ndikuar rëndë përmes 60 për qind të reduktimit të të ardhurave të tyre.

Supozimi në lidhje me të ardhurat minimale të garantuara buron nga vendimi për zbatimin e ligjit të mbrojtjes sociale, me ç'rast janë zbutur kriteret për vlerësimin e

privimit material të amvisërive (shiko Pjesën 2.1.1), që në SILC mund të përafrohet me heqjen e kriteri për të mos pasje të ardhura nga qiratë. Ky është një supozim shumë i fortë sepse zbutja e kriterëve nënkupton që amvisëria mund të zotërojë një pasuri të patundshme në të cilën jeton, një makinë më të vjetër se 5 vjet dhe një parcelë ndërtimi nën 500 m<sup>2</sup>, të gjitha këto më parë kishin qenë pengesë. Prandaj, sipas kriterëve të zbutura, posedimi i pasurive të tjera të patundshme ose të tundshme përpos këtyre ngel kriter përjashtimi. Por, ne jemi të detyruar ta simulojmë këtë sepse SILC nuk përmban informacione kaq të hollësishme për posedimin e pasurisë. Prandaj, supozojmë se heqja e komponentit të qirasë së të ardhurave si kriter do të imitojë heqjen e kriterëve të lartpërmendura të përshtatshmërisë. Në kategorinë e pranuesve të NMG-së e simulojmë shtrirjen e mbështetjen rreth shpenzimeve për energji nga 6 në 12 muaj.

Sidoqoftë, kriteret e zbutura janë më të fuqishme në një aspekt tjetër: një amvisëri mund të hyjë në sistemin NMG duke u bazuar në të ardhurat e fituara në muajin paraprak para aplikimit (në vend se të bazohen në mesataren e 3 muajve të mëparshëm). Kjo nënkupton që në sistem mund të hyjnë me shpejtësi të gjitha amvisëritë, të ardhurat e të cilave në treg janë goditur rëndë nga

pandemia, përfshirë ato që kanë humbur të ardhurat joformale. Prandaj, humbjet e të ardhurave nga tregu i punës në supozimet e mëparshme i mbështesin kriteret (pragun e të ardhurave) për marrjen e NMG-së.

Supozimi në lidhje me të ardhurat e tjera buron nga vendimi për ndihmë financiare të njëhershme të qytetarëve dhe të punësuarve me të ardhura të ulëta dhe të rinjve. Vendimi përcakton shpërndarjen e ndihmës në para të gatshme prej 9,000 denarëve për personat më të vjetër se 18 vjet, të cilët jetojnë në amvisëri, përfituese të ndihmës sociale (NMG dhe shtesa të tjera) si dhe kërkuesve aktivë të punës të regjistruar në AP; ndihmë të njëhershme në para prej 3.000 denarë për punonjësit, të ardhurat e të cilëve burojnë vetëm nga punësimi dhe që nuk i kalojnë 15,000 denarë në muaj; dhe ndihmë të njëhershme në të holla në vlerë prej 3,000 denarë për nxënësit dhe studentët e moshës 16-29 vjeçare të cilët janë në arsim të rregullt publik. Vëmë re se të ardhurat e simuluar mund të mbivlerësohen paksa sepse SILC nuk përmban informacione nëse kërkuesit aktivë të punës janë regjistruar në AP e as nëse arsimiti (veçanërisht i studentëve) ka qenë i rregullt (studentët të rregullt) dhe vetëm në universitetet shtetërore.

Ne e realizuam një test të përgjithshëm për të gjitha këto

supozime duke i krahasuar të ardhurat mesatare të disponueshme para Kovid-19 (të parashikuara nga SILC 2018) dhe ato pas Kovid-19, kur të gjithë kriteret e mësipërme janë zbatuar dhe simuluar të ardhurat e fituara nga amvisëria. Rezultatet janë paraqitur në Tabelën 6 dhe ato sugjerojnë që në supozime të tilla, të ardhurat mesatare të disponueshme për një anëtar të rritur të amvisërisë do të binin me 6.4 për qind pas Kovid-19.

Rezultatet janë paraqitur në **Tabelën 6** dhe sugjerojnë që nën supozim të tillë mesatarja të ardhurave të disponueshme për anëtarët e rritur të amvisërisë do të bien për 6.4 për qind pas Kovid-19.

**Tabela 6:** Të ardhurat mesatare të disponueshme për anëtarët e rritur të amvisërisë

<b>para Kovid-19 (MKD)</b>	174,143
<b>pas Kovid-19 (MKD)</b>	163,015
<b>ndryshimi (%)</b>	-6.4%
<i>Burimi: Përlllogaritjet e autorit janë bazuar në SILC 2018 dhe MK-MOD.</i>	

Kemi nevojë për burim të jashtëm për verifikim. Prandaj e bëjmë një ushtrim të shkurtër në të cilin e vlerësojmë rënien e të ardhurave të disponueshme, duke marrë parasysh një ulje unike të PBV-në. Ne i morëm të dy seritë nga Indikatorët e Zhvillimit Botëror të Bankës Botërore dhe e llogaritëm një rezistencë prej 1.66. Kjo nënkupton që kur BPV-ja bie për 1 për qind, të ardhurat e disponueshme në Maqedoninë

Veriore bien prej 1.66 për qind. Parashikimet e tanishme<sup>20</sup> për rritjen e BPV-së përgjatë vitit 2020 në Maqedoninë e Veriut dallojnë midis 3.2 për qind dhe 4 për qind negativ. Kjo nënkupton që rënia e të ardhurave të disponueshme të disponueshme do të shkonte midis 5.3 për qind dhe 6.6 për qind. Vlerësimi ynë në Tabelën 6 është i madhësisë së diapazonit, kështu që e vërteton fuqinë e supozimeve të mësipërme.

### 3.3.3. Rezultatet dhe diskutimet

Bazuar në metodologjinë dhe supozimet e përshkruara më lart, është zhvilluar një grup i ri i të dhënave të të ardhurave të amvisërisë, që ne e quajmë "skenar post-Kovid-19". Mbi bazën e këtyre të dhënave është llogaritur shkalla e varfërisë së fëmijëve pas Kovid-19. Janë llogaritur edhe efektet diferenciale të të ardhurave nga rrogat, të ardhurat nga vetëpunësimi, të ardhurat sociale dhe pagesat e njëhershme. Ne gjithashtu i kemi veçuar nivelet e varfërisë së fëmijëve me disa karakteristika individuale dhe karakteristika të amvisërisë.

Tabela 7 i paraqet efektet e Kovid-19 në varfërinë e fëmijëve duke i krahasuar nivelet e varfërisë së fëmijëve në vitin 2018 me vlerësimet pas Kovid-19. Këtu janë përdorë tre indikatorë të varfërisë së fëmijëve: ai relativ i bazuar në pjesën e popullsisë së

fëmijëve që jeton në amvisëri, të ardhurat e të cilave bien nën përqindjen e 60-të të të ardhurave mesatare ekuivalente; dhe dy nivelet absolute të varfërisë-pragu i varfërisë së ulët ekstreme dhe pragu i varfërisë në rastin e amvisërive me të ardhura mbi mesatare. Rëndësia e paraqitjes së varfërisë relative dhe absolute të fëmijëve qëndron në nocionin e të ardhurave mesatare, të cilat preken nga të gjitha ndryshimet e supozuara në Pjesën 3.3.2. Prandaj, pjesa relative e fëmijëve të varfër do të ndryshojë jo vetëm si rezultat i një ndryshimi në të ardhurat e amvisërisë së tyre, por edhe si rezultat i ndryshimeve të të ardhurave mesatare. Kjo është arsyeja pse treguesi relativ i varfërisë plotësohet me nivele absolute të varfërisë së fëmijëve, të cilat përftohen duke llogaritur përqindjen e fëmijëve nën një prag të përcaktuar (në këtë rast 1.9 "për të ardhura ekuivalente të rritur" është për pragin e varfërisë së ulët ekstreme dhe 5,5 dollarë amerikan në ditë është për pragin e varfërisë në rastin e amvisërive me të ardhura mbi mesatare.). Shikoni një diskutim të mëtejshëm të këtyre çështjeve në **Kutinë 1.**

<sup>20</sup>Përmbledhur këtu



## KUTIA 1: KARAKTERISTIKAT E VIJAVE TË VARFËRISË TË PËRDORA NË KËTË STUDIM

Megenëse kjo pjesë e hulumtimit mbështetet në SILC, linja kryesore e varfërisë që ne përdorim është linja relative e varfërisë e barabartë me 60 për qind të të ardhurave të barabarta mesatare të amvisërive. Shumë është ne rëndësi të theksohet tipari “për anëtar të rritur” i llogaritjes, që nënkupton se anëtarët e amvisërisë ponderohen në marrjen e të ardhurave “për kokë banori”, si më poshtë: kreu i amvisërisë fiton 1, secili i rritur tjetër 0.5, ndërsa fëmijët (të moshës 0-13 vjeçare) 0.3 për secilin. Për sa i përket këtij hulumtimi në përdorimin e një konstrukti të tillë të vijës së varfërisë është avantazh ponderimi i veçantë i fëmijëve, që është në përputhje me ligjin për mbrojtjen sociale dhe ligjin për mbrojtjen e fëmijëve. Ligji për mbrojtje sociale përcakton, që kryesisht në llogaritjen e NMG-së, kryeamvisi ponderohet 1, personi i rritur i radhës 0.5, personi i rritur i tretë dhe i katërt 0.4, personi i rritur i pestë në 0.2, fëmija 0,1 secila. Ligji parashikon ponderime të përshtatura përpjetë për prindërit e vetëm dhe personat me aftësi të kufizuara. Ligji për mbrojtjen e fëmijëve përcakton një shkallë barazimi paksa të ndryshme: kreu i amvisëri 1, anëtari i dytë 0.5, anëtari i tretë dhe i katërt 0.4 secili, anëtari i pestë 0.2, ndërsa anëtari i gjashtë, i shtatë dhe i tetë 0,1. Ngjashëm ligji i përshtatur në mënyrë të ngjashme ponderimet e përshtatura përpjetë për prindërit e vetëm. Sidoqoftë, disavantazhi i përdorimit të çdo linje relative të varfërisë është se niveli i varfërisë që rezulton mund të mbetet i paprekur ose madje të bjerë, ashtu siç bien të ardhurat e amvisërisë (kështu në mënyrë efektive njerëzit janë më të varfër se më parë, por kjo nuk shfaqet në nivelin relativ të varfërisë), thjesht sepse të ardhurat mesatare zvogëlohen, duke lëvizur kështu linjën e varfërisë relative.

Disavantazhi i tillë në këtë hulumtim është tejkaluar nga mbështetja në linjat e varfërisë absolute. Ne përdorim dy linja absolute të varfërisë: 5,5 dollar në ditë dhe 1.9 dollarë në ditë (termat e PPP-së 2011). Këto janë linjat e varfërisë absolute që zakonisht përdoren dhe sugjerohen nga Banka Botërore.<sup>21</sup> Linja e parë i referohet vijës ekstreme të varfërisë, ndërsa e dyta për kategorinë më të lartë se mesatarja sipas Linjës Ndërkombëtare të Varfërisë. Për sa i përket këtij hulumtimi disavantazhi i dukshëm i përdorimit të konstrukcioneve të tilla është se ata mbështeten në parimin “për anëtar të amvisërisë” dhe jo në parimin “ekuivalent për të rritur”. Kjo nënkupton që në llogaritjen e të ardhurave për kokë banori të amvisërisë, ata përdorin një ponderim të barabartë për të gjithë anëtarët e amvisërisë, përfshirë edhe fëmijët.

Për qëllimin e këtij studimi, ne bëjmë një barazim të avantazheve të linjave relative dhe absolute të varfërisë. Ne i llogaritim shkallët e varfërisë relative për fëmijët në mënyrën e bërë në SILC dhe i kopjojmë të dhënat e publikuara nga Enti Shtetëror i Statistikës. Më tej i llogaritim linjat e varfërisë absolute duke i përdorur dy pragjet e lartpërmendura (përkatësisht 16.989 denarë dhe 49,175 denarë), por kemi zbatuar për të ardhurat e amvisërisë “ekuivalent të rriturit”, me qëllim që ta marrim në konsideratë ponderimin diferencial të fëmijëve në kuadër të ligjeve për mbrojtjes sociale dhe fëmijëve. Sidoqoftë, kjo nënkupton që normat e tilla nuk janë të krahasueshme me normat e llogaritura dhe/ose të publikuara bazuar në metodologjinë e Bankës Botërore, andaj kjo duhet të kihet parasysh kur të interpretohen rezultatet. Për ta shmangur konfuzionin, ne potencojmë se nivelet e arritura të varfërisë bazohen në “pragun tepër të ulët të të ardhurave” dhe “pragun mbi mesatar të ardhurave”.

<sup>21</sup>Këtu mund të gjendet një diskutim në [këtë](#) temë



Kovid-19 parashihet të ndikojë në varfërinë e fëmijëve pasi që shkalla relative rritet nga 29.3 për qind para pandemisë në 33.3 për qind pas pandemisë. Një rritje e tillë i vë 16,000 fëmijë tjerë të Maqedonisë së Veriut nën pragun relativ të varfërisë. Se një rritje prej 4 pikë përqindje (ekuivalente me rritje prej 13.6 për qind) është në të vërtetë mjaft e madhe mund të vlerësohet edhe nga fakti se niveli i varfërisë së tillë ose më i lartë i fëmijëve nuk është regjistruar që nga fillimi i SILC (2010). Për më tepër, bazuar në Anketën e buxhetit të amvisërisë, varfëria e fëmijëve midis 2009 dhe 2010 (pa të dhëna për vitin 2008) gjatë krizës globale financiare është rritur me 2.9 pikë për qind, duke theksuar se kovid-19 ka një efekt më të fortë.

Më tej rezultatet sugjerojnë që varfëria absolute është zvogëluar vetëm për shkak të reformës së ndihmës sociale të vitit 2019 dhe për shkak të kriterëve të relaksimit gjatë Kovid-19 (kolona 4), si dhe për shkak të ndihmave të njehershme të parave (kolona 5), e jo për shkak të humbjeve në të ardhurat e tregut të punës, siç duket amvisëritë me burim kryesor të të ardhurave nga tregu nuk janë ndër më të varfrit. Në këto kushte, pas Kovid-19, rreth 2.600 fëmijë do të nxirren nga varfëria ekstreme, por mesa duket pjesa më e madhe e tyre për shkak të reformës sociale të vitit 2019.

Hulumtimi më i thellë në **Tabelën 7** paraqet një pasqyrë interesante. Efekti rritës i të rënies së ardhurave nga rroga (përfshirë uljen serioze të pagave nga vendet joformale, kolona 2) vlerësohet me rreth 1.4 pikë përqindje, ndërsa ajo e të ardhurave nga vetëpunësimi (kolona 3) në 2.1 pikë përqindje. Kjo sugjeron që individët e vetëpunësuar më shpesh i afrohen pragut të varfërisë, andaj një tronditje e përmasave të mëdha, siç është Kovid-19, i përballë lehtësisht ata me varfëri. Kjo gjithashtu nuk është e çuditshme nga pikëpamja që një pjesë e madhe e të vetëpunësuarve gjenden në sektorët më të goditur, si tregtia me pakicë, shërbimet personale (parukierët dhe sallone kozmetike), kafenetë, restorantet dhe shërbimet e transportit. Varfëria absolute rritet për shkak të ndikimit të Kovid-19 në rrogat dhe të ardhura nga vetëpunësimi, megjithëse vetëm rreth pragut mbi nivelin e mesëm të të ardhurave pasi të ardhurat e tregut të punës kryesisht gjenden rreth e sipër kësaj vije, ndërsa shkalla jashtëzakonisht e ulët e varfërisë mbetet kryesisht e rrafshët sepse amvisëritë e tilla nuk mbështeten vetëm në të ardhurat e tregut të punës.

Kolona (4) e paraqet ndikimin e reformës së ndihmës sociale të vitit 2019 dhe zbutjen e kriterëve të pranueshmërisë gjatë Kovid-19. Siç është cekur më, pasi nuk kemi informacione të sakta nga

**Tabela 7:** Efektet e Covid-19 ndaj varfërisë së fëmijës

	Para Covid-19	Pas Covid-19				
	Real 2018	Ndikimi i rënies së të ardhurave të rrogës (përfshirë edhe rrogat jo-formale)	Ndikimi i rënies të ardhurave nga vetëpunësimi	Ndikimi i reformës dhe zbutjes së kriterëve për ndihmë sociale	Ndikimi i ndihmës së njëhershme në të holla	TOTAL
	(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)
<b>Varfëria relative (nën 60% të mestarës së të ardhurave ekuivalente)</b>	29.3%	30.7%	32.4%	n.a.	29.4%	33.3%
<b>Varfëria absolute (nën pragun ekstrem të të ardhurave të ulëta)</b>	3.0%	3.1%	3.0%	2.4%	1.1%	2.3%
<b>Varfëria absolute (nën pragun mbi mesataren e të ardhurave)</b>	11.3%	12.3%	12.0%	10.7%	10.0%	11.8%

*Burimi:* Përlllogaritjet e autorit janë bazuar në SILC 2018 dhe MK-MOD.  
*Vërejtje:* Varfëria relative në kolonën (4) nuk është paraqitur pasi është nën ndikimin e rëndësishëm nga shënjestrimi i sistemit të ri të reformuar, veçanërisht nga imponimi i mesatares së testit me asistencën prindërore dhe pengesat tona për të simuluar asistencën e jashtë NMG-së.

SILC për ta simuluar reformën (si dhe zbutjen e kriterit të pranueshmërisë), i paraqesim të gjitha rezultatet; ata sugjerojnë që reforma do ta zvogëlojë varfërinë absolute nga 3.0 në 2.3 për qind, duke supozuar se marrin ndihmë të gjithë më të varfrit e kualifikuar të segmenteve të varfra. Ky rezultat është në përputhje me faktin se shumica e të ardhurave nën pragun mbi mestar të të ardhurave janë të ardhura sociale. Sidoqoftë, arsyet e dështimit të zhdukjes së varfërisë ekstreme duhet të kërkohen përsëri në kriteret e pranueshmërisë së pronës, si dhe në pamjaftueshmërinë e mundshme të shumave të ndihmës për familjet shumë të mëdha.

Kolona (5) e paraqet ndikimin në rritje të ndihmës së njehershme në të holla, e cila ushtron një efekt të rëndësishëm mbi varfërinë absolute. Sidoqoftë, duhet të jemi të kujdesshëm në interpretim, sepse pjesa më e madhe tyre, si dhënia e ndihmës në të holla për rastet me të ardhura të ulëta, qoftë në formë të ndihmës sociale, ose për punësimet me paga të ulëta, në mënyrë kumulative vërtetohet si mekanizëm i fuqishëm në zhdukjen e varfërisë ekstreme. Prandaj, ata janë në shënjestër të duhur, por vetëm ata nuk mund ta shkatërrojnë varfërinë.

Në përgjithësi, humbjet e të ardhurave për shkak të Covid-19

janë zbuluar se kryesisht e përkeqësojnë varfërinë relative të fëmijëve, megjithëse deri në një farë mase edhe atë absolute sipas pragut të të ardhurave të mbi nivelin e mesëm. Përderisa, kriteret e zbutura të NMG-së dhe shpërndarja e parave të gatshme janë duke e zbutur efektin e varfërisë së fëmijëve kryesisht në krahun e majtë të shpërndarjes së të ardhurave, duke ndikuar kështu kryesisht në nivelet e varfërisë absolute, e cila përcaktohet nga pragu i të ardhurave për pranueshmërinë e NMG-së dhe synimin e mbështetje monetare të njehershme.

We proceed by disaggregating Ne vazhdojmë me zberthimin e efekteve të Covid-19 në varfërinë e fëmijëve nga disa karakteristikat personale dhe të amvisërisë. **Tabela 8** paraqet shkallët e varfërisë së fëmijëve sipas gjinisë dhe moshës së fëmijës. Vini re se këto janë karakteristikat e vetme personale të fëmijëve, pasi personat në SILC të moshës 15 vjeçare ose më poshtë nuk e plotësojnë pyetësorin individual. Vajzat janë të cenueshme për sa i përket rënies në varfëri, megjithëse pandemia i rrit nivelet relative të varfërisë për të dy gjinitë pothuajse në mënyrë të barabartë. Reforma sociale dhe kriteret e relaksimit të përshtatshmërisë e ulin në mënyrë më efektive varfërinë absolute në linjën me të ardhura mbi mesatare për djemtë sesa për vajzat, të cilët janë më të

**Tabela 8:** Ndikimet e Kovid-19 në varfërinë e fëmijëve sipas gjinisë dhe moshës

	Gjinia		Moshë		
	Mashkull	Femër	0-5	6-14	15-17
<b>Para Kovid-19</b>					
<b>Varfëria relative (nën 60% të mesatares së të ardhurave ekuivalente)</b>	28.7%	29.8%	27.1%	28.5%	35.6%
<b>Varfëria absolute (nën pragun ekstrem të të ardhurave të ulëta)</b>	3.0%	2.9%	2.1%	2.9%	4.2%
<b>Varfëria absolute (nën pragun mbi mesataren e të ardhurave)</b>	11.5%	11.1%	10.0%	11.3%	12.9%
<b>Pas Kovid-19</b>					
<b>Varfëria relative (nën 60% të mesatares së të ardhurave ekuivalente)</b>	32.8%	33.9%	31.8%	31.6%	38.0%
<b>Varfëria absolute (nën pragun ekstrem të të ardhurave të ulëta)</b>	2.3%	2.4%	1.3%	3.1%	2.1%
<b>Varfëria absolute (nën pragun mbi mesataren e të ardhurave)</b>	11.3%	11.6%	9.4%	12.4%	12.4%

*Burimi: Përlllogaritjet e autorit janë bazuar në SILC 2018 dhe MK-MOD.*

ekspozuar ndaj efektit negativ të Kovid-19. Për sa i përket moshës, efekti i Kovid-19 është i përhapur në nënkategoritë e moshave. Varfëria relative atje rritet me 3-4 pikë përqindje, ndërsa shkalla absolute e varfërisë në pragun e të ardhurave mbi mesatare bie për nëngrupet e moshës 0-5 dhe 15-17 vjeçare. Rritja e niveleve të varfërisë pas Kovid-19 për grupmoshën 6-14 vjeçare mund të jetë e lidhur mirë me shtesën e ulët fëmijërore krahasuar me grupmoshën 0-5, dhe asistencën më të ulët arsimore në krahasim me grupmoshën 15-17 vjeçare.

**Tabela 9** i vlerëson dy karakteristika e amvisërisë: nëse amvisëria ka 3 ose më shumë fëmijë ose jo; dhe arsimin

mesatar të anëtarëve të rritur të amvisërisë<sup>22</sup>. Varfëria relative e fëmijëve në amvisëritë me shumë fëmijë është befasisht e lartë, prandaj Kovid-19 e përkeqëson ndjeshëm këtë situatë krahasuar me amvisëritë me një ose dy fëmijë, ku varfëria relative rritet vetëm pak. Çuditërisht, pandemia e përkeqëson varfërinë absolute për amvisëritë me 3+ fëmijë, të cilat mund të përshkruhen si ngritje të pandërprerë të NMG-së

<sup>22</sup>Vini re se arsimit mesatar i prindërve ka nevojë për një identifikim kompleks dhe të rëndë të amvisërive përkundrejt konceptit të amvisërive, në të cilat është ndërtuar SILC-ja, andaj si për përafrim ne operojmë me arsimin mesatar të të gjithë anëtarëve të rritur të amvisërisë..

**Tabela 9:** Ndikimet e Kovid-19 në varfërinë e fëmijëve sipas disa karakteristikave të amvisërisë

	Numri i fëmijëve në amvisëri		Arsimi mesatar i të personave të rritur në amvisëri		
	3 ose më shumë	Fillor ose më pak	Të mesëm	Sipëror ose më shumë	Tertiary or more
<b>Para Kovid-19</b>					
<b>Varfëria relative (nën 60% të mesatares së të ardhurave ekuivalente)</b>	23.9%	42.0%	64.1%	28.7%	1.1%
<b>Varfëria absolute (nën pragun ekstrem të të ardhurave të ulëta)</b>	2.8%	3.2%	8.0%	2.7%	0.0%
<b>Varfëria absolute (nën pragun mbi mesataren e të ardhurave)</b>	8.5%	17.0%	28.7%	10.4%	0.0%
<b>Pas Kovid-19</b>					
<b>Varfëria relative (nën 60% të mesatares së të ardhurave ekuivalente)</b>	24.9%	50.3%	70.1%	32.2%	0.9%
<b>Varfëria absolute (nën pragun ekstrem të të ardhurave të ulëta)</b>	1.1%	4.7%	7.0%	2.0%	0.0%
<b>Absolute poverty, below upper middle income threshold</b>	8.5%	17.5%	30.3%	10.4%	0.0%

*Burimi: Përlllogaritjet e autorit janë bazuar në SILC 2018 dhe MK-MOD.*

për fëmijën shtesë dhe shtesën fëmijërore për më shumë se dy fëmijë, shoqëruar me intensitetin e mundshëm të ulët të punës për të kursyer kohë për kujdesin ndaj fëmijëve. Një situatë e tillë i vërteton rezultatet e njohura përgjithësisht se fëmijët në amvisëri me më shumë fëmijë janë më të lënë mbrapa. Tabela 9 tregon më tej se varfëria e fëmijëve është e ndërlidhur me forcën arsimore të amvisërisë, e cila mund të rezultojë e rëndësishme në kontekstin e


mbylljes së imponuar të shkollave si rezultat i Kovid-19. Përkatësisht, aty ku mesatarja e arsimit në amvisëri është fillor ose më pak, aty "lulëzon" varfëria e fëmijëve, ndërsa Kovid-19 e intensifikon atë. Në anën tjetër të spektrit, kur anëtarët e rritur të familjes kanë një mesatare të arsimit sipëror (terciar) ose më shumë, varfëria e fëmijëve është zhdukur pothuajse në secilin prag.

### 3.4. PRIVIMET TJERA QË E PËRKEQËSOJNË NDIKIMIN E KOVID-19 NDAJ FËMIJËVE

Diskutimi nga Pjesa 3.3.3. mund të shtrihet në efektet e mundshme të pandemisë në një gamë të indikatorëve të varfërisë jo-monetare, duke përfshirë treguesit që lidhen me arsimin, shëndetin, kushtet e strehimit dhe mundësinë e përdorimit të shërbimeve. Pandemia e ka përkeqësuar të gjithë gamën e indikatorëve, të cilët shkojnë përtej privimit të të ardhurave, por janë të ndërlidhur me to. Këto privime përfshijnë një

sërë indikatorësh në lidhje me arsimin, shëndetin, kushtet e strehimit dhe qasjen në shërbime. Për shembull, kontinuiteti i arsimit të ulët të prindërve dhe varfëria, siç zbulohet në Tabelën 9, sugjeron që Covid-19 mund t'i dëmtojë ndjeshëm fondet e kapitalit njerëzor dhe akumulimin e mjeteve për fëmijët, pasi ata mund të përballen me një nevojë të paplotësuar për mbështetje mësimore dhe ndihmë nga prindërit, ose të dëmtohet nga mungesa e mjeteve për të mundësuar mësim efikas nga distanca. Besimi në aftësinë e vet për të mbështetur mësimin e fëmijëve si dhe mungesën e

**Grafiku 12:** Pjesa e fëmijëve me lidhje interneti në shtëpi



*Burimi:* Përlogaritjet e autorit janë bazuar në SILC 2018.

njohjes së mundshme të lëndës mund të jetë pengesë midis prindërve me arsim të ulët. 45.8% e fëmijëve në Maqedoninë e Veriut jetojnë në shtëpi me lidhje interneti; **Grafiku 12** tregon se kjo pjesë është çuditërisht e ulët në amvisëritë me arsim të ulët, me 3+ fëmijë dhe në amvisëritë e varfra; gjë që potencialisht shpie në përkeqësimin e rrezeve të mbylljes së shkollës për të mësuar dhe zhvillim njohës të fëmijëve të tillë.

Të jetuarit në amvisëri me shumë fëmijë dhe të varfra mund të ndërliken me kushtet e banimit dhe të jetesës, gjë që po ashtu e dëmton procesin e të mësuarit të fëmijëve. Grupi i mëposhtëm i të dhënave i paraqet kushtet e tilla. **Grafiku 13** e paraqet numrin e fëmijëve sipas numrit të dhomave në amvisëri dhe sugjeron që shumica e tyre posedojnë deri në katër dhoma, me shpërndarje të barabartë mbi bazë të gjinisë. Amvisëritë më të varfra, të cilët njashu kanë të arritura më të ulëta arsimore dhe kanë më shumë fëmijë posedojnë më pak dhoma, duke sugjeruar që mbipopullimi mund të intensifikojë përkeqësimin e mësimit dhe dështimin e aftësive kognitive të fëmijëve. Amvisëritë më të varfra, amvisëritë me më shumë fëmijë dhe të rritur me arsim fillor ose nivel më të ulët arsimor dominojnë në mesin e amvisërive, të cilat nuk mund ta ngrohin shtëpinë e tyre (Grafiku


13, tabloja b) dhe objekti i banimit të cilëve është shumë i errët (Grafiku 13, tabloja c), mirëpo në secilën prej këtyre kategorive, nuk haset pjesa e amvisërive jo të varfra. Tablot b dhe c më tej sugjerojnë që Covid-19 ka shumë të ngjarë që përmes mbylljes dhe izolimit, t'i përkeqësojë dhe të ndikojë negativisht në kushtet e mësimit të fëmijëve, pasi që rritet përpjesëtimi i amvisërive të tilla.

Një perspektivë më e gjerë se si ka ndikuar pandemia në procesin e të mësuarit të fëmijëve në Maqedoninë e Veriut është dhënë në Pjesën 4, ndërsa ndikimi i rrezeve shëndetësore në Pjesën 5. Fatkeqësisht, për sa i përket indikatorëve të varfërisë jo-monetare, SILC nuk përmban informacion shëndetësor dhe informacione për qasjen në shërbime nga amvisëritë, ndërsa gjithashtu karakteristikat socio-ekonomike për fëmijët nën 16 vjeç po mungojnë.


Sidoqoftë, Hulumtimi në Klasterit me më shumë indikatorë (MICS) hedh dritë mbi pabarazitë midis fëmijëve nga amvisëritë më të varfra dhe ata që jetojnë në amvisëritë me mirëqenie të mirë. Siç kemi vërtetuar pas Covid-19 e përkeqëson gjendjen e varfërisë, ka shumë të ngjarë që ajo të zgjerojë edhe hendekun mes të ardhurave/pasurisë. Edhe pse Hulumtimi përvetësoi një qasje të ndryshme, që nuk ka të bëjë me të ardhurat në lidhje me përkufizimin e amvisërive

**Grafiku 13:** Kushte e amvisërisë (pjesa e fëmijëve të prekur)


A) NUMRI I DHOMAVE NË AMVISËRI



B) Nuk mund ta ngroh në mënyrë adekuate shtëpinë



C) OBJEKTI I BANIMIT ËSHTË SHUMË I ERRËT



Burimi: Përlllogaritjet e autorit janë bazuar në SILC 2018.



të varfra, sidoqoftë i i uri në pah disavantazhet të cilat i vuajnë fëmijët. Për shembull, vetëm një e treta (36 për qind) e fëmijëve më të varfër 6-23 muajsh kanë konsumuar një diversitet<sup>23</sup> minimal të pranueshëm ushqimor, që paraqet gjysmën e fëmijëve të amvisërive më të pasura (70 për qind). Më tej i vëzhgojmë ato sipas këtyre boshteve: ushqyerja e foshnjave të fëmijëve të vegjël; zhvillimi në fëmijëri të hershëm; aftësi themelore për mësim; të ushqyerit; uji, hapësirat sanitare dhe higjiena; dhe përdorimi i lëndëve djegëse në amvisëri **(Grafiku 14)**.

Pabarazitë fillojnë kur fëmijët observohen për sa i përket përputhshmërisë së tyre me zhvillimin, të matur në të paktën në tre nga katër fushat: shkrime e leximi, zhvillimi fizik, socio-emocional dhe mësimi (Grafiku 14, tabela a): pjesa e amvisërive më të varfra është rreth dy të tretat, krahasuar me mbi 90 për qind të amvisërive më të pasura. Për më tepër, më pak se 10 për qind e fëmijëve të moshës 3-5 vjeçare nga amvisëritë më të varfra e ndjekin edukimin në fëmijëri të hershëm (krahasuar me afro 70 për qind të bashkëmoshatarëve të tyre në amvisëritë më të pasura). Pjesa që ka të bëjë me fëmijët romë janë shpalos shifra katastrofale për gjithë shpërndarjen e pasurisë: edhe për amvisëritë më të pasura, shtrirja e tillë dallon vetëm pak


mbi 20 për qind (Grafiku 14, tabela a).

Fëmijët në amvisëritë më të varfra ngecin në aftësitë e leximi dhe aftësitë numerike (Grafiku 14, tabela b). Shpërndarja e shtresës së fëmijëve me aftësi numerike është e vendosur në pjesën e poshtme të shpërndarjes, madje është interesant që vajzat nga amvisëritë e varfra janë vazhdimisht më pak të suksesshëm në krahasim me djemtë. Është evidente që rrëgjimi është më i përhapur në mesin e fëmijëve më të varfër (Grafiku 14, paneli c), që nuk është rasti për mbi peshin e mundshme, sepse fëmijët më të varfër përballen me kequshqim, i cili e pengon përhapjen e mbipeshes. Megjithatë, në rastin e mbipeshës kjo nuk vlen për kuintilin e dytë, që është më e lartë (15.3 për qind), gjë që sugjeron ushqim potencialisht të mjaftueshëm, por me diversitet të pamjaftueshëm.

<sup>23</sup>Diversiteti minimal ushqimor i referohet sigurimit për fëmijët të ushqimit me përmbajtje të përshtatshme ushqyese. Treguesi llogaritet bazuar në përqindjen e fëmijëve, të moshës 6-23 muajsh, të cilët kanë marrë të paktën pesë nga tetë grupet ushqimore (1) qumësht gjiri, 2) kokrra, rrënjë dhe zhardhokë, 3) bishtajore dhe arra, 4) produkte të qumështit, 5) ushqime me mish, 6) vezë, 7) pemë dhe perime të pasura me vitaminë-A, dhe 8) fruta dhe perime të tjera.


**Grafiku 14:** Pabarazitë në mes fëmijëve varësisht nga pasuria e amvisërisë

A) ZHVILLIMI NË FËMIJËRI TË HERSHME




● Më të varfër ● Niveli i dytë ● Mesëm  
● Niveli i katërt ● Më të pasur

B) SHKATHËSITË THEMELORE PËR LEXIM




● Më të varfër ● Niveli i dytë ● Mesëm  
● Niveli i katërt ● Më të pasur

C) TË USHQYERIT




● Më të varfër  
● Niveli i dytë  
● Mesëm  
● Niveli i katërt  
● Më të pasur

D) UJI, HAPËSIRA SANITARE, HIGJIENA



E) LËNDËT DJEGËSE



**Burimi:** MICS 2019

**Vërejtje:** \* Indeksi i Zhvillimit në fëmijëri të hershme llogaritet si pjesa e fëmijëve të moshës 36-59 muajshe, të cilët zhvillohen në rrugën e duhur në të paktën tre nga katër fushat e mëposhtme: shkrim e lexim, shtashtësi fizike, sociale-emocionale dhe mësim.

\*\* Rezultatet për zhvillimin e hershëm të fëmijëve romë duhet të merren me kujdes, për shkak të numrit të vogël të rasteve të paponderuara.

Uji i pijshëm dhe higjiena nuk janë problem për fëmijët në Maqedoninë e Veriut, por hapësirat sanitare (kanalizimet) mund të jenë problem (Grafiku 14, tabela d), megjithëse të gjitha familjet kanë qasje të lartë në të si një shërbim themelor. Sidoqoftë, lidhja e kanalizimeve mungon pothuajse në gjysmën e amvisërive, ndërsa hapësirat sanitare në lokacion e banimit janë të pranishme në gati 40 për qind të tyre. Mbi dy të tretat e amvisërive të varfra mbështeten në karburantet ndotëse dhe

teknologjitë e gatimit që mund të ndikojnë negativisht në shëndetin e fëmijëve (veçanërisht nëse objekti i banimit nuk ka ajrosje të duhur) (Grafiku 14, tabela e). Po kështu, pothuajse 100 për qind e familjeve më të varfra përdorin dru për ngrohje, kuintilet e mesme dhe të nivelit të katërt përballen me përqindje të mëdha.

Në përgjithësi, varfëria dhe pabarazia kanë një ndikim të madh në masën në të cilën fëmijët janë të ekspozuar ndaj rreziqeve të Covid-19. Rritja në lagje më

të varfra, që në veçanti haset në lagjet rome, ndikon në qasjen në një sërë nevojash siç janë ushqimi i mirë, strehimi cilësor, çështjet sanitare, hapësira për lojë ose studim, si dhe mundësitë për t'u përfshirë në shkollim onlajn, por gjithashtu mund të rritet rrezikun i marrjes dhe bartjes së virusit, si dhe të përjetohen probleme themelore shëndetësore, siç është dokumentuar nga një studim i fundit i OECD-së (2020b).



## 4. FËMIJËT QË PËRBALLEN ME HUMBJE TË MËSIMIT

Qeveria mbylli institucionet shkollore dhe parashkollore më 10 Maj 2020. Vendimi i parë ishte që procesi edukativo-arsimor të ndërpritet për 14 ditë me qëllim që të parandalohet shpërndarja e virusit korona. Njëkohësisht, një vendim tjetër u morr në të cilin njërit nga prindërit e fëmijëve të moshës deri 10 vjeç (klasës së katërt së shkollës fillore) i mundësohej të merr pushim me pagesë me qëllim kujdesi ndaj të vegjëlve, edhe pse vendimi i përjashtonte prindërit e fëmijëve që nuk ishin pjesë e arsimit parashkollor formal. Derisa numri i rasteve me Covid-19 u

shtua, më 13 mars, Qeveria, me rekomandim të MASH-it, këshilloi televizionin kombëtar që të ndajë kohë të caktuar për transmetim të emisioneve me përmbajtje arsimore në të gjitha gjuhët. MASH-i dhe Byroja për Zhvillimin e Arsimit (BZhA), me mbështetje teknike dhe financiare nga UNICEF-i, punoi në gjetjen e mësimdhënësve të duhur, në krijimin e orareve javore si dhe në përgatitjen e planeve të mësimit për çdo lëndë që do transmetohej në TV. Gjithashtu, MASH-i siguroi që përmbajtja të ndahet në të gjitha rrjetet sociale dhe kanalet e tjera të

komunikimit. Më 24 mars, Qeveria vendosi që procesi edukativo-arsimor i shkollave fillore dhe të mesme të organizohet nëpërmes mësimin në distancë, megjithëse çdo shkolle iu dha mundësia që të vendosë se cilën mënyrë të komunikimit elektronik të përdor me qëllim mbajtjen e komunikimit të drejtpërdrejtë mes mësimdhënësve dhe nxënësve. Mësimdhënësit morën udhëzime nga BZhA-ja se si të vlerësojnë dhe notojnë nxënësit duke përdorë provime me gojë dhe me shkrim. Më 30 prill, u vendos që të vazhdohet me modelin e mësimin në distancë deri në mbarim të viti shkollor (10 qershor 2020). Regjistrimi i fëmijëve në klasën e parë në shkolla fillore u prolongua nga maji në qershor, ndërsa matura shtetërore u anulua për ata që e mbarojnë shkollën<sup>24</sup>.

Disa ditë pas mbylljes së shkollave, MASH-i, me ndihmën e UNICEF-it, e lëshoi në përdorim platformën Edulno. Platforma në fjalë fillimisht ishte planifikuar të shërbejë si hapësirë ku mësimdhënësit, edukatorët dhe prindërit mund të gjenin ide për të aplikuar metoda të reja të nxënies nëpërmes lojërave dhe mjeteve kreative të cilat do të nxisnin zhvillim socio-emocional të fëmijët e moshës 3- 10 vjeçare. Megjithatë, UNICEF-i krijoi një E-klasë në këtë platformë ku u përfshinë video leksionet e mësimdhënësve që ishin në përputhje me programin mësimor

nacional. Qëllimi i platformës ishte ta mbështesë procesin mësimor të fëmijëve gjatë pandemisë. Megjithatë, sigurimi i cilësisë së procesit arsimor dhe kujdesi për nevojat e të gjithë nxënësve gjatë Kovid-19 ishte i mbushur me plot vështirësi. Konteksti i pandemisë i përkeqësoi dhe i nxori në pah një mori të çështjeve paragjyquese brenda sistemit arsimor. Disa palë të interesuara shtetërore dhe private u mobilizuan për të siguruar vazhdimësi në procesin arsimor, megjithëse veprime të mëtutjeshme nevojiten për të përgatitur sistemin për të ardhmen. Kjo pjesë tregon përgjigjen e autoriteteve arsimore në Maqedoninë e Veriut ndaj pandemisë, veprimet që janë marrë, si dhe vlerëson ndikimin e mundshëm të mbylljes fizike të shkollave në qasjen në arsim, vazhdimin e funksionimit të sistemit arsimor gjatë mbylljes, praktikave premtuese dhe parandalimin e një ulje të madhe të të nxënimit.

---

<sup>24</sup>Matura Shtetërore është një provim diplomimi i destinuar për nxënësit e shkolla të mesme të përgjithshëm dhe shkollat e mesme profesionale katër vjeçare. Përveç që është pjesa finale e arsimit të mesëm, ajo synon të shërbejë si një përzgjedhje e kandidatëve për regjistrim në arsimin sipëror. Matura Shtetërore merret sipas programeve speciale të provimit, të bazuara në objektivat e mësimin të programeve mësimore në listën e moduleve të Maturës Shtetërore.

#### 4.1. NJË PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E PROCESIT ARSIMOR DHE SISTEMIT ARSIMOR

Përgjigjja ndaj pandemisë është shumë e rëndësishme në vendet të cilat po hasin në vështirësi me kualitetin e procesit arsimor (Reimers dhe Schleier, 2020) siç është rasti në Maqedoninë e Veriut. Nxënësit në vend vazhdimisht tregojnë rezultate të dobëta në testimin PISA. Në testimin PISA të vitit 2018, rezultatet treguan: 393 për lexim (e cila është më e ulët nga mesatarja prej 487 e propozuar nga OECD-ja), 394 në matematikë (në krahasim me mesataren prej 489 të OECD-së) dhe në shkencë 413 (në krahasim me mesataren prej 489 të OECD-së). Gjithashtu, 45 për qind e nxënësve arritën së paku nivelin 2 në lexim derisa përqindja e nxënësve që treguan rezultate të larta ishte shumë i vogël. Në matematikë, 39 për qind e nxënësve arritën së paku nivelin 2 dhe vetëm 1 për qind ia dolën të arrijnë nivelin 5 ose më lartë. Në shkencë, 51 për qind arritën së paku nivelin 2 dhe vetëm 1 për qind treguan rezultat më të lartë. Këta rezultate tregojnë përmirësim të dukshëm në krahasim me ato të PISA 2015 dhe përqindja e atyre që kanë treguar rezultate të ulëta është zvogëluar për së paku nënë pikë (Avvisati et al. 2019). Edhe pse kjo tregon përmirësim në krahasim me rezultatet e viti

2015, sistemi edukativo-arsimor i vendit mbetet i ngarkuar me një numër problemesh që lidhen me procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies si dhe me procesin e vlerësimit të nxënësve (Mickoska-Raleva et al. 2017; OECD, 2019a; OECD 2019).

Sistemi arsimor i Maqedonisë së Veriut përbëhet nga shkollat fillore ku arsimin e ndjekin fëmijët 6- 11 vjeç; shkollat e mesme të ulëta (11-14 vjeç) dhe të mesme (gjimnazet – shkollat e gjuhëve dhe të shkencave dhe shkollat e arsimit të mesëm profesional) ku ndjekin mësimin nxënësit 15- 18 vjeç. Shkolla fillore dhe e mesme janë të obligueshme. Institucionet parashkollore pranojnë fëmijë nga mosha njëvjeçare dhe deri sa të fillojnë me arsimin fillor; megjithatë, regjistrimi në institucionet parashkollore ngelet i ulët, edhe atë 36.8% më 2018/2019 (MICS 2019), krahasuar me shtetet fqinje dhe kjo një përqindje shumë e ulët krahasuar me planet e arsimit dhe trajnimit të Unionit Evropian për të arritur përqindjen prej 95 % më 2020 (Byrne, 2020).

Sipas rezultateve të PISA-s, arritjet e nxënësve në Maqedoninë e Veriut janë të lidhura me sfondin socio-ekonomik të amvisërisë së tyre (shiko gjithashtu Pjesën 3.4). Pra, rezultatet e PISA-s tregojnë që nxënësit me përparësi socio-ekonomike janë më të suksesshëm se ata që u mungon kjo përparësi në shkathtësitë



e leximit (me diferencë prej 90 pikësh). Gjetje të ngjashme ka edhe në matematikë dhe shkencë, përkatësisht 11 për qind dhe 10 për qind e diferencave në rezultate mund t'i atribuohen statusit socio-ekonomik (Avissati et al. 2019). Gjithashtu, të dhënat nga PISA 2018, siç shihen në **Table 10**, tregojnë që nxënësit që bëjnë testin në gjuhën maqedonase janë më të suksesshëm në rezultate se nxënësit që bëjnë testin në gjuhën shqipe, dhe diferenca më e theksuar është sidomos në shkencë. Kjo do të thotë që disa grupe të caktuara të nxënësve janë më të prekshëm ndaj mbylljes së shkollave dhe kthimit në mësim në distancë se disa të tjerë. Kjo lidhje midis statusit socio-ekonomik dhe aftësive të të mësuarit themelor dëshmohej edhe nga të dhënat e MICS-së, të cilat zbulojnë pabarazi të konsiderueshme në aftësitë e shkrim-leximit dhe të numeracionit të fëmijëve 7-14 vjeç në varësi të pasurisë, vendit të jetesës, nivelit arsimor të nënës dhe etnisë. Kjo do të thotë që fëmijët e amvisërive urbane janë diç më të suksesshëm se ata rurale sa i përket aftësive themelore në lexim, por diferenca është e madhe sa i përket aftësive themelore numerike: vetëm 38% e fëmijëve të vendeve rurale kanë aftësi të këtilla krahasuar me ato të fëmijëve të vendeve urbane prej 42.9%. Diferenca të mëdha ka gjithashtu edhe bazuar në nivelin e arsimimit të nënës.

Vetëm 45.3 për qind e fëmijëve, nënat e të cilëve kanë arsim fillor, kanë aftësi themelore në lexim dhe 29.1 për qind kanë aftësi themelore numerike, krahasuar me 78.7 për qind dhe 53 për qind të fëmijët nënat e të cilëve kanë arsim të lartë. Vetëm 46.9 për qind e fëmijëve të varfër kanë aftësi themelore në lexim krahasuar me 79.3 për qind e fëmijëve të pasur (shih gjithashtu Grafikon 14 fusha b). Përqindja e aftësive themelore numerike është, përkatësisht, 28.1 për qind dhe 58.1 për qind. Gjithashtu, më shumë fëmijë maqedonas kanë aftësi themelore në lexim (75.3 për qind) dhe aftësi themelore numerike (51.2 për qind), krahasuar me fëmijët shqiptar të cilët përqindjet janë më të ulëta, përkatësisht vetëm 56.4 për qind dhe 32.6 për qind. Situata është edhe më brengosëse te nxënësit romë pasi vetëm 1/3 e tyre kanë aftësi themelore në lexim dhe përafërsisht vetëm 1/5 e tyre kanë aftësi themelore numerike, dhe prej tyre, ata nga kuintili më i varfër tregojnë rezultat më të ulët.

**Tabela 10:** Rezultatet e PISA-s sa i përket gjuhës së testit

	Reading	Mathematics	Science
<b>Macedonian</b>	409	409	430
<b>Albanian</b>	355	350	365

*Burimi: databaza e PISA-s e vitit 2018*



Janë disa institucione që janë përgjegjëse për të vëzhguar procesin arsimor. Vendimmarrja ekzekutive bie mbi Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës (MASh), Inspektorati Shtetëror i Arsimit (IShA) është përgjegjës për të siguruar kualitet dhe kontroll, Byroja për Zhvillimin e Arsimit (BZhA) bën kurikulën dhe zhvillon standardet e nxënies nga arsimit parashkollor e deri te ai i mesëm, përveç lëndëve të specializuara për shkollat e mesme profesionale ku standardi dhe kurikula zhvillohen dhe monitorohen nga Qendra për Arsim Profesional dhe Trajnim (QAPT). Qendra Shtetërore e Provimeve është përgjegjëse për zhvillimin dhe implementimin e provimeve dhe certifikimeve për drejtorët e shkollave. Ministria e Punës dhe Politikës Sociale (MPPS) është përgjegjëse për funksionimin e institucioneve parashkollore (përveç kurikulës). Shkollat administrohen nga drejtoritë e shkollave dhe menaxhohen nga drejtorët e shkollave të cilët kanë autonomi të gjerë mbi resurset e shkollave dhe planit vjetor, edhe pse janë nën ndikimin të madh të politikës (OECD, 2019a). Mësuesit kanë autonomi të madhe sa i përket vlerësimit të nxënësve, por shumë pak autonomi nga aspekti i vendimeve për planin mësimor dhe caktimin e kohëzgjatjes së mësimin (Komisioni Evropian, 2018). Ngarkesa e madhe në planin mësimor dhe mungesa e autonomisë rezulton në një

situatë ku mësuesit i mbetet pak kohë për të përsëritur përmbajtjen mësimore, nëse ka nevojë, dhe për të siguruar që kuptojnë materialin mësimor e që mund të kontribuojnë në boshllëqe të mëdha në kompetencat e nxënësve derisa përparojnë në sistemin arsimor (OECD, 2019a). Kjo mungesë e autonomisë në lidhje me caktimin e kohës së mësimit dhe detyrimin për ta ndjekur në mënyrë rigoroze të programit mësimor mund ta pengojë përshtatjen në mësimin në distancë.

## 4.2. QASJA NË ARSIM

Kur bëhet fjalë për sigurimin e cilësisë në procesit arsimor për të gjithë, hapi i parë është të mundësohet qasje e barabartë në arsim. Duke pasur parasysh që vendimi për t'i mbyllur fizikisht mjediset shkollore dhe parashkollore dhe kalimi në mësim në distancë duhej të bëhej pa shumë përgatitje, çështja e qasjes së barabartë në arsim është parësore.

Të dhënat nga Hulumtimi në klaster me më shumë indikatorë (MICS 2019) e tregojnë pasurinë, përkatësinë etnike dhe ndarje urbane/rurale që mund të prishin mësimin në distancë për grupe të ndryshme të nxënësve. Domethënë, 10 për qind e fëmijëve të moshës parashkollore nga kuintili më i ulët marrin pjesë në programet e arsimit të hershëm krahasuar me përafërsisht 90 për qind e më të pasurve (të dhënat e paraqitura në Grafikon 14 tabloja a). 68.5 për qind e fëmijëve që jetojnë në vendet urbane e që janë në klasën e parë kanë qenë pjesë e arsimit parashkollor një vit më parë derisa vetëm 34.5 për qind e fëmijëve që jetojnë në vende rurale kanë marrë pjesë në arsimin parashkollor. Fëmijët e përkatësisë etnike maqedonase kanë gjithashtu frekuentim të lartë të enteve të edukimit të hershëm. Kjo do të thotë që fëmijët nga amvisëritë me mirëqenie të mirë, zonat urbane dhe përkatësia

etnike maqedonase janë më të gatshëm për shkollë sesa moshatarët e tyre. Kur flitet për shkollat e mesme, vetëm 75.5 për qind e fëmijëve nga kuintili më i varfër shkojnë në shkollë të mesme krahasuar me mbi 90 për qind të atyre që i përkasin kuintilëve të tjerë. Gjithashtu, thuajse gjithë fëmijët maqedonas hyjnë në shkolla të mesme krahasuar me 92.9 për qind e fëmijëve shqiptar dhe vetë 59.9 për qind i fëmijëve të etnive tjera (MICS 2019). Kjo mospërputhje mund të nxisë rezultate të ndryshme për grupet e ndryshme të nxënësve gjatë mbylljes fizike të shkollave.

Problemi i qasjes fizike në procesin arsimor gjatë mësimin digjital/në distancë është përmendur nga gjithë pjesëmarrësit në intervistë. Shumica e të intervistuarve theksuan nevojën për një kompjuter dhe një lidhje të qëndrueshme interneti si parakusht për të përcjellë me sukses procesin arsimor dhe shumica nga ta ishin të vetëdijshëm që jo çdo fëmijë i ka këta parakushte.

**“INFRASTRUKTURA ËSHTË PROBLEMI I PARË; NJERËZIT VËRTETË NUK KANË PATISJE NË SHTËPI, DHE NUK JAM I SIGURTE QË ATA KANË INTERNET NË SHTËPI... UNË FLAS PËR MËSUESIT, PRINDËRIT, FËMIJËT. NUK E KEMI MUNDËSINË TË PUNOJMË NGA SHTËPIA”**

- përfaqësues nga sektori OJQ-ve dhe

“JU NUK MUND TË ORGANIZONI MËSIM NË DISTANÇË KUR FAMILJET NUK KANË KOMPJUTERË, LAPTOP, APO TELEFON CELULAR... SHUMË PREJ TYRE NUK KANË AS INTERNET”

- (mësues). Problemi shtohet nëse në familje ka më shumë se një fëmijë dhe çdo fëmijë i duhet qasje në një mjet digjital për ta përcjellë procesin arsimor:

“KA FAMILJE QË NUK KANË KOMPJUTER APO LAPTOP OSE KANË NJË POR KANË MË SHUMË FËMIJË TË MOSHËS SHKOLLORE NË SHITËPI... ORARI... ATA KANË ORË NË TË NJËJTËN KOHË ETJ., DHE KJO ËSHTË PROBLEMI MË I MADH PËR FAMILJET”

-(mësues praktikant). Sidoqoftë, nuk ka të dhëna statistikore në lidhje me numrin e familjeve që janë në situata të këtilla, dhe si rezultat, mund të bëjmë vetëm një vlerësim për mungesën e pajisjeve shkollore nëpër shtëpi. Të dhënat e paraqitura në **Grafikun 13** tregojnë që fëmijët më të varfër kanë tendencë të jetojnë në kushte të atilla shtëpiake që mund ta dobësojnë nxënien shkaku i mbipopullimit. Të dhënat në PISA 2018 tregojnë që disa fëmijë mund të mos kenë qasje të barabartë në kompjuterë, libra dhe materiale që mund t’u ndihmojnë gjatë mësimin (**Tabela 11**). Në përgjithësi, vetëm 5.8 për qind e nxënësve kanë raportuar se nuk kanë pasur vend të qetë për mësim, derisa 7.7 për qind kanë raportuar për mungesë të kompjuterit për mësim në shtëpi. Gjithashtu, rreth 40 për

qind të nxënësve në PISA kanë raportuar për posedimin e një apo asnjë kompjuteri në shtëpi, duke nënkuptuar që ata mund të mos kenë qasje në kompjuterë për një periudhë më të gjatë kohore nëse ata do të duhet të përdoren edhe nga vëllezërit, motrat ose prindërit. Rreth 18 për qind e nxënësve kanë raportuar se kanë vetëm një televizor në shtëpi e cila gjithashtu mund të jetë problematike nëse anëtarët e tjerë të familjes duan ose u duhet ta përdorin.

**Tabela 11:** Qasja në resurset e shtëpisë që mund të ndihmojnë gjatë mësimin në distancë

	Po	Jo
<b>Vend të qetë për mësim në shtëpi</b>	94.4%	5.8%
<b>Kompjuter në shtëpi</b>	92.3%	7.7%

*Burimi: Baza e të dhënave PISA-s e vitit 2018*

Shumica e pjesëmarrësve pajtohen në përgjithësi se situata aktuale e ka përkeqësuar pabarazitë sociale sa i përket qasjes në arsim dhe bëjnë thirrje për veprime që do t’i zbulonin shakatarrët e pabarazive:

“FATKEQËSISHT, (...) SITUATA MARGJINALIZON NJË GRUP TË MADH TË NXËNËSVE DHE PRINDËRVE DHE KJO ËSHTË NJË SFIDË E MADHE. NË ANËN TJETËR, SHPRESOJ QË KJO TË NDEZ ALARMIN PËR TË ARDHMEN, QË TË FILLOJMË TË BISEDODJMË SERIOZISHT PËR KËTO PABARAZI...”

-(përfaqësues nga sektori OJQ-ve).

Intervistat theksojnë faktin që diferencat e pjesëmarrjes në mësimin digjital/në distancë ekzistojnë dhe kjo si shkak i kushteve socio-ekonomike dhe ndarjes urban/rural. Siç përmendi një mësues:

"NË SHKOLLAT TONA RRETH 75-100 PËR QIND E NXËNËSVE MARRIN PJESË NË MËSIM DHE JANË AKTIVË NË ORË. MEGJITHATË, NË SHKOLLAT TJERA PUNA NUK QËNDRON KËSHTU... NË KEMI MË SHUMË NXËNËS TË FAMILJEVE TË PASURA, NDËRSA SHKOLLAT E TJERA KANË AMBIENT TJETËR SOCIO-EKONOMIK DHE NXËNËSIT ATJE NUK KANË QASJE... NË FAKT NUK KANË KOMPJUTERË."

Në një intervistë me përfaqësues nga OJQ-të, theksohet ndarja urban/rural:

"KA SHKOLLA RURALE... PËR SHEMBULL, ËSHTË NJË SHKOLLË NË NJË FSHAT TË KRIVA PALLANKËS KU NXËNËSIT NUK KANË ASPAK QASJE NË INTERNET DHE SHKOLLA NUK KA RESURSE DIGJITALE."

Padyshim, të dhënat e SILC-it tregojnë një diferencë të posedimit të kompjuterëve/laptopëve mes amvisërive urbane dhe atyre rurale. Në zonat rurale vetëm 66.3 për qind e amvisërive raportojnë se kanë kompjuter/laptop në krahasim me 74 për qind e amvisërive urbane. Situata është edhe më e rëndë për amvisëritë e varfra ku vetëm 49.8 për qind kanë kompjuter/laptop. Gjithashtu, proporcioni i amvisërive me më shumë se pesë persona është më i lartë në vendet rurale (30.9 për qind krahasuar me 20 për qind në

vendet urbane). Kjo do të thotë që fëmijët në vendet rurale, sidomos ata të varfrit, që kanë dy apo më shumë vëllezër apo motra dhe që jetojnë me një prind, mund të ndikohen më rëndë nga mungesa e qasjes në resurset arsimore që nevojiten për të përcjellë procesin arsimor. Siç është treguar tashmë në Pjesën 3.4 më lart, përkundër shkallës relativisht të lartë të pronësisë kompjuterike të raportuar nga pjesëmarrësit e PISA, më shumë se gjysma e fëmijëve në vend nuk kanë qasje në internet, dhe amvisëritë e varfra dhe me arsim të dobët janë veçanërisht vulnerabile në këtë drejtim (**Grafikun 12**).

Fëmijët romë janë një ndër grupet më të cënueshme sa i takon arsimimit. Në një hulumtim me komunitetet e marginalizuara rome (përzgjedhja e qëllimshme e mostrës së vendbanimeve me popullsi më të lartë rome se mesatarja në nivel nacional), regjistrimi i fëmijëve në arsimin parashkollor është mjaft i ulët edhe atë afërsisht 14 për qind (UNDP, 2018), derisa të dhënat e MICS-it tregojnë që afërsisht vetëm 25 për qind e fëmijëve romë që ishin regjistruar në klasën e parë kishin qenë pjesë e arsimit parashkollor një vit më parë. Gjithashtu, afërsisht vetëm 70 për qind e fëmijëve romë nga dy kuintilët më të ulëta të pasurisë kanë shkuar në shkollën fillore dhe ky numër bie në 12.8 për qind sa i përket pjesëmarrjes në shkolla

të mesme i atyre nga kuintili më i varfër. Mbarimi i shkollës së mesme te personat e moshës 22-25 vjeç është 36.9 për qind – i cili është më i lartë se më parë, por prapë se prapë shumë i ulët krahasuar me popullatën jo romë (MICS 2019).

Fëmijët e marginalizuar romë kanë tendencë të jetojnë në familje të mëdha me më shumë se katër anëtarë (47.8 për qind), më shumë se shokët e tyre jo romë (24.9 për qind). Vetëm 37.7 për qind e romëve të marginalizuar (MICS, 2019) kanë raportuar të kenë kompjuterë në shtëpi. Të intervistuarit gjithashtu theksuan edhe mungesën e pajisjeve dhe kanaleve për komunikim të fëmijët romë, sidomos te ata që jetojnë në varfëri:

“AFËR 20 PËR QIND E SHFRYTËZUESVE TË BURSIVE (NË KLASËN E PARË, NË SHKOLLË FILLORE, NGA KOMUNITETET E VARFRA ROMË) NUK E PËRCJELLIN PROCESIN ARSIMOR, ATA NUK KANË PAJISJE PËR TË MARRË PJSË, THJESHË NUK KEMI KONTAKT ME TA... DHE KËSHU MUNDOHEMI NË MËNYRA TJERA NËPËRMES PRINDËRVE, FQINJËVE, AKTIVISTËVE TË OJQ-VE, T’I DËRGOJMË MATERIALET MËSIMORE DERI TE FËMIJËT, UDHËZUES, LIBRA ME TREGIME... POR ËSHË MJAFT RËNDË SEPSE NUK MUNDËMI T’U SHKOJMË DERI NË SHTËPI SHKAKU I MASAVE MBROJTËSE”

- (përfaqësues nga sektori OJQ-ve). Shkollat gjithashtu tregojnë një nivel mungese të ndihmesës

sa i përket këtyre fëmijëve kryesisht për shkak se u mungon një qasje sistematike për të ndihmuar fëmijët në nevojë:

“NE KEMI AFËRSISHT 30 FËMIJË ROMË NË SHKOLLËN TONË (NGA GJITHSEJ 980); ATA JETOJNË PA GJËRA BAZË, E LEJE ME MË TEPËR... NE I KEMI KONTAKTUAR ATA... DHE U TAKON ORGANIZATAVE, NJERËZVE, KOMPANIVE QË T’U NDIHMOJNË ATYRE TË MARRIN PJSË”

-(mësues).

Ky është një problem sistematik ku të dhënat në lidhje me statusin socio-ekonomik të nxënësve mungojnë në nivel shkolle dhe kjo e bën edhe më të vështirë vlerësimin e nevojës për ndihmë në aspektin e qasjes në arsim.

NXËNËSIT E CENUESHËM REAGUAN PËR ATË SE NUK KISHIN QASJE NË INTERNET DHE PAJISJE TË IT-SË ME QËLLIM QË TË PËRCILLNIN MËSIMIN. NE U MUNDUAM TË MARRIM TË DHËNA NGA SHKOLLA, POR ATA MENDUAN SE DO U JAPIM KOMPJUTERË DHE INTERNET TË GJITHËVE, DHE KËSHU NUK MORËM NDNJË TË DHËNË TË SAKTË SE SA FËMIJË KISHIN NEVOJË PËR KOMPJUTERË DHE INTERNET

(zyrtar shtetëror). Pastaj, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale mundësoi USB me qasje në internet për afërsisht 30 000 nxënës nga marrësit e ndihmave sociale. Disa të intervistuar përmendën që disa kompani u kanë dhënë kompjuterë nxënësve në nevojë. Këto veprime e korrigjuan situatën disi, por arsimtarët dhe përfaqësuesit e

OJQ-ve tregojnë se disa nxënës në nevojë, familjet e të cilëve nuk marrin ndihmë sociale ishin lënë jashtë. Këto veprime e korrigjuan situatën disi, por arsimtarët dhe përfaqësuesit e OJQ-ve tregojnë se disa nxënës në nevojë, amvisëritë e të cilëve nuk marrin ndihmë sociale ishin përjashtuar nga kjo asistencë.

Një numër i të intervistuarve theksuan që shkollat dhe stafi ndonjëherë përballen me probleme në qasje:

“MËSUESIT NJËLLOJ KANË NEVOJË PËR PAJISJE NGASE ATA I KANË PËRDORUR TË VETAT... ÇFARËDO QË KANË PASUR EDHE ÇFARËDO QË KANË GJETUR. KËSHTU, DUHET TË MUNDËSOJMË PAJISJE TË IT-SË NË SHKOLLA TË CILAT MËSUESIT DO T’I PËRDORNIN PËR TRAJNIME, PLATFORMA DHE MJETE”

- (zyrtar shtetëror). Kjo është edhe më me rëndësi kur kemi të bëjmë me rastet e shkollave që gjenden në zonat e largëta, shkollat rurale dhe shkollat në zonat nevojtare; nevoja për veprim është tashmë e njohur nga sektori i OJQ-ve:

“MUNDOHEMI TË SHOHIM SE A KEMI MUNDËSI T’U NDIHMOJMË DISA SHKOLLAVE RURALE ME PAJISJE, LAPTOPË, KOMPJUTERË, POR EDHE LAPTOPË PËR NXËNËS TË CILËT DO T’I ISHIN PËRDORUR ATA JO VETËM NË KOHË KRIZASH, POR EDHE GJATË ORËVE TË RËNDOMTA.”

Fëmijët me aftësi të kufizuara janë një grup i veçantë i cenueshëm për shkak se atyre

u duhet një qasje individuale në procesin arsimor. Shteti ka filluar përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkollat e rëndomta, por një numër i njerëzve dhe institucioneve që punojnë në arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara mendojnë se ky proces është i rëndë të aplikohet në praktikë. Pengesat në përfshirje kanë më së shumti të bëjnë me kategorizimin e fëmijëve të tillë, problemet në vlerësimin e tyre, mungesës së stafit mbështetës dhe bashkëpunimit institucional, mungesës së trajnimit dhe zhvillimit profesional të mësuesve (Avokati i Popullit i Republikës së Maqedonisë së Veriut, 2016). Nuk ka të dhëna të plota në lidhje me numrin e saktë të fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkollat e rregullta. Stafit mësimdhënës i mungon përgatitja e mjaftueshme metodologjike dhe didaktike për punë me fëmijë të këtillë, mungojnë ekipet e plota të specializuara që do të punonin me fëmijët në një numër shkollash, si dhe mungojnë resurset financiare për të pajisur shkollat me materiale të nevojshme për fëmijët me aftësi të kufizuara (Qendra e burimeve të prindërve, NA). Plani mësimor në shkolla është i fokusuar në aktivitetet nga perspektiva e mësimdhënies sesa ajo e mësimnxënies dhe qasja ndaj fëmijëve ende është shumë mjekësore (Hollenweger dhe Martinuzzi, 2015). Kjo do të thotë që në situatën aktuale fëmijët me aftësi të kufizuara mund



të lihen në pajisjet e tyre më shpesh sesa bashkëmoshatarët e tyre, pasi që shkollat kanë filluar vetëm implementimin e arsimit gjithëpërfshirës dhe nuk janë të pajisur për t'u përballë me çështjet e mësimin nga distanca.

Për qasje në arsim gjatë mësimin në distancë, fëmijët me aftësi të kufizuara kanë nevojë jo vetëm për qasje në internet dhe pajisje digjitale, por edhe për pajisje të specializuara për qasje në materiale mësimore dhe bërje të detyrave:

"KEMI FËMIJË TË CILËT NUK MUND TA PËRDORIN KOMPJUTERIN NË MËNYRË TË RREGULLT. ATA NUK KANË TEKNOLOGJI NDIHMËSE NË SHËTËPI, DHE KËSHTU ATA NUK MUND TA PËRDORIN KOMPJUTERIN DHE EFEKTET E MËSIMIT NË DISTANCË JANË TË PASHMANGSHME. PËR SHËMBULL, NJË FËMIJË ME PARALIZË CEREBRALE MUND TË KETË KOMPJUTER NË SHËTËPI POR NUK MUND TA PËRDORË SHKAKU I KUFIZIMEVE QË KA NË LËVIZJEN E DUARVE, AI S'MUND TË MBAJË NJË MI TË RREGULLT. DHE KJO NUK KA TË BËJË ME MUNDËSITË INTELEKTUALE, POR ME QASTEN NË TEKNOLOGJI"

- (përfaqësues nga sektori OJQ-ve).

Nevojitet një përzierje komplekse e zgjidhjeve, që e nxit nevojën e planifikimit dhe mbështetjes së mëtutjeshme; sektori i OJQ-ve është i përfshirë në proces duke i ndihmuar institucionet dhe fëmijët: Në njërën nga iniciativat tona, ne bashkëpunuam me

Partenij Zografski, qendrën për fëmijë me dëgjim të dëmtuar, dhe kuptuam që e drejta e tyre për arsimim është e kufizuar. Ne tashmë kemi filluar një iniciativë në të cilën MASH-i dhe BZhA-ja do të mundësojnë përdorimin e gjuhës me shenja në programet edukative të televizionit kombëtar në mënyrë që këta fëmijë të mund t'i përcjellin. Ka një vetëdije për këtë edhe në nivel qeverie, por gjithashtu ka edhe një frikë se këta probleme dhe çështje rëndë adresohen dhe shqyrtohen edhe në rrethana normale.

## 4.3. NDIKIMI I VIRUSIT KOVID-19 NË ARSIM DHE REZULTATET NDËR-SEKTORIALE

### 4.3.1. Një ndryshim praktik dhe i shpejtë pa unifikim

Gatishmëria e shkollave dhe mësuesve për të mundësuar shkollim cilësor për të gjithë është problem kyç gjatë pandemisë. Kritika më kryesore drejt sistemit arsimor është se shkollat harxhojnë shumë në kompensimin e stafit derisa jo mjaft fonde u dedikohen investimeve kapitale, ku disa shkolla – shumica të paprivileguara – janë lënë me fonde të pamjaftueshme (Byrne, 2020). Duke pasur këtë parasysh, shumica e të intervistuarve theksuan që vendi ka arritur të mobilizojë resurset në dispozicion dhe është përgjigjur mirë dhe relativisht shpejtë për vazhdimin e procesit mësimor në pandeminë aktuale pavarësisht mungesës së strategjisë për situata të këtilla:

PRA, NË PËRGJITHËSI NUK KA PASUR STRATEGJI, POR VETËM MASA TË PËRCAKTUARA PËR MBËSHTETJEN E MËSIMIT NË SITUATËN AKTUALE. DUKE MARRË PARASYSH RRETHANAT, MENDOJ SE IA KANË ARRITUR TË KENË REZULTATE MË TË MIRA TË MUNDSHME

- (përfaqësues nga sektori OJQ-ve). Zyrtaari shtetëror i ka lavdëruar mësuesit dhe punonjësit tjerë arsimor për punën e mirë që kanë bërë dhe ka thënë se kjo e vërteton potencialin profesional të personelit mësimor.

Punonjësit arsimor përmendën që kanë pranuar udhëzime dhe se përgjithësisht ishin të kënaqur me komunikimin me MASH-in, edhe pse preferonin që udhëzimet t'i kishin pranuar më shpejtë dhe si tërësi. Shembuj pozitiv janë krijimi i një klase në televizion pas disa javësh nga mbyllja fizike e shkollave dhe platforma Edulno (shih **Kutinë 2**).

Shumica e të intervistuarve ishin kritikë për mungesën e strategjisë për integrimin real të mësimin digjital para pandemisë, megjithëse ekzistonte një dispozitë ligjore për shkollat që të zbatonin TIK në mësimdhënie dhe mësim. Ky është një fragment i një vlerësimi rutinor dhe integral të vetëvlerësimit (Inspektorati Shtetëror i Arsimit, 2014) nga një arsimtar: (Inspektorati Shtetëror i Arsimit, 2014):

JAM I VETËDIJSHËM PËR STRATEGJITË E NDRYSHME TË MASH-IT DHE MINISTRITË E TJERA DHE ATO EKZISTOJNË VETËM NË LETËR NDËRKAQ REALIZIMI I TYRE ËSHTË I DISKUTUESHËM. GJITHASHTU, NË STRATEGJINË PËR ZHVILLIMIN E ARSIMIT 2010-2025 TË HARTUAR MË PARË NUK PËRMENDET MËSIMI DIGJITAL. STRATEGJIA E RE E VITI 2018-2025 E PËRMEND MËSIMIN DIGJITAL VETËM NJË HERË NË PJESËN E ARSIMIT SIPËROR... PRA NË TË GJITHA KËTO DOKUMENTE NË 10 VITET E KALUARA NE AS NUK PËRMENDIM MËSIMIN DIGJITAL APO NË DISTANCË

- (mësues praktikant).




Zyrtarët shtetëror gjithashtu theksojnë që vendi nuk ka kornizë ligjore për mësimin në distancë duke paraqitur një barrë shtesë në situatën aktuale:

**NUK KEMI PASUR MËSIM NË DISTANCË SI SHTET, AS NË KORNIZËN LIGJORE ... KJO ËSHTË NJË PENGESË DHE SFIDË MË E MADHE**

- (zyrtar shtetëror). Disa nga të intervistuarit përmendën nevojën për plane veprimi që janë të lidhura me një strategji të caktuar që do të ndihmonte në implementimin e aktiviteteve arsimore në rrethana të ndryshme:

**NEVOJITEN INSTRUKSIONE TË SHKRUARA DHE TË QARTA SI NJË PLAN ME FAZA DHE HAPA TË IMPLEMENTIMIT TË KËTIJ LLOJI TË MËSIMIT. NË KËTË MËNYRË, MËSUESIT MUND TË KONSULTOHEN ME NJËRI TJETRIN, TË KOMUNIKOJNË, TË NDAJNË PRAKTIKA TË DOBISHME, TË MARRIN KËSHILLA ... POR ËSHTË ME RËNDËSI QË KJO TË CAKTOHET NGA MASH-I DHE BZHA-JA ME NJË SASI FLEKSIBILITETI ME QËLLIM INDIVIDUALIZIMIT DHE IMPLEMENTIMIT TË TYRE NË MËNYRËN MË TË MIRË**

- (përfaqësues nga sektori OJQ-ve). Prandaj, vendi duhet të sjellë dispozita ligjore për mësimin në distancë si dhe një strategji që do të ishte një udhëzim gjatë mësimin në distancë kur do t'u nevojiteshte.



## **KUTIA 2: PRAKTIKAT PREMTUESE QË KANË SIGURUAR VAZHDIM TË ARSIMIT PËR TË GJITHË**

Leksionet e transmetuara në televizionin kombëtar dhe e-klasa në platformën Edulno (<http://edulno.gov.mk/>) – dy mjete mbështetëse të krijuara menjëherë pas përhapjes së pandemisë – mbeten të jenë praktika premtuese për mbështetjen e procesit mësimor gjatë pandemisë. Në fillim, ne nisëm me transmetimin e një programi në Televizionin Kombëtar “TV klasa” në gjuhën maqedone dhe shqipe, dhe nganjëherë edhe në turqisht dhe serbisht. Që nga java e dytë e këndeje kemi pasur përmbajtje për të gjithë nëntë klasat e shkollës fillore. Me përfshirjen e BZHA-së, leksionet janë në përputhje me kurikulën; pastaj, mësuesit marrin instruksione e më pastaj i realizojnë ata (zyrtar shtetëror). Ideja kryesore ishte që të mbështetet mësimi në ato fusha të cilat u konsideronin më të rëndësishmet: matematika, gjuha amtare dhe shkathtësitë në shkencë, si dhe të mundësohet përkrahje në nxënien e hershme. Adaptimi i shpejtë në një platformë në internet, që ka shërbyer si resurs i vlefshëm për mjediset e shkollave fillore dhe të mesme, ka qenë më e lavdërueshme nga të intervistuarit. Procesi i krijimit të një platforme vetëm se kishte filluar derisa pandemia nxiti intensifikim të mëtejshëm. Pra, tash kemi rreth 200 video nga stafi parashkollor që shërbejnë si resurs në arsimimin e fëmijëve (zyrtar shtetëror).

Leksionet në TV dhe e-klasa shërbejnë si një resurs i rëndësishëm për mësuesit praktikantë dhe prindërit në rritjen e nxënies të fëmijët, sidomos në vitet e hershme. Gjithashtu e ka mobilizuar stafin dhe ua ka shtuar motivimin që të mbështesin edhe më tepër procesin e nxënies të fëmijët: Përveç e-klasës, ne kemi edhe e-grupin e lojërave në YouTube ku stafi mësimdhënës është i përfshirë me xhirimin e videove. Në fillim ishte sa pak e çuditshme, por bazuar në reagimet e prindërve, vërejtëm që fëmijët ishin të lumtur dhe kërkonin ende (mësues praktikant). Interesimi impresionues në platformë dhe video materiale mbështetet nga të dhënat e mundësuar nga SmartUp Innovationlab. Një përmbledhje e dhënë më 27 maj 2020 tregon që e-grupi i lojërave kishte 301 video me më shumë se 200,000 shikime, derisa e-klasa për shkollat fillore kishte 501 video me më shumë se 1,300,000 shikime.

Edhe pse është iniciativë premtuese dhe e shkallëzuar, platforma ende nuk ka materiale për shkollat e mesme, andaj larmia e rritur e lëndëve në këtë nivel, veçanërisht në shkollat profesionale, do të jetë një sfidë për zhvilluesit e vetë platformës. Siç përmendi një nga mësuesit praktikantë, puna në këtë drejtim po ec përpara dhe se ka koordinatore për çdo lëndë që po punojnë në krijimin e video leksioneve. Një pjesë e problemit me shkollat e mesme është edhe mungesa e përgatitjes së mësimdhënësve në përdorimin e materialeve dhe pajisjeve digjitale: Kemi dhënë mjaft

mund për të siguruar materiale të mira por rezultatet kanë qenë zhgënjyese në fillim... pastaj na patën thënë që u mungojnë pajisjet e sofistikuara si dhe shkathtësitë për të bërë atë (zyrtar shtetëror), e që do të thotë se ka nevojë që të punohet me mësimdhënësit dhe t'u mundësohen trajnime për përdorimin e mjeteve digjitale si pjesë e zhvillimit profesional të tyre.

Platforma konsiderohet një resurs i vlefshëm nga të gjithë të intervistuarit edhe pse ata dhanë një vërejtje që asaj i mungon opsioni që u mundëson përdoruesve komunikim të dyanshëm. Kjo është një vërejtje valide marrë parasysh faktin se në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies participimi dhe interaktiviteti me nxënësin është i nevojshëm. Prandaj, përdorimi i platformës tani për tani është ende resurs plotësues: Nëpërmes një ankete, ne zbuluam që mënyra e vetme që mësuesit e përdorin platformën tonë është për përsëritje të materialit apo për përgatitje të orëve ku fëmijët e shohin përmbajtjen e e-leksionit dhe më pastaj mësimdhënësi e merr në dorë duke bërë pyetje, vlerësim, komente, diskutim (përfaqësues i OJQ).

Grupi i ri punues tash po punon në propozimin e një koncepti për një platformë interaktive që mund të përdoret edhe në shkollimin e rregullt, pra, diçka nga përmbajtja mund të përdoret kur fëmijët janë në shkollë ose kur janë në shtëpi për shkak të sëmundjes apo arsyeve të tjera të ndryshme (zyrtar shtetëror). Përmirësimi i platformës do të mundësojë funksione të tjera shtesë: Ne e kemi testuar konceptin e e-testimit, jo vetëm për vlerësim, por si një mënyrë për nxënësit të vetë-vlerësojnë diturinë e tyre. Ne gjithashtu jemi duke e testuar e-orarin për shkak se kemi kuptuar që një ndër problemet me të cilin edukatorët përballen është edhe komunikimi joformal. Ne duam të lëvizim drejt një platforme ku çdo nxënës dhe mësues do të kishte nga një emër përdoruesi dhe fjalëkalim dhe ku ata do të mundnin të kyçen dhe të përcjellin leksionet, të marrin nota etj. (përfaqësues i OJQ).

UNICEF-i dhe "Open the Windows" (Hapni dritaret), në bashkëpunim me MASH-in, njëlloj kanë krijuar një platformë që ka për qëllim ndihmën ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe prindërve të tyre (<https://otw.assistive.mk>), duke mundësuar plane të individualizuara për mësimdhënie dhe mësimnxënie për gjithë ata fëmijë që kanë nevojë për ta. Këshillat dhe planet në fjalë nuk janë vetëm për fëmijët që janë në shkollë, por edhe për ata të moshës parashkollore. Megjithatë, sipas përfaqësuesit të "Open the Windows" , lidhja që mungon në platformë është mësuesit gjë e cila kërkon vëmendje të veçantë në të ardhmen.

### 4.3.2. Gatishmëria e shkollave dhe mësuesve

Të dhënat nga PISA 2018 në **Grafikun 15** zbulojnë mendimet e drejtorëve të shkollave në lidhje me politikat dhe praktikrat në përdorimin e pajisjeve digjitale në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Pavarësisht nga diskutimet në lidhje me pajisjet digjitale për qëllime pedagogjike, shumica e shkollave nuk kanë marrë në konsideratë gatishmërinë për të përdorur pajisjet digjitale. Kjo mungesë politikash në nivel shkollash ka gjasa të ketë vështirësuar implementimin e mësimin të distancë ngase në fillim të pandemisë qeveria i kishte dhënë liri secilës shkollë të vendosë për organizimin e procesit. Kjo be bëri ndryshimin e arsimit jo të barabartë për nxënësit: disa shkolla u adaptuan shpejt derisa disa të tjera ende kanë vështirësi në funksionim:

“DISA SHKOLLA VEPRUAN SHPEJT DHE U DHANË INSTRUKSIONE SPECIFIKE MËSUESVE NË LIDHJE ME STRUKTURIMIN E PROCESIT MËSIMOR, PLATFORMAT QË DUHET PËRDORUR, RREGULLUAN PROCESIN E RRJEDHJES SË INFORMATAVE; DERTISA DISA SHKOLLA TJERA I LANË MËSUESIT TË PUNOJNË ME MJETET E VETA PERSONALE; ATA VETËM DUAN TË IA DALIN MBANË KËSAJ PERIUDHE, DUKE MUNDËSUAR MATERIALE VETËM E VETËM TË DËSHMOJNË SE KANË QENË AKTIVË”


-(përfaqësues nga sektori OJQ-ve).

Të intervistuarit theksuan që shumica e stafit mësimdhënës kanë përdorur platformën Viber për komunikim me nxënësit, derisa mësimdhënësit që janë teknikisht më të përgatitur, kanë përdorur mjete të njëkohshme komunikimi, si Zoom, Google Classroom, Microsoft Team si dhe platforma të specializuara për mbështetje në mësim si Kahoot dhe Edmodo, të cilat ofrojnë opsione për kuize, për ndarje të detyrave dhe mbështetje të avancuara në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Megjithatë, mësuesit kanë shprehur shqetësime për unifikimin në qasje, të nxitura nga praktika si licencimi dhe kufizimet e versioneve themelore softuerike:

“DUHET TË ZGJEDHIM PLATFORMA TË LICENCUARA ARSIMORE DHE NJË QASJE TË NJËTË PËR GJITHË SHKOLLAT, TË SHOQËRUARA ME TRAJNIME PËR MËSUESIT. NE NUK MUND TË PËRDORIM SHUMË LLOJE TË PLATFORMAVE; GJITHASHTU, PËRBALLEMI ME KUFIZIME, SI NUMRI I NXËNËSVE, KOHA PËR TË FOLUR, PAMUNDËSIA PËR TË BËRË ORAR ETJ.”

Të dhënat e PISA-s të vitit 2018, siç janë dhënë në Grafikun 16, sugjerojnë që shumica e drejtorëve të shkollave konsiderojnë se stafi ka qenë i përgatitur për integrimin e pajisjeve digjitale në mësimdhënie, kanë pasur mjaft kohë dhe stimuj për të integruar pajisjet digjitale në procesin mësimor. Në anën tjetër, një pjesë

## Grafiku 15: Praktikrat dhe politikrat e shkollave që promovojnë përdorimin e pajisjeve digjitale



**Burimi:** Baza të dhënave e PISA-s e vitit 2018: Të dhënat nga pyetëtori i shkollës

e madhe e tyre mendon që nuk ka pasur resurse të mjaftueshme me të cilat mësuesit do të mësonin se si përdoren pajisjet digjitale, derisa 40 për qind theksuan mungesën e stafit teknik për asistencë. Pikëpamje të ngjashme me drejtorët japin edhe zyrtarët shtetëror:

"MËSUESIT TANË KANË MARRË TRAJNIME PËR PËRDORIM TË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT (ICT) NË ORËT E RREGULLTA; ATA ISHIN TË OBLIGUAR TA PËRDORNIN ATË NË SË PAKU 30 PËR QIND TË ORËVE MËSIMORE."

Megjithatë, zyrtarët shtetëror kanë qenë të vetëdijshëm se mësimi në distancë kërkon një grup të ri të shkathtësive:

"NE KEMI NJË SITUATË TË RE TASH KU DUHET TË KUPTOSH GJITHË PROGRAMIN DUKE PËRDORUR MËSIMIN NË DISTANCË DHE KJO NUK KËRKON VETËM NJOHURI NË TEKNOLOGJI, POR KËRKON EDHE SHKATHTËSI TË TJERA, SI KREATIVITET, MËNYRA TË REJA TË TË MENDUARIT, MË SHUMË PJESËMARRJE."

Megjithatë, mungesa e gatishmërisë së mësuesve ka qenë e dukshme në të gjitha intervistat dhe shumë nga pjesëmarrësit sugjerorin që trajnime të shkurta nuk do të ishte e mjaftueshme për mësuesit për t'i bërë ata ta ndërrojnë mënyrën e mësimdhënies:

“MËSUESI I YNË MODERN NUK ËSHTË I PËRGATITUR PËR MËSIMDHËNIË NË SHEKULLIN 21: NUK KA MJAFT TRAJNIME DHE SHUMË PREJ TYRE JANË VËRTETË TË SHKURTA. NUK MUND TË BËSH NDRYSHIM NË TË MENDUARIT E DIKUJT PËR NJË DITË E GJYSMË. MËSUESIT TANË JANË ENDE NË NIVELIN E MEMORIZIMIT, PROBLEM KY MË I MADH I YNI. NE I INFORMOJMË MËSUESIT MBI ZHVILLIMET MË TË REJA, POR DËSHTOJMË T’UA NDRYSHOJMË MENTALITETIN”

- (mësues praktikant).


Drejtorët gjithashtu ishin kritikues për mungesën e materialeve mësimore dhe 63.4 për qind e tyre mendonin se kjo kishte ndikuar deri diku ose shumë në procesin arsimor; gjysma e drejtorëve deklaruan që materialet mësimore janë me kualiteti të dobët. Të intervistuarit theksuan mungesën

e materialeve digjitale e cila megjithatë është kompensuar me TV klasën që është transmetuar në televizionin kombëtar dhe me platformën Edulno (shih **Kutinë 2** për më shumë detaje). Rreth një e pesta e drejtorëve pjesëmarrës në PISA 2018 mendonin që mësimi i nxënësve është penguar nga rezistenca e mësuesve për ndryshim e që është mjaft e rëndësishme kur stafi adaptohet shpejt me mësimin në distancë:

KA MËSUES QË JANË REZISTENTË NDAJ NDRYSHIMIT, ATA NDJEHEN MJAFT KOMFORT NË MËSIMDHËNIËN TRADICIONALE NDOSSHTA SHKAKU I MOSHËS APO GATISHMËRISË SË PËRGJITHSHME

-(zyrtar shtetëror).

**Grafiku 16:** Kapaciteti i shkollës për të përmirësuar mësimdhënien dhe mësimnxënien duke përdorur pajisje digjitale



**Burimi:** *Baza e të dhënave PISA-s e vitit 2018: Të dhënat nga pyetësi i shkollës*

Një tjetër një e pestë e drejtorëve deklaruan se mësimi i nxënësve është penguar nga mësuesit të cilët nuk kanë kushtuar vëmendje individuale:

MASAT E MARRA NUK JANË TË ADAPTUARA ME KËRKESAT E FËMIJËVE. NË NJË NUMËR RASTESH PROCESI MËSIMOR ISHTE REDUKTUAR NË NIVELIN E DËRGIMIT TË DETYRAVE DHE INSTRUKSIONEVË PA PËRFSHIRJE AKTIVE TË MËSUESIT DHE DUKE MOS PËRDORUR ASNJË NGA PLATFORMAT. KJO PRAKTIKISHT DO TË THOSHTE SE PRINDËRIT ISHIN NË NJË SITUATË NË TË CILËN DUHEJ TË BËHESHIN ARSIMTARË DHE NUK ISHIN NË ASNJË MËNYRË TË PËRGATITUR TA MBËSHTETNIN MËSIMIN

-(përfaqësues nga sektori i OJQ-ve).

Përvoja e mësuesve në Maqedoninë e Veriut nuk është e ndryshme nga ajo e mësuesve në gjithë botën. Anketa e "School Education Gateway" me mësuesit evropianë ka zbuluar që për dy të tretat e të anketuarve, mbyllja e shkollave ka sjellë që ata të kenë përvojën e parë në mësimdhënien në internet e cila ka qenë si pozitive ashtu edhe sfiduese. Pjesa më pozitive ka qenë mundësia për të bërë një inovacion në praktikë. Problemi më i madh ka qenë qasja e nxënësve në teknologji; mbajtja e motivimit dhe angazhimit të të gjithë nxënësit; si dhe përfshirja e nxënësve nga shtëpitë me probleme sociale. Qeveritë dhe agjencitë u përgjigjën duke dhënë udhëzime për arsimtarët për

atë se si të përdoren opsionet e teknologjisë në dispozicion dhe për problemet pedagogjike gjatë mësimin online. Seminaret online për zhvillim profesional dhe trajnimet online kanë ndihmuar të rritin nivelin e shkathtësive (School Education Gateway, 2020). Andaj, mësuesit duhet të përkrahen duke ua shtuar qëndrueshmërinë, si dhe duhet mbështetur në mësimdhënie dhe nga ana e teknologjisë që të sigurohet efektshmëria të ta (Banka Botërore, 2020).

#### 4.3.3. Mësimi, materialet dhe vlerësimi

Mungesa e një qasjeje të unifikuar në organizimin e procesit mësimor ka bërë që nxënësit të pranojnë shumë aktivitetet të ndryshme në të njëjtën kohë, duke shkaktuar kështu mbingarkesë me detyra dhe duke e vënë në pikëpyetje nxënien. Gjithashtu, disa mësues kanë përdorur kohën e papërshtatshme për të dërguar detyra, derisa të tjerët kanë qenë pasivë. Kjo është në përputhje me një studim në kohën e fundit (Inchley et al. 2020) i cili tregon që nxënësit e moshës 11-15 vjeç në Maqedoninë e Veriut kanë raportuar se ndjejnë presion në rritje nga detyrat shkollore derisa rriten, e që është më i madh se vendet e tjera të anketuara. Presioni ndjehet ndryshe nga dy gjinitë dhe nga gjendja socio-ekonomike: fëmijët me gjendje socio-ekonomike të ulët kanë



raportuar më pak presion (44 për qind e djemve dhe vajzave ndjejnë presion), derisa vajzat që vijnë nga familje të pasura e ndjejnë më tepër këtë presion (59 për qind).

Disa çështje si kanë qenë më të rënda për t'i organizuar për shkollat e mesme, kryesisht marrja me fusha të ndryshme mësimore, sidomos në arsimin profesional:

SHKOLLAT PROFESIONALE DUHET TË ZBATOJNË ATË QË MËSOJNË TEORIKISHT; TANI PËR TANI ËSHTË PROBLEMATIKE SE SI TË BËHET ZBATIMI. E NJËJTA VLEN EDHE PËR DISA LËNDË TË GJIMNAZIT, KU NEVOJITEN EKSPERIMENTE NË FIZIKË, KIMI, BIOLOGJI

- (përfaqësues i OJQ). Praktikantët në shkollat profesionale presin instruksione për atë se si të ekzekutohet trajnimi praktik i obligueshëm, derisa zyrtarët shtetëror kërkojnë këshilla nga Komisioni për Sëmundje Infektive:

KOMISIONI NA KA KËSHILLUAR QË TRAJNIMI PRAKTIK DUHET TË ANULOHEK DERI NË SHTATOR DHE NE THJESHTË PRESIM TË SHOHIM SE SI DO TË RRJEDHË SITUATA

- (zyrtar shtetëror).

Vlerësimi i nxënësit gjatë pandemisë ka qenë një çështje e debatuar për një kohë të gjatë. Zyrtari shtetëror nënvizoi se ata kanë përgatitur instruksione sa i takon vlerësimit të nxënësit. Megjithatë, të intervistuarit i konsideronin shumë të gjëra dhe të paqarta. Kur kësaj i shtohet edhe intervenimi i prindërve për

nota më të mira, vlerësimi online mund të dështojë nëse nuk bëhet në mënyrë strukturore e cila do të siguronte që vlerësimi do të reflektonte diturinë dhe aftësinë e vërtetë të nxënësve:

MËSUËSIT PËRDORIN VLERËSIM TË VAZHDUESHËM DHE PËRFUNDIMTAR NË MJEDISËT E KLASAVE... TANI KJO ËSHTË KREJTËSISHT NDRYSHË... TASH PËRBALLEMI ME NJË SITUATË NË TË CILËN FËMIJA E BËN TESTIN NDËRSA NËNA IA MBAN LIBRIN NËN TAVOLINË. DUHET QË TË ZHVILLOJMË STRATEGJI PËR VLERËSIM

- (mësues praktikant).

#### 4.3.4. Gatishmëria e prindërve

Mungesa e materialeve mësimore dhe gatishmëria jo e mjaftueshme e mësuesve për të kaluar në modelin e mësimi në distancë ka bërë që prindërit të marrin pjesë në mënyrë aktive në procesin arsimor:

KISHIM NJË SITUATË KU PRINDI ISHTE I DETYRUAR TË LEXOJ SË PARI MATERIALIN, PASTAJ TË BËJË HULUMTIM DHE MËSOJ PËR VETE NJËHERË PARA SE TA MËSOJË FËMIJËT E VET

- (përfaqësues i OJQ). Kjo situatë përkeqësoi disproporcionin në aspektin e mbështetjes që prindërit mund të japnin për fëmijët e tyre:



PRINDËRIT DUHET TË JENË SHUMË AKTIVË DHE TË PUNOJNË ME FËMIJËT E TYRE NË SHËTËPI, DHE NUK JAM I SIGURTË SE SA PRINDËR MUND TA BËJNË KËTË. NUK PO THEM QË ATA NUK DUAN TA BËJNË NJË GJË TË TILLË. POR VETËM NUK JAM I SIGURTË SE GJITHË PRINDËRIT I KANË TË GJITHA SHKATHTËSITË E DUHURA DHE ATO DIGJITALE PËR TË BËRË KËTË

- (përfaqësues i OJQ).

Niveli më i lartë i mbështetjes nga prindërit ka qenë e lidhur me rezultatet e PISA-s (OECD, 2019), që do të thotë se fëmijët që kanë pasur mungesë të stimulimit dhe mbështetjes nga prindërit mund të jenë të ndikuar më ndryshe nga mbyllja e shkollave. MICS 2019 zbulon që 69 për qind e fëmijëve të moshës 7-14 vjeç kanë pasur përkrahje me detyrat e shtëpisë në shtëpi dhe se prindërit nga dy kuintilët më të ulët janë më pak të përfshirë në aktivitetet e shkollës, menaxhimin e shkollës dhe ngjarjet. Prindërit maqedonas dhe urbanë kanë raportuar përfshirje më të lartë, dhe mjedisi i mësimi në këto amvisëri është vlerësuar si më stimulues. Prindërit me gjendje më të ulët socio-ekonomike kanë qenë shumë më të preokupuar me ekzistencën sa që i kanë bërë fëmijët edhe më të cenueshëm:

NE ZAKONISHT KEMI PROBLEME ME GRUPET E MARGJINALIZUARA DHE FËMIJËT E CENUESHËM NË ASPEKTIN SOCIAL SA I PËRKET PRANISË NË ORË DHE TANI ËSHTË AKOMA MË RËNDË T'I MOTIVOSH ATA

-(përfaqësues i OJQ).

#### 4.3.5. Arsimimi i fëmijëve të cenueshëm

Disa grupe kanë tendencë të jenë mjaft të ndikuar nga pabarazitë socio-ekonomike sa i përket mësimi. Një shembull i dukshëm është ai i fëmijëve romë të cilët kanë më shumë gjasa të shkojnë në shkolla të ndara (me përqindje në rritje duke arritur shifrën 40 për qind më 2017), që lidhet me arsimin e kualitetit të ulët për shkak të infrastrukturës së dobët dhe mungesës së resurseve, si dhe kualifikimit të ulët të mësuesve dhe qarkullimit të lartë (UNDP, 2018). Prindërit romë gjithashtu nuk janë mjaftë të përfshirë në aktivitetet shkollore dhe ata raportojnë një ambient jo mjaft stimulues për mësim. Gjithashtu, vetëm 43 për qind e fëmijëve romë flasin gjuhën e mësimi në ambiente shtëpiake (MICS 2019). Një numër i organizatave joqeveritare i mobilizuan resurset ekzistuese për të ndihmuar procesin mësimor për fëmijët në rrezik:

NE PUNOJMË ME FËMIJËT ME RREZIK PËR TA BRAKTISUR SHKOLLËN DHE ATA JANË ZAKONISHT NGA FAMILJE TË RREZIKUARA, MË SHUMË FËMIJË ROMË. ATA MUND TA HUMBIN VAZHDIMËSINË DHE TË JENË EDHE MË SHUMË TË CENUESHËM PASI PRINDËRIT E TYRE NUK I KUPTOJNË DOBITË E ARSIMIMIT. NE PUNOJMË ME NDËRMJETËSUES, ATA SJELLIN MATERIALE, PUNOJNË ME FËMIJËT, DHE KËSHU ROLI I TYRE KA NDRYSHUAR NGA NDËRMJETËSUES DHE PËRKRAHËS TEKNIK NË MENTORË

-(përfaqësues i OJQ).

Një grup tjetër i cenueshëm është edhe fëmijët me aftësi të kufizuara.

NJË GRUP TJETËR I CENUESHËM ËSHTË EDHE FËMIJËT ME AFTËSI TË KUFIZUARA. NE MUND TË THEMË QË TË GJITHA SHKOLLAT TASH JANË PËRFSHIRËSE PASI I PRANOJMË TË GJITHË FËMIJËT, POR PËRFSHIRJA ËSHTË SHUMË MË SHUMË SE PREZENCË FIZIKE. SA JEMI TË PËRGATITUR TË KEMI MËSIM NË DISTANCË ME FËMIJË TË KËTILLË? NA DUHET STRATEGJI DHE TRAJNIM PËR ATË SE SI VËRTETË MUND T'Ë PËRFSHIJMË KËTA FËMIJË NË PROCESIN MËSIMOR. NA DUHEN EDHE UDHËZIME PËR PUNË ME KËTA FËMIJË. KËTA GRUPE TË CENUESHME JANË EDHE NË NJË NIVEL MË TË LARTË RREZIKU PËR MOMENTIN

- (mësues praktikant). Të intervistuarit ishin të vetëdijshëm se mekanizmat e zakonshëm mbështetës, siç janë asistenti personal dhe teknologjia mbështetëse e specializuar, nuk janë në dispozicion për shumë fëmijë gjatë pandemisë. Disa organizata që mundësojnë mbështetje për fëmijët me aftësi të kufizuara i rritën përpjekjet:

AKTUALISHT, NE BËJMË DY LLOJ SHËRBIMESH: NJË ËSHTË AJO E KËSHILLIMIT TË PRINDËRVE NË ATË SE SI TË PUNOHET ME FËMIJË ME AFTËSI TË KUFIZUARA NË AMBIENTET E SHITËPISË; DHE TJETRA ËSHTË MBËSHTETJA E MËSUESVE GJATË ADAPTIMIT TË MATERIALIT MËSIMOR NEVOJAVE TË KËTYRE FËMIJËVE

- (përfaqësues i OJQ).

Megjithatë, mbështetja që këto organizata e japin është e lidhur

me projektet ekzistuese, dhe mundësimi sistematik i këtyre shërbimeve mungon. Duke kuptuar nevojën për një ndihmesë më të strukturuar, MASH-i në bashkëpunim me UNICEF-in<sup>25</sup> dhe "Open the Windows" lëshuan një depo të resurseve për t'u dalë në ndihmë fëmijëve dhe familjeve, si dhe një sërë materialesh mund të merren në faqen e internetit të shkollës së veçantë.

#### 4.4. MBËSHTETJA E FAMILJEVE NË SIGURIMIN E PËRKUJDESJES DHE MBËSHTETJES NË MËSIM TË FËMIJËVE PARASHKOLLOR

Ekziston një kuptim i gjerë mes pjesëmarrësve në hulumtim i rëndësisë së mësimit të hershëm të fëmijët dhe adresimin e çështjes së mësimit dhe përkujdesjes së tyre gjatë krizave në krahasim me opinionin e zakonshëm që institucionet parashkollore janë ambiente të parëndësishme për fëmijët.

"SHUMICA E NJERËZVE NË VEND MENDOJNË QË INSTITUCIONET PARASHKOLLORE SHËRBEJNË VETË PËR USHQIM DHE GJUMË. GJASHTË VITET E PARA JANË TË RËNDËSISHME PËR ZHVILLIMIN E FËMIJËS DHE DUHET TË PUNOJMË NË NDRYSHIMIN E MENDËSISË SË POPULLATËS"

- (mësues praktikant). Shumica e të intervistuarve deklarojnë që mësimi është i rëndësishëm dhe se një numër i fëmijëve dhe

<sup>25</sup>Më shumë detaje mund të gjenden në këtë [link](#).

familjeve janë lënë të përballohen me rrethanat e veta gjatë pandemisë.

“PERIUDHA MË KRITIKE TANI ËSHTË PËR PARASHKOLLORËT. KËTA FËMIJË GJENDEN NË NJË PERIUDHË KUR U DUHET MË SË SHUMTI SHOQËRIMI, KONTAKTI FIZIK, MËSIMI DHE LOJËRAT, NDËRSA TANI ATA JANË LËNË ME FAMILJET E TYRE TË GJERË, DISA PREJ TË CILËVE GJITHASHTU PUNOJNË. NUK ËSHTË PUNA VETËM TË PËRKUJDESESH, POR ME RËNDËSI ËSHTË EDHE EDUKIMI DHE ARSIMIMI I TYRE”

- (përfaqësues i OJQ).

Të dhënat e MICS (**Tabela 12**)

**Tabela 12:** Ndarjet në përvojat e fëmijërisë bazuar në aktivitete që promovojnë gatishmërinë në shkollë dhe mësimin

	Fëmijët e moshës 2-4 vjeç me të cilët anëtarët e amvisërisë janë angazhuar në katër apo më tepër aktivitete (%)	Numri mesatar i aktiviteteve në të cilat çdo anëtar i rritur i amvisërisë ka qenë i angazhuar me fëmijën	3 ose më tepër libra për fëmijë në amvisëri (% e amvisërive)	Dy apo më tepër lloje të lodrave për fëmijë
Zona				
<b>Urbane</b>	91,4	5,3	61,8	67,3
<b>Rurale</b>	83,4	4,9	43	52,7
<b>Kuintilët e indeksit të pasurisë</b>				
<b>Më i varfër</b>	69,7	4,2	17,2	48,2
<b>I dytë</b>	88,3	5	44,9	55,2
<b>I mesëm</b>	94,5	5,5	57,8	62,9
<b>I katërt</b>	94,3	5,6	75,4	68,8
<b>Më i pasur</b>	99,4	5,8	83,9	75,3
<b>Përkatësia etnike</b>				
<b>Maqedonas</b>	97,1	5,6	78,6	71,6
<b>Shqiptar</b>	80,5	4,8	27,4	39,9
<b>Të tjerë</b>	73,8	4,3	26,3	67,8

Burimi: MICS 2019.

zbulojnë kategori në përvoja fëmijërore që ka gjasa të kenë ndikim në aftësinë për të marrë pjesë në mësimin në distancë, për grupe të ndryshme të fëmijëve. Fëmijët e moshës parashkollore nga kuintili më i varfër janë të rrethuar nga një ambient mësimor më pak stimulues sesa ai i shokëve të tyre nga kuintili më i pasur. Të parët gjithashtu kanë më pak libra në shtëpi. Dallime mund gjithashtu të vërehen edhe në ndarjen urban-rural. Fëmijët e moshës parashkollore që jetojnë në vende urbane marrin

pjesë në më shumë aktivitetet duke promovuar gatishmërinë e shkollës sesa ata të vendeve rurale, si dhe më shumë nga ta kanë qasje në libra. Fëmijët maqedonas duket se kanë më shumë aktivitetet stimuluese dhe më shumë mjete apo sende në shtëpi që stimulojnë mësimin krahasuar me shokët e tyre nga etnitë tjera. Fëmijët romë janë shumë të ndikuar nga mungesa e ndihmës nga prindërit gjatë mësimit në vitet e hershme, pasi vetëm 55.3 për qind e atyre të moshës 2-4 vjeç kanë qenë të angazhuar në aktivitetet që ndihmojnë nxënien dhe numri mesatar i aktiviteteve është vetëm 3.7. Vetëm 14.5 për qind e fëmijëve romë kanë më shumë se 3 libra në shtëpi ndërsa vetëm 49.8 për qind kanë më shumë se tri lodra në shtëpi. Kjo do të thotë që shumë fëmijë parashkollor mund të jenë ndikuar në masë të madhe nga mungesa e aktiviteteve shkollore dhe angazhimit të prindërve gjatë pandemisë.

Stafi i arsimit parashkollor vazhdoi të përkrahte prindërit në mënyrë që të stimulojnë mësimin e hershëm dhe zhvillimin e fëmijëve duke sugjeruar aktivitete që mund t'i bënin me fëmijët e tyre:

**"STAFI DHE PRINDËRIT KRIJUAN NJË GRUP NË VIBER DHE PROGRESI I FËMIJËVE KA QENË I PËRCJELLË PËRMES ATIJ. STAFI NDANTE AKTIVITETE NDËRSA PRINDËRIT U PËRGJIGJESHIN ME FOTO TË AKTIVITETEVE DHE KRIJIMEVE"**

-(zyrtar shtetëror). Në raste të caktuara, stafi ka dhënë edhe mbështetje shtesë:

**"NË FLASIM ME PRINDËRIT NË LIDHJE ME GJENDJEN PSIKOLOGJIKE TË FËMIJËVE, U JAPIM DISA STRATEGJI PËR ZHVILLIM SOCIO-EMOCIONAL DERISA JANË NË SHTËPI"**

-(mësues praktikant). Megjithatë, i gjithë procesi i është lënë institucioneve individuale parashkollore duke rrezikuar kështu që një numër i fëmijëve me gjasë të humbasin mundësi arsimore gjatë pandemisë. Ngjashëm me rastet në nivel shkollor, është mjaft e rëndësishme të krijohet një strategji që do të shërbente si udhëzues për të gjithë praktikuesit për të mbështetur mësimin e hershëm te fëmijët:

**"PRIORITETET PËR MOMENTIN JANË PËRKUJDESJA NDAJ SHËNDETIT MENTAL TË FËMIJËVE DHE ZHVILLIMIN E TYRE SOCIAL DHE EMOCIONAL. MEGJITHATË, NA DUHET NJË PROTOKOLL PËR MËSIMIN E HERSHËM DHE PËRKUJDESJEN GJATË GJENDJES SË JASHTËZAKONSHME. TË GJITHA PROGRAMET TONA JANË TË BAZUARA NË PREZENCË FIZIKE"**

-(mësues praktikant).

Pandemia nxiti nevojën për krijimin e materialeve mësimore që mund të përdoren në ambiente shtëpiake që do të stimulonin mësimin dhe zhvillimin. Gjithashtu e bëri aktuale nevojën për të mbështetur të gjithë prindërit dhe fëmijët pa marrë parasysh se ku jetojnë dhe çfarë rrethana familjare kanë:

“PËR FËMIJËT PARASHKOLLËR, NEVE NA NEVOJITET INTERAKTIVITET AKOMA EDHE MË I MADH; NEVE NA DUHET NJË PERSON QË ËSHTË JOSHËS, GAZMOR, ENERGJETIK QË NXIT VËMENDJE DHE LOZJE GJATË MËSIMIT. NE GJITHASHTU KISHIM DHE ENDE PO PUNOJMË TË PRANOJMË EDHE MË TEPËR AKTIVITETET ONLINE QË DO TË JENË SHUMË TË DOBISHME NË AMBIENTE SHITËPIAKE. UNICEF-I E PËRMENDI KËTË DERI NË NJË MASË KUR TREGUAN PËR KRIJIMIN E MATERIALEVE DIGJITALE, POR MENDOJ SE NA DUHEN EDHE MË TEPËR. JEMI SHUMË TË CENTRALIZUAR NË SHKUP DHE ZONAT URBANE, DERISA DUHET T’U AFROHEMI ZONAVE RURALE”

-(përfaqësues i OJQ).

#### 4.5. KONTRIBUTE TË JASHTME POZITIVE

Krizja mobilizoi të gjithë kontribuesit në arsim dhe ka rezultuar në disa kontribute pozitive të jashtme. Së pari, të gjithë të intervistuarit theksuan solidaritetin mes palëve përkatëse:

“SOLIDARITETI ËSHTË RRITUR: MËSUESIT PO E NDIHMOJNË NJËRIT TJETRIN, AMVISËRITË PO NDIHMOJNË NJËRA TJETRËN, SIDOMOS KUR BËHET FJALË PËR FËMIJËT E PRIVUAR NGA SHOQËRIA”

-(përfaqësues i OJQ). Solidariteti ka qenë i shprehur nga donacionet në pajisje nga kompanitë e ndryshme për fëmijët në nevojë, mësuesit e përfshirë në TV klasë dhe në përgatitjen e videove

për platformën mësimore; interaktiviteti i rritur mes zyrtarëve shtetëror dhe shkollave. Veçanërisht i rëndësishëm është mobilizimi i sektorit të OJQ-ve në sigurimin e trajnimeve dhe mbështetjes ndaj mësuesve në përdorimin e platformave të ndryshme për mësim në distancë.

“KJO SITUATE NA KA INKURAJUAR TË THEM: ‘PRA, NE ISHIM NË GJENDJE T’I BËJMË TË GJITHË KËTO GJËRA!’, TË ADAPTOHEMI NË TË GJITHA PLATFORMA DHE TË MËSOJMË ÇKA NUK KEMI DITUR, BILE EDHE DISA NGA KOLEGËT TANË MË TË MOSHUAR – VËRTETË SHUMË AFËR PENSIONIMIT – JANË SHUMË TË VENDOSUR TË MËSOJNË GJËRA TË REJA.”

-(mësues praktikant). Një nga shembujt më të dukshëm të solidaritetit qytetar dhe profesional është mobilizimi i grupeve të mësuesve në shkëmbimin e praktikave të mira, duke dhënë këshilla njëri tjetrit dhe duke motivuar njëri tjetrin që të përdorin rrejte të ndryshme sociale, p.sh. Facebook-un, Messenger-in dhe Viber-in.

ANA POZITIVE E KËSJAJ ËSHTË SE DISA MËSUES TË ÇAKTUAR U ERDHI SHANSI TË NJIHEN PËR PUNËN E TYRE DHE TË TREGOJNË KREATIVITETIN E TYRE. DUKE QENË TË EKSPOZUAR NË PUBLIK, DISA MËSUES JANË TANIMË TË DALLUAR NËPËRMES RRJTEVE SOCIALE, FAQEVE TË INTERNETIT TË SHKOLLAVE, PRA ATA PËRKUJDESEN MË SHUMË PËR KUALITETIN E MATERIALEVE DHE DETYRAVE. TANI ATA NUK JANË VETËM TË PËRGJEGJSHËM NDAJ NXËNËSVE POR EDHE NDAJ PUBLIKUT SI TËRËSI

-(përfaqësues i OJQ).

Zyrtarët e shtetit konsiderojnë se momenti i përhapjes së përdorimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në arsim duhet të shfrytëzohet, pasi rezistenca është konfrontuar për një kohë të gjatë.

"NË TASHMË KEMI BËRË NJË HAP DHE DUHET TA SHFRYTËZOJMË KËTË NË TË ARDHMEN. DUHET TA PËRFSHIJMË PËRDORIMIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT NË KURIKULË, NË PLANIFIKIMIN E MËSIMIT, EDHE PSE DUHET TË RITIM NUMRIN E PAJISJEVE NË PËRPUTHJE ME KËTË, TË ADAPTOJMË KORNIZËN LIGJORE, SI DHE TË GJETJMË NJË MËNYRË BINDËSE QË KJO TË BËHET PJESË E VAZHDUESHME E PUNËS SË MËSUESVE"

- (zyrtar shtetëror).

Duke pasur parasysh nevojën për të ruajtur efektet e një mobilizimi të tillë brenda sektorit arsimor, një numër i të intervistuarve theksuan nevojën që procesi arsimor të mendohet përsëri. Një numër i tyre bënë thirrje për një analizë të thellë të situatës dhe vendimmarrjes bazuar në të dhëna për integrimin e mësimit digjital në kurikulën e rregullt:

"TANI DUHET TË ANALIZOJMË SE ÇKA KA NDODHUR NË DISA MUAJT E KALUAR NË MËNYRË QË TË SHOHIM SE ÇKA FUNKSIONON E ÇKA JO, DHE TË ZHVILLOJMË MODELE PËR PROCESIN ARSIMOR QË MUND TË PËRDOREN NGA SHTATORI. NUK MUND TA MENDOJMË ARSIMIN DIGJITAL VETËM SI PJESË TË PËRGJIGJES NDAJ KRIZËS – AI DUHET TË IMPLEMENTOHET SI PJESË E ORËVE TË ZAKONTA DHE TË RREGULLTA"

- (përfaqësues i OJQ).

Të intervistuarit bënë thirrje për një rishikim të sistemit arsimor duke filluar nga kurikula, trajnimi dhe mbështetja e mësuesve:

"DUHET TË MENDOJMË PËR METODËN E PËRZIER TË MËSIMIT. KA MËSIM TË RËNDOMTË DHE MËSIMI NË DISTANCË DHE NE DUHET TA ADAPTOJMË PLANIN MËSIMOR QË TË LEJOJMË KËTË. MËSUESIT DUHET TË MARRIN NJË TRAJNIM TË MJAFTUESHËM DUKE FILLUAR QË NË GUSHT. DHE E FUNDIT, NA DUHET NJË STRATEGJI, JO NJË TË TILLË QË DO TË MBETESHTË NË LETËR, POR NJË TË VËRTETË QË DO TË ISHTE E APLIKUESHME"

- (mësues praktikant).

Disa nga praktikantët bënë thirrje për ta menduar përsëri vlerat të cilat sistemi arsimor po i promovon dhe nevojën për të rishikuar ato. Një përfaqësues i OJQ-ve bëri thirrje që të shqyrtohet përsëri ajo se çka duam të stimulojmë te nxënësi si shkathtësi mësimi:



SISTEMI I NYË NUK OFRON MUNDËSI PËR MËSIM TË VETË UDHËHEQUR, QË TANI REFLEKTOHET SI PENGESË SEPSE NË MUNGESË TË UDHËZIMEVE DHE UDHËHEQTES, NXËNËSIT E KANË RËNDË TË NAVIGOJNË NËPËR MATERIALIN MËSIMOR, DERISA PRINDËRIT E KANË EDHE ME RËNDË TA MARRIN ROLIN E MËSUESIT.


Një përfaqësues tjetër nga OJQ-të bën thirrje për reformë në fusha e arsimit të mësuesve dhe zhvillimin profesional të tyre si bazë për të pajisur ata me shkathtësi dhe njohuri të nevojshme për të ardhmen. Kovid-19 bëri të qartë se sistemi arsimor e meriton vëmendje të veçantë:

“DUKE QENË NË ARSIM PËR 30 VJET, MUND TË THEM SE, FATKEQËSISHT, SISTEMI ARSIMOR NUK KA QENË ASNJËHERË E RENDITUR LARTË NË AGJENDËN E ASNJË QEVERIE. FAMILJET TANI PËRBALLEN ME TË METAT E SISTEMI ARSIMOR DHE SHËNDËTËSOR. SHPRESOJ QË KJO SITUATË DO TË JETË NJË NXITJE PËR TË MENDUAR PËRSËRI RRETH PRIORITETEVE NË VEND, SI NË ASPEKTIN E INVESTIMEVE ASHTU EDHE NË ATË TË KRIJIMIT TË POLITIKAVE FUNKSIONALE”

- (përfaqësues i OJQ).

Hapi i parë për të integruar mësimin digjital në klasë ka qenë në proces e sipër, për shkak se MASH-i, BZhA-ja dhe QAPT-i (të përkrahura financiarisht nga USAID-i dhe UNICEF-i dhe me MCEC-in si një partner për implementim) filluan një strategji për mësimin digjital. Sipas

zyrtarëve shtetëror, ajo do të përfshijë një qasje integruese ndaj mësimin digjital, përfshirë edhe konsideratat pedagogjike, politikat që përkrahin përdorimin e mjeteve teknologjive të IT-së dhe plan veprimi për çdo rrethanë. Gjithashtu, MASH-i po punon në përgatitjen e protokolleve për kthim të sigurtë të fëmijëve në objektet shkollore duke filluar nga shtatori.







## 5. FËMIJËT QË PËRBALLEN ME RREZIK SHËNDETI

Trendet globale gjatë Kovid-19 sugjerojnë që fëmijët janë me gjasa më të ulëta për t'u infektuar në krahasim me të rriturit dhe se një numër i madh i tyre janë pa simptome (Gudbjartsson et al. 2020). Fëmijët që janë simptomatik përjetojnë simptome më të buta në krahasim me të rriturit: ata mund të tregojnë simptome të tipit të gripit si temperaturë, kollitje dhe ftohje, apo mund të kenë simptome gastrointestinale si vjellje dhe diare. Vetëm pak nga ta kanë vështirësi me frymëmarrje dhe që do kishin nevojë për pranim të përkujdesjes intensive (OECD, 2020a). Pak fëmijë vdesin nga Kovid-19, megjithëse indikacionet e hershme nga vendet e Evropës perëndimore sugjerojnë që këta vdekje mund të jenë të lidhura

me problemet tjera shëndetësore ekzistuese. Derisa duket që fëmijët janë më rezistentë ndaj Kovid-19 sesa të rriturit – kryesisht për shkak të sistemit të fortë imunitar (Dong et al. 2020) – roli i tyre në shpërndarjen e virusit mbetet i paqartë (Zimmermann and Curtis, 2020).

Ky seksion fillon me një përmbledhje të kapaciteteve institucionale dhe njerëzore të sistemit shëndetësor të Maqedonisë së Veriut që u përdorën si përgjigje ndaj pandemisë së Kovid-19. Më pas, jep një vlerësim të mënyrës në të cilën fëmijët në Maqedoninë e Veriut kanë qenë të ndikuar nga pandemia. Të dhëna administrative dhe përgjigje nga anketat e bëra me mjekë të përgjithshëm do të përdoren në analizë.

## 5.1. KAPACITETI I SISTEMIT SHËNDETËSOR GJATË KOVID-19

Shërbimet mjekësore në Maqedoninë e Veriut dominohen nga përkujdesja e spitaleve dhe i mungon një sistem i fortë i kujdesit themelor. Maqedonia e Veriut ka një rrjet të gjerë spitalësh (mesatarisht 3.2 për 100,000 banorë), me 4.5 shtretër për 1000 banorë (WHO, 2019). NJë karakteristikë pozitive e sistemit shëndetësor e trashëguar nga ish Jugosllavia ka qenë sistemi i monitorimit dhe kontrollimit të sëmundjeve infektive (Milevska-Kostova et al. 2017). Kjo karakteristikë akoma konsiderohet si një pikë e fortë e sistemit, së bashku me parandalim të fortë dhe qasjen pa pagesë në kujdesin shëndetësor në vendin e dhënies së tij.

Instituti i Shëndetit Publik dhe Qendrat e Shëndetit Publik janë përgjegjëse për të kontrolluar dhe monitoruar sëmundjet përhapëse në vend. Instituti një institucion profesional i nivelit më të lartë i cili mundëson shërbime si promovim të shëndetit përmes monitorimit, hulumtim dhe analizë të statusit shëndetësor të popullatës dhe hartimin e masave për mbrojtjen dhe promovimin e shëndetit të popullatës. Dhjetë qendrat e shëndetit publik janë përgjegjëse për të mundësuar shërbime publike shëndetësore në nivel lokal në fushat e

mjekësisë sociale, shëndetit mjedisor, epidemiologjisë dhe mikrobiologjisë, si dhe shërbime laboratorike.

Niveli më i lartë i kujdesit shëndetësor lidhur me trajtimin e pacientëve me sëmundje përhapëse mundësohet në nivel terciar në Klinikën Universitare për sëmundje infektive dhe kushtet febrile, derisa ekzistojnë departament për sëmundje infektive të nivelit të dytë në secilin prej tre spitaleve klinike publike në Manastir, Shtip, dhe Tetovë, si dhe në nëntë spitale të përgjithshme në Shkup, Kumanovë, Veles, Gostivar, Ohër, Prilep, Kavadarç, Strumicë dhe Dibër.

Epidemiologët janë pjesë e Institutit dhe Qendrave të Shëndetit Publik. Më 2017, ka pasur 42 epidemiolog, që është 2.1 për 100,000 banorë (**Tabela 13**). Sipas numrit mesatar të epidemiologëve, vendi është i pozicionuar diku në mes, krahasuar me shtetet fqinje: Bosnja dhe Hercegovina 1.5, Serbia 2.1, Mali i Zi 4.2, Kroacia 4.5. Krahasuar me numrin e përgjithshëm e specialistëve në vend, epidemiologët përbëjnë 1.1 për qind. Si pjesë e sistemit shëndetësor publik, 30 epidemiologë punojnë në Institutin dhe Qendrat e Shëndetit Publik, e që është 20.3 për qind e numrit total të mjekëve në këto institucione. Sipas anketës me mjekët e përgjithshëm, ka

**Tabela 13:** Numri i epidemiologëve në institucionet e shëndetit publik

Institucioni	Numri
ISHP	2
QSHP Manastir	3
QSHP Veles	3
QSHP Koçanë	2
QSHP Kumanovë	3
QSHP Ohër	3
QSHP Përlep	3
QSHP Shkup	2
QSHP Strumicë	6
QSHP Tetovë	1
QSHP Shtip	2
<b>Totali</b>	<b>30</b>
<b>Totali në vend</b>	<b>42</b>

**Tabela 14:** Numri i specialistëve për sëmundje ngjitëse sipas rajonit

	Norma	2017
<b>Niveli sekondar</b>		
Pellagoni	5	10
Vardar	3	5
Verilindje	4	4
Jugperëndim	5	5
Juglindje	4	4
Pollog	7	8
Lindje	4	4
Shkup	14	4
<b>Niveli terciar</b>		
Shkup	-	28
<b>Totali</b>	<b>44</b>	<b>72</b>

*Burimi: Institut i Shëndetit Publik, Burimet njerëzore të ofruesit të shëndetit në Republikën e Maqedonisë së Veriut (2017) dhe Ministria e Shëndetit, Rrjeti shëndetësor dhe Instituti i Shëndetit Publik, Burimet njerëzore të ofruesit të shëndetit në Republikën e Maqedonisë së Veriut*

mungesë të epidemiologëve dhe specialistëve të sëmundjeve infektive që tashmë i ka dhënë edhe efektet negative në menaxhimin e pandemisë.

Numri i specialistëve për sëmundje infektive më 2017 ka qenë 72, apo 3.6 për 100,000 njerëz (**Tabela 14**). Ata janë pjesë e ofruesve të kujdesit shëndetësor të nivelit të dytë dhe të tretë. Në nivelin e dytë, Rrjeti Shëndetësor përcakton një normë e cila parasheh një specialist për 45,000 banorë. Në të gjitha regjionet, përveç Shkupit, numri i specialistëve të këtyre është mbi ose në nivel të normës. Megjithatë, në kryeqytet përveç

katër specialistëve në spitalin e përgjithshëm, ka edhe 28 tjerë që punojnë në nivelin terciar, apo 5.1 specialistë për 100,000 banorë. Derisa nuk ka të dhëna publike në lidhje me infermiere që punojnë në departamentet infektive në spital, ka 58 infermiere që punojnë në Klinikën për Sëmundje Infektive.


Vendi ka 1,445 mjekë aktivë të përgjithshëm dhe specialistë të mjekësisë familjare në nivelin primar, e që financohen nga Fondi i Sigurimit Shëndetësor (FSSh). Ka 0.78 mjek të përgjithshëm për çdo 1,000 banorë (FSSh, 2020), megjithëse numri është ulur për 104 mjekë në krahasim me një

vit më parë. Mosha mesatare e mjekëve të përgjithshëm më 2018 ishte 46.4 vjeç. Specialistët pediatrik janë pjesë e kujdesit shëndetësor të nivelit primar numri i të cilëve në vend është zvogëluar nga 9.5 për 10,000 fëmijë më 2011 në 8.2 më 2017 (Grafiku 17). Gjinekologët, si specialistë më deficitar në vend, regjistruan një ulje më të vogël për të njëjtën periudhë, nga 3.5 për 10,000 gra në vitin 2011 në 3.3 në 2017. Këto ulje mund të rrezikojnë shëndetin e nënave shtatzënë, fëmijëve dhe të porsalindurve gjatë Kovid-19.

Mjekët pediatër nga Klinika e Fëmijëve kanë asistuar specialistët për sëmundje infektive në raste ku fëmijët ishin të infektuar me

Kovid-19, veçanërisht fëmijët me sëmundje të tjera. Zakonisht fëmijët e këtyllë ishin trajtuar në klinikën e Sëmundjeve Infektive ku ekipet ishin ndihmuar nga nën-specialistët nga Klinika e Fëmijëve, edhe pse kontakti i parë me disa prindër ishte me të dytët.

**Grafiku 17:** Numri i pediatërve për çdo 10,000 fëmijë dhe gjinekologëve për çdo 10,000 gra



**Burimi:** Institut i Shëndetit Publik, Burimet njerëzore të ofruesit të shëndetit në Republikën e Maqedonisë së Veriut 2011 dhe 2017; Zyra Statistikore e Shtetit, Vlerësimet e popullsisë 2011 dhe 2017

"NE VENDOSËM NJË NJËSI AMBULATORE TË PËRKOSSHME PËR T'I NDARË PACIENTËT E RËNDOMTË NGA ATA QË DYSHONIM SE KANË KOVID-19 DHE KAPACITETI I KËTILLË FIZIK NUK ËSHTË PROBLEM. SFIDA ËSHTË PERSONELI PËR SHKAK SE JO ÇDO PEDIATËR ËSHTË I PAJISUR ME AFTËSI TË KUJDESET PËR FËMIJË QË KANË NEVOJË PËR PËRKUJDESJE INTENSIVE. NË KLINIKË, NE KEMI VETËM 9 PEDIATËR PËR PËRKUJDESJE INTENSIVE DHE NUK MUND TA TRAJNOSH NJË PEDIATËR BRENDA NJË JAVË OSE NJË MUAJ TË PUNOJË NË NJË NJËSI PËR PËRKUJDESJE INTENSIVE,"

- sqaron një mjek pediatër.

Duke ndërtuar lidhje mes mjekëve të përgjithshëm, objektet diagnostikuese të KOVID-19 dhe ofruesit e kujdesit shëndetësor, *"Termini im"* - sistemi elektronik i regjistrimit shëndetësor në Maqedoni – ka qenë i përdorur plotësisht për të rekrutuar mjekë të përgjithshëm në procesin e detektimit dhe, pjesërisht, në trajtimin e pacientëve me Kovid-19. Derisa epidemiologët u fokusonin në testimin e klasterëve dhe kontaktet e pacientëve të diagnostifikuar, mjekëve të përgjithshëm u ishte caktuar një kontakt kryesor për popullatën me simptoma. Bazuar në një algoritëm pyetjesh, mjekët e përgjithshëm përdornin *"Termini im"* për të planifikuar testimin. Mjekët e përgjithshëm të anketuar shprehën nivel të madh të mbështetjes (70 për qind) për këtë masë të autoriteteve me

argumentin se njohuritë e tyre mjekësore dhe përvoja luajnë rol të rëndësishëm në vlerësimin e simptomave të Kovid-19.

Roli i dytë i rëndësishëm i mjekëve të përgjithshëm ishte në trajtimin e pacientëve të diagnostifikuar. Derisa pacientët e rëndë dhe të rrezikuar ishin trajtuar në spitale dhe Klinikë, qasja e autoriteteve ishte që rasteve buta të trajtohenin në shtëpi nën mbikëqyrje të mjekëve të përgjithshëm. Mjekët ishin në kontakt të vazhdueshëm me pacientët dhe raportonin vazhdimisht në sistemin *"Termini im"*. Specialistët për sëmundje infektive gjithashtu përdornin sistemin *"Termini im"* të monitorojnë raportet e mjekëve të përgjithshëm dhe jepnin mendime përmes sistemit në lidhje me trajtimet e caktuara apo nevojën për hospitalizim. Përfshirja e mjekëve të përgjithshëm në trajtimin e rasteve të buta ishte përkrahur gjerësisht, me 74 për qind të të anketuarve mjekë.

Mjekët e përgjithshëm dhanë një notë mesatare prej 3.31 (nga gjithsej 5) sa i përket infrastrukturës dhe kapacitetit fizik të sistemit në përgjithësi, si dhe një notë mesatare diç më të ulët prej 3.09 sa i përket pajisjeve në sektorin shëndetësor. Nga ta gjithashtu u kërkua të notojnë kapacitetet e kujdesit shëndetësor primar. Ata i dhanë një notë të ulët kapaciteteve të nivelit që ata punojnë krahasuar me kapacitetet

e sistemit shëndetësor për t'u kujdesur për sëmundjet përhapëse. Nota mesatare sa i përket burimeve njerëzore në nivelin primar ishte 2.95 dhe ende më e ulët sa i përket furnizimeve mjekësore të hudhshme dhe pajisjeve bazike, e që ishte 2.09. Specialisti pediatër njëlloj i nje pengesat e mundshme: Po të ishin prekur fëmijët me Kovid-19 sa pleqtë, do të kishte qenë vështirë të reagoheste në mënyrë efektive.


**"E VETMJA NJËSI PËR KUJDES INTENSIV PËR FËMIJË ËSHTË KLINIKA E FËMIJËVE ME 20 SHITRËTËR, TË CILËT PËRDOREN KRYESISHT PËR TË SAPOLINDURIT, NËSE DO TË ISHTE DASHUR TË PËRDORET PËR RASTE TË RËNDA ME KOVID-19 DO TË KISHTE QENË RËNDË TË PËRGJIGJET."**

Mjekët e përgjithshëm i kanë identifikuar mënyrat e mëposhtme për ta përmirësuar reagimin e sistemit shëndetësor ndaj pandemisë:

- Komunikim më efikas dhe koordinim mes gjithë nivelet e kujdesit shëndetësor, për një trajtim më efikas ndaj pacientëve me Kovid-19;
- Qendrat shëndetësore të përcaktuara për diagnostikimin dhe trajtimin e pacientëve që nuk kanë Kovid-19
- Rritja e numrit të vizitave në shtëpi nga ekipet e specializuara shëndetësore për të monitoruar pacientët me Kovid-19 në mënyrë që të identifikohen herët rastet e rënda

- Janë dashur më shumë fonde për blerjen e pajisjeve personale mbrojtëse për stafin shëndetësor;
- Furnizim publik më efikas nga Ministria e Shëndetësisë të pajisjeve personale mbrojtëse për të gjithë sistemin shëndetësor.

Mjekët e përgjithshëm gjithashtu theksuan nevojën për fonde për specializim të pediatërve si një përgjigje më afatgjate ndaj shpërndarjeve të sëmundjeve infektive si Kovid-19 ose, më e rëndësishmja, të atyre sëmundjeve që prekin fëmijët në një mënyrë më të rrezikshme.





## 5.2. NDIKIMI I KOVID-19 NË SHËNDETIN E FËMIJËVE

### 5.2.1. Dhënia e shërbimeve shëndetësore

Sistemet shëndetësore janë duke u përballuar në mënyrë direkte me kërkesat në rritje si rezultat i shpërndarjes së pandemisë Kovid-19. Megjithatë, dëshmitë në rritje të kujdesit të vonuar ose të lënë pas dore janë shqetësuese dhe nxjerrin në pah efektet indirekte shëndetësore të pandemisë. Në aspektin global, shqetësimet janë shprehur nga shumë palë të interesuar në lidhje me implikimet e kujdesit të vonuar, derisa shumë vende kishin ulje drastike të rasteve emergjente, siç janë sulmet në zemër dhe sulmet në tru. Ruajtja e besimit të popullatës në kapacitetin e sistemit shëndetësor për të përmbushur në mënyrë të sigurtë nevojat thelbësore dhe për të kontrolluar rrezikun e infeksionit të institucioneve shëndetësore është thelbësore për të siguruar sjelljen e duhur të kërkimit të kujdesit dhe respektimin e këshillave të shëndetit publik. Krijimi i një sistemi efikas të procedimit të pacientëve (përfshirë kontrollin, përzgjedhja e pacientëve në bazë të urgjencës, udhëzimet për rastet e Kovid-19 dhe raste të tjera) është esenciale në të gjitha nivelet (WHO, 2020a). Studimet globale kanë zbuluar se një ulje prej 15 për qind në mbulimin e ndërhyrjeve

thelbësore shëndetësore për shpëtim jetësh për 6 muaj në shtetet me të ardhura të ulëta dhe të mesme lidhet me 9.8 për qind rritje të mortalitetit të fëmijët nën 5 vjeç dhe 8.3 për qind rritje të mortalitetit të nënat shtatzëna apo gjatë lindjes (Robertson et al. 2020).

Përderisa fëmijët nuk kanë qenë të goditurit kryesor të infeksionit, zvogëlimi i dukshëm i qasjes në kujdesin pediatrik mund të rezultojë në mungesë të resurseve në dispozicion shkaku i redistribuimit të tyre si rezultat i Kovid-19, apo mund të ketë përmbajtje nga ana e prindërve dhe kujdestarëve duke i ikur ekspozimit ndaj Kovid-19. Fëmijët me nevoja të veçanta janë me mundësi më të kartë rreziku prej sëmundjeve të rënda shkaku i mungesës së qasjes në kujdesin shëndetësor (Lazzerini et al. 2020). Hulumtimet rreth efekteve të pandemive dhe katastrofave në të kaluarën të fëmijët qartazi tregojnë që do të ketë pasoja të këqija si në aspektin afatshkurtër ashtu edhe atë afatgjatë, me rreziqe të veçanta që mund të përballen gjatë fëmijërisë së hershme kur arkitektura e trurit ende zhvillohet hovshëm apo është shumë i prekshëm nga rreziqet nga ambienti (Shonkoff et al. 2012).

Llogaritjet parashikojnë rritje të vdekshmërisë së nënave shtatzëna dhe fëmijëve në vendet me të ardhura të ulëta dhe të



mesme shkakut se shërbimet shëndetësore për rastet që nuk kanë të bëjnë me Covid-19 bëhen të pakta si dhe si rezultat i rrezikut në rritje nga pasojat shkatërruese fizike, socio-emocionale dhe kognitive gjatë gjithë jetës së fëmijëve (Yoshikawa et al. 2020). Qeveria e Maqedonisë së Veriut bëri përshtatje sa i përket sigurimit të kujdesit shëndetësor gjatë Covid-19. Mjekët e përgjithshëm dhe specialistët ishin të lejuar të vizitohen vetëm në raste emergjente, derisa disa ofruan të kujdesit shëndetësor, siç janë dentistët, ishin të imponuar t'i mbyllin ordinancat si dhe shërbimet e rëndomta shëndetësore në spitale ishin shtyrë. Gjithashtu, kontrollet e zakonshme për sëmundje kronike ishin anuluar. Ndryshime në dhënien e udhëzimeve dhe

recetave u miratuan në mënyrë që të minimizohen kontaktet derisa u siguroi një vazhdimësi të kujdesit esencial shëndetësor. Për shkak se shtyrja e kujdesit shëndetësor gjatë pandemisë mund të përbëjë një rrezik ndaj shëndetit të përgjithshëm të popullatës, mjekët e përgjithshëm u munduan ta ndërronin regjimin e zakonshëm të punës me atë të ndihmës përmes telefonit. Ata gjykuan se trajtimi i shëndetit mental dhe sëmundjeve kronike ka qenë më shumë më i ndikuar nga kriza e Covid-19 në Maqedoninë e Veriut, përkatësisht me një mesatare prej 4.28 dhe 4.25 të regjistruar në anketën me mjekët e përgjithshëm. Shëndeti riprodhues (3.3) dhe kujdesi shëndetësor ndaj foshnjave (3.43) kanë qenë të vlerësuar si më pak të ndikuara (**Grafiku 18**).

**Grafiku 18:** Vlerësimi i mjekëve të përgjithshëm sa i përket efekteve të Covid-19 në shërbimet themelore shëndetësore



*Burimi:* GPs Survey


Vlera e përgjithshme e shërbimeve të ofruara të kujdesit shëndetësor u ul për 34 për qind gjatë marsit dhe prillit të vitit 2020, krahasuar me të njëjtën periudhë para një viti. Ulja ka qenë e ngjashme si me llojin e kujdesit spitalor ashtu edhe me atë ambulator. (Grafiku 19, majtë). Ulje dukshëm më e madhe është vërejtur në sektorin publik (38 për qind)(Grafiku 19, në mes). Për fëmijët (vetëm shërbime spitalore), ulja ka qenë prej 33 për qind ka qenë më e vogël krahasuar me atë në popullatën e përgjithshme prej 39 për qind (Grafiku 19, djathtë), që nënkupton se nga aspekti i ofrimit të shërbimeve fëmijët nuk kanë qenë të ekspozuar ndaj Kovid-19 më shumë se popullata e përgjithshme. Një specialist pediater e vërtetoi këtë:

"QË NGA FILLIMI, INSTITUTI NË KOZLE ISHTE I PËRGATITUR TË PRANOJË FËMIJË QË KANË ETHE, DERISA NË [KLINIKA E FËMIJËVE, N.B.] VAZHDOAM ME AKTIVITETET E ZAKONSHME, PËR SHEMBULL REPARTI PËR KUJDES INTENSIV DHE AI I HEMATO-ONKOLOGJISË KANË PUNUAR SIPAS PLANIT, DHE KËSHTU SITUATA NUK KA NXITUR NDOJË NDRYSHIM DOMETHËNËS SA I PËRKET OFRIMIT TË SHËRBIMIT PËR PACIENTËT E TJERË."


Prandaj, ulja në ofrim të shërbimeve është kryesisht i lidhur me kërkesën e ulët dhe me anulimin e disa kontrolleve dhe diagnostikimeve të rregullta, ku kanë lejuar kushtet.

"DIAGNOSTIKIMI I SËMUNDJEVE KRONIKE KA VUAJTUR MË SHUMË, POR JO EDHE TRAJTIMI. PRINDËRIT NUK VIJNË TË VIZITOJNË MJEKUN PËR SHKAK SE KANË FRIKË,"

- vërtetoi specialisti pediater.



**Grafiku 19:** Reduktimi i sasisë së shërbimeve sipas llojit të kujdesit shëndetësor, llojit të pronësisë së ofruesit (të shërbimeve) dhe moshës



*Burimi:* Fondi i Sigurimit Shëndetësor


Qendrat e Shëndetit Publik kanë pasur shkurtime të këtylla më të larta (53 për qind) të cilat kanë hise më të vogël në strukturën e shërbimeve të përgjithshme në sektorin publik, megjithëse kanë qenë të parat që janë përgjigjur në frontin kundër pandemisë (**Grafiku 20**, majtë). Spitalet e përgjithshme dhe ato klinike janë përballur me ulje, përkatësisht prej 47 për qind dhe 44 për qind, duke u pasuar nga Klinikat universitare dhe Spitalet e veçanta, derisa uljet më të lehta që janë vërejtur janë ato të Qendrave të shëndetit. Sa i takon fëmijëve, Klinika Universitare për Kirurgjinë e Fëmijëve ka shënuar uljen më të madhe prej 46 për qind, derisa Instituti i Kozles, ku sëmundjet e frymëmarrjes trajtohen, shënoi uljen më të lehtë (13 për qind) (**Grafiku 20**, djathtë), që do të thotë se ofrimi i shërbimeve është


mirëmbajtur mirë edhe gjatë rrezikut prej Covid-19.

Sipas distribuimit gjeografik, reduktimi më i madh i 10 grupeve më të zakonshme të shërbimeve është vërejtur në regjionin e Pollogut (46 për qind), derisa më e vogla është shënuar në regjionin e Vardarit (28 për qind). Shkupi, si regjion me ofrim më të madh të kujdesit shëndetësor prej 60 për qind në vend, u përballua me reduktim prej 31 për qind.

E vërejtur nëpërmes sëmundjeve, reduktim në numër të shërbimeve të kujdesit spitalor është shënuar në të gjitha grupet e KKD-së (Kategoria Kryesore Diagnostikuese) (**Grafiku 21**). Në të shumtën e shërbimeve shëndetësore sa i përket sistemeve qarkulluese dhe respiratore, uljet arrijnë në 40% dhe 46%. Shërbimet e kujdesit


**Grafiku 20:** Reduktimi sipas llojit të ofruesve të kujdesit shëndetësor, atij të përgjithshëm dhe për fëmijë





Burimi: Fondi i Sigurimit Shëndetësor

**Grafiku 21:** Numri i shërbimeve në dhjetë grupet më të zakonshme të shërbimeve (KKD)




Burimi: Fondi i Sigurimit Shëndetësor

shëndetësor të lidhura me shtatzëninë, lindjes së fëmijëve dhe lehonisë regjistruan një përqindje prej 25 për qind, ndërsa te të porsalindurit dhe grupet e tjera të porsalindurve (periudha prenatale) reduktimi është 19 për qind. Shërbimet e kujdesit shëndetësor për sëmundjet dhe çrregullimet e sistemit riprodhues te femrat u ulën për 33 për qind derisa për sëmundjet dhe çrregullimet mentale për 46 për

Vëzhguar sipas llojit të shërbimeve spitalore që u ofrohen fëmijëve (**Grafiku 22**), shërbimet në grupin më të rëndomtë të sëmundjeve të frymëmarrjes (pas të porsalindurve dhe foshnjave të tjera) shënuan ulje prej 39 për qind; në sëmundjet që janë të lidhura me veshin, hundën, gojën dhe fytin, 38 për qind derisa në shërbimet e sistemit tretës shërbimet u ulën për 48 për qind.

**Grafiku 22:** NNumri I fëmijëve-shërbimet e kujdesit spitalor (KKD)




*Burimi:* Fondi i Sigurimit Shëndetësor

Oasja e Ministrisë së Shëndetësisë për të bërë nivelin sekondar dhe terciar të bëjnë shërbime vetëm për pacientët me Covid-19 dhe shërbime urgjente për rastet që nuk janë të lidhura me pandeminë, mund të ketë implikime për shëndetin e gjithë popullatës (përfshirë edhe fëmijët), për shkak të mungesës së diagnostikimit dhe trajtimit të sëmundjeve të tjera, veçanërisht atyre kronike (të lidhura me kancer, kardiovaskulare, dhe atyre me diabet), anulimin e kontrolleve që mund të rezultojnë në gjetjen e vonshme të sëmundjeve duke lënë kështu qytetarët të përballen me probleme me shëndet në shtëpi dhe që kanë vetëm mjekun e përgjithshëm në dispozicion. E të ndikojë gjithë situata mund të ndikojë keq në shëndetin mendor

të fëmijëve, derisa mungesa e aktiviteteve fizike mund ta rrit nivelin e trashjes, sidomos mes fëmijëve (anketa e mjekëve të përgjithshëm). Për shkak se resurset kritike mungojnë gjatë Covid-19, treguesit kryesorë shëndetësorë të fëmijëve, si vdekshmëria e nënave gjatë lindjeve dhe fëmijëve dhe sëmundshmëria e fëmijëve mund të shtohen dhe të kthejnë tendencën e rritjes së kohës së fundit (**Grafiku 23**). Të dhënat e parakohshme të Entit shtetëror për statistikë (2020) vërtetojnë këto shqetësime: vdekjet e foshnjave janë rritur prej 5.8 (mars 2019) dhe 4.5 (prill 2019) për 1000 lindjeve të gjalla në 10.5 dhe 11.3 në 2020.

**Grafiku 23:** Shkalla e vdekshmërisë të nënat dhe fëmijët



**Burimi:** Indikatorët zhvillimorë botëror.



## 5.2.2. Vaksini

Imunizimi është një shërbim esencial i kujdesit shëndetësor i cili mund të ndikohet nga pandemia. Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë, pengimi i shërbimeve të imunizimit, qoftë kjo edhe për një periudhë të shkurtër, mund të rezultojë në rritje të numrit të individëve të ndjeshëm dhe rritje të mundësisë të sëmundjeve që janë të prira për shpërthim dhe që parandalohen me anë të vaksinimit siç është sëmundja e fruthit (WHO, 2020b). Shkolla e Higjienës dhe Mjekësisë Tropikale në Londër ka llogaritur dobitë shëndetësore të imunizimit të vazhdueshëm rutinor të foshnjat kundër rrezikut nga infeksioni me Kovid-19. Shkalla e problemit varet nga kohëzgjatja e vonimit dhe nëse fëmijët që kanë humbur një dozë apo dy do të mund të përfshihen në kalendarin e mjekëve para kthimit në shkollë apo çerdhe. Akademia Amerikane e Pediatriës sugjeron që imunizimi i fëmijëve duhet të jetë prioritet i lartë gjatë Kovid-19.


Shërbimet preventive, siç është imunizimi dhe kontrollimi preventiv, tradicionalisht kanë mbulim të madh dhe në rritje në Maqedoninë e Veriut (Grafiku 24). Ofrimi i shërbimit është universal për të gjithë fëmijët dhe adoleshentët, pa marrë parasysh statusin e tyre të sigurimit shëndetësor. Vendi e ka bërë të obligueshëm vaksinimin kundër

virusit të hepatitit B për të gjithë foshnjat e lindura pas nëntorit të vitit 2003 dhe kundër Papilloma virusit njerëzor për të gjithë vajzat të moshës 9-12 vjeç që nga 2010 (Milevska Kostova et al. 2017), si dhe vaksinat kundër sëmundjeve Rota dhe Pneumokoku për të gjithë foshnjat duke filluar nga korriku i vitit 2019.

Pas shpërthimit të Kovid-19, Qeveria e Maqedonisë së Veriut sugjeroi që vaksinimi, si një aktivitet vendimtar i kujdesit shëndetësor i lidhur me fëmijët, nuk duhet të ndërpritet dhe duhet të vazhdojë sipas kalendarit të imunizimit. Ky rekomandim ka qenë veçanërisht i theksuar për të porsalindurit dhe fëmijët parashkollor. Një intervistë me ekipin e vaksinimit e konfirmoi faktin që se ata vazhdimisht e bënin vaksinimin dhe se nuk kishte devijim nga kalendarin e imunizimit. Në anën tjetër, opinioni i mjekëve të përgjithshëm është i përzier: gjysma e tyre priten rënie afatshkurte të numrave të imunizimit si rezultat i mbylljeve dhe distancimit, derisa 36 për qind shprejonin se rrethanat e Kovid-19 do të rezultojnë në një rritje të vetëdijes për vaksinim dhe kështu përqindja e imunizimit do të rritet në të ardhmen.

**Grafiku 24:** Shkalla e imunizimit, sipas llojit

*Burimi:* OBSH Databaza e të dhënave globale të shëndetit



### 5.2.3. Shëndeti mendor i fëmijëve

Shëndeti mendor i fëmijëve është duke u bërë një sfidë e rëndësishme e sistemeve shëndetësore nëpër botë. Sipas një raporti të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (2020c), mirëqenia mendore te adoleshentët ka qenë në rënie edhe para pandemisë së Kovid-19. Mbyllja, distancimi fizik dhe mbyllja e shkollave gjatë pandemisë mund t'i përkeqësojë gjendjen: të rrit friken te fëmijët dhe të prindërve të tyre. Studimet në sferën e ndikimit psikologjik të karantinës kanë raportuar efektet negative edhe atë simptoma të stresit post-traumatik, konfuzion dhe zemërim (Brooks et al. 2020).

Gjërat që japin stres kanë qenë mjaft të gjalla, përfshirë karantina e zgjatur, frika nga infektimi, frustrimi, mërzia, furnizimi jo i mjaftueshëm, informacioni joadekuat, humbja financiare dhe njolla. Megjithatë, dëshmitë tregojnë që ndikimi i Covid-19 në shëndetin mendor të fëmijëve ka qenë i vogël në këtë fazë (Pew Research Center, 2020), derisa mësimi në distancë mund të ndihmojë në zvogëlimin e efekteve potenciale negative të izolimit. Efekte të këtylla negative mund të përkeqësohen më tej mes fëmijëve nga familje me gjendje socio-ekonomike të ulët për shkak se për ta kriza shton rrezikun financiar dhe sigurisë sociale, si dhe mes fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Të gjithë të intervistuarit theksuan se mungesa e prezencës në shkolla, që do të thotë mungesë të kontaktit me mësues, shokë dhe staf për mbështetje profesionale, mund të ketë ndikime të rënda në shëndetin mendor të nxënësve. Gjithashtu, disa nxënës do të humbasin mundësinë e festimeve të zakonshme derisa mbarojnë një fazë të shkollimit dhe fillojnë një fazë të re që gjithashtu mund të ketë ndikim në ndjenjat e tyre. Në situata të këtylla edhe disa çështje dhe probleme të caktuara mund të kalojnë pa u vërejtur dhe të krijojnë më shumë probleme, si për shembull bullizmi:

"TANI MUND TË KEMI BULLIZËM NË INTERNET E QË ËSHTË AKOMA EDHE MË I FRIKSHËM SE BULLIZMI FIZIK; NË SHKOLLË, ATA MUND TË VIJNË TEK UNË NDËRSA TANI ATË NUK E KE MË" (MËSUES PRAKTIKANT).  
SPECIALISTI PEDIATËR THEKSON: "ME SIGURI, FËMIJËT E MOSHËS SHKOLLORE, SIDOMOS ATA HIPERAKTIVË DHE ATA ME NEVOJA TË VEÇANTA, PËRBALLOHEN ME FRIKË DHE PASOJË NË SHËNDETIN MENDOR, DERISA FËMIJËT PARASHKOLLORË JANË MË TË QETË SEPSE JANË NË SHËTËPI ME PRINDËRIT".

Një numër praktikantësh dhe përfaqësuesish të OJQ-ve u përfshinë në dhënien e mbështetjes ndaj fëmijëve duke kuptuar që shëndeti mendor i nxënësve, prindërve dhe mësuesve do të ndikohet rëndë dhe do të jetë një sfidë e re të cilën do të duhet përballur.

Në nivelin institucional, linjat telefonike për mbështetje psikologjike ishin mundësuar nga autoritetet shëndetësore në bashkëpunim me UNICEF-in dhe Klinikën Psikiatrike Universitare për fëmijë, tinxherë dhe fëmijë me aftësi të kufizuara. Kjo përfshinë mbështetje për fëmijë kur ata tregojnë stres apo shqetësim, duke këshilluar mënyra për të mirëmbajtur rutinën dhe kontaktin social me shokët.

“NJERËZIT I FRIKOHEN STIGMATIZIMIT NË PËRGJITHËSI E LEJ MË TË BISEDOSH NË LIDHJE ME PROBLEMET PSIKOLOGJIKE NËPËRMES TELEFONIT. INFORMIMI DHE KOMUNIKIMI NË KËTO TEMA MUND TË NDIHMOJNË NË PLANIN AFATMESËM”

-sqaron specialisti pediatër. Mjekët e përgjithshëm konsiderojnë që trajtimi i shëndetit mendor do të jetë më shumë i ndikuar mes shërbimeve esenciale të kujdesit shëndetësor gjatë Covid-19, me një mesatare prej 4.28 nga 5.66% e tyre kanë vërejtur keqësim të shëndetit mendor.


#### 5.2.4. Nënmat dhe të porsalindurit

PGratë shtatzëna mund të jenë më të prekshme ndaj infeksione virale të frymëmarrjes, sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë, krahasuar me popullatën e përgjithshme për shkak të ndryshimeve imunologjike dhe fiziologjike (OECD, 2020a). Megjithatë, të dhënat në dispozicion nga vendet

e tjera nuk i japin përkrahje hipotezës se ka përhapje në rritje të Covid-19 te gratë shtatzëna. Në anën tjetër, McCarthy (2020) ka gjetur që ekzistojnë lindje të parakohshme të nënat që u testuan pozitiv ndaj virusit korona gjatë shtatzënisë, megjithëse shakatarit ende nuk është konfirmuar. Shëndeti i grave dhe nënave shtatzëna mund të luaj një rol të rëndësishëm në mirëqenien afatgjatë të fëmijës. Studime të individëve që kanë ngelur shtatzëna dhe janë para lindjes gjatë pandemisë, katastrofave natyrore apo urisë (Torche, 2011) kanë nxjerrë në pah mundësitë për pasoja negative dhe afatgjatë nga kësi lloji tronditjesh, si humbje të arritjeve dhe përfitimeve nga arsimit, dhe rritjen e mundësisë për mbipeshë, sëmundjeve jo ngjitëse dhe probleme shëndetësore mendore.

Shëndeti i grave dhe nënave shtatzëna ka qenë ndër prioritetet e sistemit shëndetësor në Maqedoninë e Veriut. Ndryshe nga mjekët e përgjithshëm, shërbimet gjinekologjike në nivel primar, veçanërisht për gratë shtatzëna, vazhduan të jepen personalisht gjatë pandemisë. Gjithashtu, ka pasur riorganizim në nivel sekondar dhe terciar, duke bërë që Klinika Universitare për Gjinekologji dhe Obstetrikë të fokusohet më shumë në rastet e dyshimta me Covid-2019 dhe në rastet e komplikuar, derisa të gjitha ofrimet e tjera kanë qenë

**Grafiku 25:** Numri i shërbimeve për nëna dhe foshnja të porsalindur



*Burimi:* Fondi i Sigurimit Shëndetësor

të caktuara të bëhen te spitali i veçantë për gjinekologji dhe obstetrikë në Çair të Shkupit. Bazuar në informatat të marra nga Klinika Gjinekologjike, asnjë nga të porsalindurit gjatë periudhës së Kovid-19 nuk ka dalë pozitiv me virus. Sipas një deklaratë të dhënë nga Instituti i Shëndetit Publik, 61 gra shtatzëna kanë dalë pozitiv me virus Kovid-19 deri më qershor 2020, prej të cilëve 15 të hospitalizuar dhe me dy raste fatale. Në këto rrethana, shërbimet e kujdesit shëndetësor për nëna dhe të porsalindurit janë reduktuar për 25 për qind për periudhën e njëjtë në vitin e kaluar (**Grafiku 25**), pjesërisht të ndikuara nga trendet demografike dhe shkallës në rritje të ofrimeve në spitalet private.

### **KUTIA 3: PABARAZITË RAJONALE DHE ETNIKE SA I PËRKET QASJES NË SHËRBIMET GJINEKOLOGJIKE PËRKEQËSOHEN GJATË KOVID-19**

Për shkak të stafit të infektuar me Kovid-19, një spital privat me reputacion për shëndetin e nënave dhe fëmijëve në Manastir u mbyll në mes të pandemisë për 15 ditë. Autoritetet shëndetësore e organizuan transferimin e të gjithë pacientëve me gjendje urgjente ose intervenimet që nuk mund të anuloheshin gjatë kësaj periudhe (shtatzëni, lindje etj.) ishin trajtuar nga spitalet e tjera në rajonin e Pellagonisë në kryeqytet. Ky rast ka qenë i rëndësishëm nga pikëpamja e përqendrimit të gjinekologëve në një vend, krahasuar me numrin e paktë të gjinekologëve në kujdesin shëndetësor publik në rajon. Mungesa e 7 nga 17 gjinekologëve në shëndetësinë sekondare në rajon e ka ekspozuar vulnerabilitetin rajonal në qasjen në shërbime gjinekologjike dhe të obstetrikës.

Rasti i Shuto Orizarit i nxjerr në pah pabarazitë etnike në qasjen në kujdesin gjinekologjik. Kjo pjesë e njohur e Shkupit e banuar me romë ka mungesë të një gjinekologu primar për shumë vite. Përderisa problemi është zgjidhur shkurtimisht përmes ofrimit të koncesioni për shërbime private gjinekologjike në këtë mjedis, mjeku “”iku” në një pjesë tjetër të qytetit në janar të vitit 2020<sup>26</sup> pa dhënë arsye për këtë veprim. Pra, përsëri, mjedisi i banuar nga rreth 40,000 romë mbeti pa një gjinekolog, me çka u thellua edhe më tej ndjeshmërinë e popullatës vendase, që veç më përballëj probleme që kanë të bëjnë me kujdesin para lindjes dhe të shëndetit të nënën dhe rreziqet e ndërlydhura me lindjen e foshnjës.

<sup>26</sup>A Alsat-m.tv, „Шупка остана без гинеколог, побегна во Ченто“ (24 Јануари 2020), qasur më 19 qershor, 2020.



### 5.3. PËRDORIMI I METODAVE ALTERNATIVE NË SISTEMIN SHËNDETËSOR GJATË PANDEMISË SË KOVID-19

Gjatë pandemisë, shtetet kanë provuar të përdorin teknologji të ndryshme për të minimizuar kontaktet fizike me njerëzit dhe veçanërisht brenda sistemit të kujdesit shëndetësor. Në përgjithësi, janë tri zona kryesore ku mjetet digjitale shëndetësore po përdoren në përballimin e Kovid-19: komunikimi; monitorimi dhe vëzhgimi; dhe përkrahja e ofrimit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor. Përdorimi i mjeteve të këtylla ende po evoluon, derisa venet i përdorin më shumë mjetet ekzistuese (për shembull tele-shëndetësia) apo zhvillojnë të reja (siç janë aplikacionet për të mbështetur gjurmimin e kontaktit).

Disa vende ose e kanë prezantuar ose e kanë zgjeruar mënyrën e sistemit të kujdesit shëndetësor të përdorimit të telemjekësisë qasjen e shërbimeve nga distanca, pa kontakte personale. Në Kroaci, Luksemburg, Romani dhe Spanjë konsultimet nëpërmes telefonit ishin përdorur për popullatën e përgjithshme apo për grupe të pacientëve. Në Britani të Madhe një sistem për përzgjedhje të pacientëve ishte prezantuar për të ndihmuar udhëzimet që kanë të bëjnë me kancer dhe për të shmangur prani të panevojshme nëpër spitale. Gjithashtu është përdorur edhe një komunikim i

lartë teknologjik duke përdorur konferenca me video si dhe janë përdorur shumë shpesh edhe platforma tjera online

Shtetet gjithashtu i kanë rritur përpjekjet për të mundësuar kujdes në shtëpi (nga sistemi shëndetësor, shoqërisë civile apo vullnetarët). Me kufizimet dhe shërbimet në vend, shumë shtete prezantuan apo zgjeruan iniciativat për të mundësuar kujdes në shtëpi, veçanërisht për grupet e cenueshme (Kroaci, Qipro).

Gjatë pandemisë Kovid-19, Maqedonia e Veriut zgjodhi t'i përdorte gjithnjë e më tepër teknologjitë e shëndetësisë digjitale kurdo që të jetë e mundur. Në këtë drejtim u arrit një përdorim efikas të sistemit të regjistrimit shëndetësor nacional *"Moj Termin"* në përgjigje ndaj virusit Kovid-19. Ekipi *"Moj Termin"* në Ministrinë e Shëndetësisë (MSH) hartoi një modul të ri për parandalimin dhe monitorimin e pacientëve të infektuar. Ky modul ishte i përbërë nga një nënmodul për ekzaminim dhe një nënmodul për monitorimin e trajtimit të Kovid-19 në shtëpi të pacientëve të infektuar. Sistemi ndihmoi në mbrojtjen e mjekëve dhe pacientëve që kanë nevojë për kujdes shëndetësor kundër virusit, dhe e bëri më të lehtë regjistrimin dhe analizimin e të dhënave për pacientët e infektuar. Siç u përmend më lart, telemjekësia u përdor gjerësisht nga mjekët e nivelit primar, por




edhe nga disa nga specialistë. Vendi gjithashtu shfrytëzoi plotësisht sistemin ekzistues të TIK-së në sektorin e shëndetësisë për dhënie prioritete dhe caktim të testimit për Covid-19, si dhe për mbikëqyrjen dhe mjekimin e rasteve të lehta. Derisa Qeveria u angazhua në zhvillimin e aplikacionit celular StopKorona për ta mbështetur ndjekjen e kontakteve dhe për ta promovuar përdorimin e aplikacionit nga popullata, numri i shkarkimeve sugjeron që ky aplikacion ka rritur një shtrirje modeste.

Mjetet digjitale të shëndetit mund të kenë potencialin që të mbështesin një tranzicion drejt masave më të lehtësuara restriktive, por sfidat mbeten. Nga aspekti i përgjigjes ndaj pandemisë, dy pyetjet janë: nëse mjetet digjitale të shëndetit do të kishin vlerë në praktikë, dhe publiku a do t'i pranonte ato. Disa hulumtime sugjerojnë që një aplikacion mund të jetë afektiv vetëm nëse 80% e njerëzve që kanë celularë e përdorin aplikacionin, apo 56% e popullatës së përgjithshme. Anketat e para sugjerojnë që afërsisht tre e katërta e popullsisë në shtetet si Mbretëria e Bashkuar, Franca, Italia dhe Gjermania do të bënin atë, megjithëse në disa vende njerëzit do ta përdornin më tepër se vendet e tjera.

Ishin të ndara opinionet e mjekëve të përgjithshëm të Maqedonisë së Veriut në lidhje me përdorimin e telemjekësisë gjatë pandemisë Covid-19.

Pothuajse 44 për qind menduan se telemjekësia post-Covid-19 duhet të vazhdojë, si dhe duhet të praktikohen orët ditore për konsultime telefonike. 14 për qind u përgjigjën se kishin përdorë telefona dhe kompjuterë në të kaluarën për të komunikuar me pacientët e tyre. Megjithatë, një grup mjaft i madh prej 42 për qind të mjekëve të përgjithshëm besonin se mjeku duhet të ekzaminojë pacientin personalisht.





## 6. PËRGJIGJE ME POLITIKA DHE REKOMANDIME

Edhe pse fëmijët nuk janë në ballë të pandemisë nga perspektiva e shëndetit, ata nuk kanë të drejta të barabarta sa i përket përballimit të efekteve socio-ekonomike nga Kovid-19. Pandemia i ka acaruar dobësitë në lidhje me burimet e prindërve/amvisërive dhe cilësinë e mjedisit shtëpiak, të cilat krijojnë një hendek të vazhdueshëm të mundësive midis fëmijëve me përparësi dhe të pengesa (OECD, 2019). Megjithatë, fokusi i politikave të menjëhershme duhet të vendoset në shëndetin e fëmijëve dhe mirëqenien psikologjike, si dhe mbështetjen e arsimit, me referencë të veçantë të fëmijët që janë lënë akoma edhe më shumë

pas dore. Pandemia e ka rritur barrën e rreziqeve të bartura nga fëmijët jetojnë në amvisëri me të ardhura të ulëta të cilat përballen me cenueshmërinë nga burime të ndryshme, prindërit e të cilëve kanë nivel të ulët të arsimit dhe që jetojnë në amvisëri me shumë fëmijë si dhe ambientit shtëpiak të të cilëve i mungon qasja në shërbime, përfshirë internetin, kushte këto që mund ta sfidojnë procesin mësimor. Një reagim me politika të këtilla do të siguronte një parandalim të rënies në varfëri të skajshme dhe përkeqësimin të pabarazive, që është shumë e rëndësishme në për të mos penguar përmirësimet sociale ndër breza.

## 6.1. MBËSHTETJA E FËMIJËVE DHE PRINDËRVE NË NEVOJË

Mbyllja ka rezultuar në pengesa gjatë ofrimit të shërbimeve për fëmijët dhe familjet si dhe ka përkeqësuar kualitetin e kujdesit të dhënë. Të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara, fëmijëve pa prindër, fëmijët viktimë të dhunës familjare si përdorues të shërbimeve të qendrave të kujdesit ditor, familjeve kujdestare të fëmijëve pa prindër, strehimoreve për viktimë të dhunës familjare, asistencë personale etj., duhet të mundësohen sistematikisht në situata ku kontakti fizik është i pamundur. Ky sistematizim i standardeve të kujdesit gjatë periudhës së mungesës së kontaktit fizik/pranisë duhet së pari t'u sjellë dobi fëmijëve dhe familjeve të tyre, duke treguar elementet kryesore për të mirëmbajtur cilësinë e kujdesit që jepet. Këta standarde duhet të jenë të unifikuara dhe sinkronizuara mes ofruesve të ndryshëm të shërbimeve sociale me qëllim që të parandalohen hendeqet në standarde e kujdesit në shërbimet e ndryshme sociale për fëmijë.

**Rekomandim:**  
Adoptoni një Protokoll për Sigurim të Shërbim Social gjatë kontaktit fizik / lëvizjes së kufizuar fizike.

Dëshmi për adoptim të kriterëve në një protokoll të këtillë duhet të bëhet e obligueshme nga MPMS-ja për të gjithë ofruesit e shërbimeve sociale që aplikojnë apo që aplikojnë për së dyti here për sigurim të shërbimit social.

Sigurimi i shërbimeve mbështetëse nga Qendrat për punë sociale (QPS) për grupet e veçanta të fëmijëve, siç janë fëmijët nga prindërit e ndarë, fëmijëve pa prindër, fëmijëve pa strehë të drejtat e të cilëve kanë qenë të sfiduara gjatë mbylljes nga virusi, duhet të adresohen sa duhet në fazën e radhës së pandemisë. MPMS-ja duhet të angazhohet në koordinimin e sigurimit të shërbimeve sociale “në kohë krizash” mes nivelesh të ndryshme të qeverisjes si dhe mes ofruesve të ndryshëm të shërbimeve sociale (privat, OJQ-të, donatorët etj.). Duhet të vendoset një trup i veçantë i cili do të hartonte standarde për sigurim të punës sociale gjatë krizës. MPMS-ja duhet gjithashtu të urdhërojë trajnime të obligueshme në lidhje me teknologjitë digjitale për të gjithë profesionistët e qendrave të punës sociale (QPS) si dhe për ofruesit e kujdesit social.

**Rekomandim:**  
Krijoni një trup koordinues për përgjigje të menjëhershme me punë sociale ndaj krizave me përfaqësues të MPMS-së, QPS-së, komunave dhe ofruesit privat të shërbimeve.

Kemi diskutuar dhe kemi dhënë vlerësim se Kovid-19 rrezikon ndikim negativ në ekonomi, duke rezultuar kështu në rritje të varfërisë, sidomos mes fëmijëve. Për t'i zbutur efektet e të ardhurave në amvisëri, Qeveria e Maqedonisë së Veriut ndërmoi masa të veçanta për të mbështetur kompanitë që ka vështirësi; për të kufizuar humbjet e të ardhurave te kategoritë e ndryshme të individëve (të punësuarit, të papunët, pranuesit e asistencës minimale të përgjithshme) të cilët u përballen me humbje të punës, ulje të orëve të punës apo ulje të çfarëdo të hyrash; dhe për të vazhduar pushimin shkaku i sëmundjes mes një grupi të punëtorëve që kanë përgjegjësi kujdesi. Siç kemi treguar (veçanërisht shihni Tabelën 7), këta veprime u dëshmuar si shumë vendimtare në zbutjen e varfërisë së madhe të fëmijët, për shkak se punësimi i prindërve mbetet mbrojtja më e suksesshme kundër varfërisë.

Masat për të mbështetur mbajtjen e vendeve të punës- më së shumti masa për subvencionimin e pagave deri në 14,500 denarë për muajt prill deri në qershor të vitit 2020- janë pranuar mirë dhe modeli i tyre mund të konsiderohet i përshtatshëm. Edhe pse, siç është argumentuar në Pjesën 2, efekti i tyre është i kufizuar dhe pa dashje shkon në favor të fëmijëve, masa të tilla janë thelbësore për ruajtjen

e të ardhurave të amvisërive në nivelin e minimumit të pranueshëm për të mbështetur jetesën, pra, drejtpërsëdrejti shumë të dobishëm për zbutjen e varfërisë së fëmijëve. Këto masa mund të plotësohen me masa të tjera për punë fleksibile dhe punë nga shtëpia. Megjithatë, puna nga shtëpia nuk mund të konsiderohet si opsion për pjesën më të madhe të ekonomisë së Maqedonisë së Veriut, veçanërisht në sektorin tradicional, si tekstili dhe bujqësia, ku kërkesa për fuqi punëtore dominon. Puna nga shtëpia dhe puna me fleksibilitet mund të kenë rreziqet e veta për prindërit e fëmijëve të vegjël dhe prindërit e vetëm të cilët përballen me nevojat e kujdesit (ndaj fëmijëve) gjatë orëve të punës, dhe kështu të ndikojnë në produktivitetin dhe kënaqësinë e punëdhënësit. Megjithatë, pandemia me të drejtë e vë lartë në agjendë çështjen e punës nga shtëpia dhe punën me orar fleksibil, e cila vërtetë përshtatet në punën e papërfunduar më parë që kishte të bëjë me hartimin e kodit të ri të punës në Maqedoninë e Veriut.

**Rekomandim:**  
**Në finalizimin e Kodit të ri të Punës, (ri) konsideroni mundësinë për punë nga shtëpia dhe punën me orar fleksibil që gjithashtu t'u përshtatet situatave si ajo e imponuar nga pandemia.**

Qeveria e Maqedonisë së Veriut ngjashëm e vazhdoi mundësinë për vazhdim të pushimit të paguar nga punëdhënësi, për prindërit e fëmijëve të moshës deri 10 vjeç të cilët kishin mbetur pa kujdes shkaku i mbylljes së objekteve parashkollore dhe shkollore. Këto masa janë planifikuar të mbeten derisa gjendja e jashtëzakonshme është në fuqi, por ngarkesa mund të bëhet edhe më e madhe nëse objektet parashkollore nuk hapen përsëri kur të mbarojë gjendja e jashtëzakonshme (që nuk është rasti me shkollat sepse ata ashtu do të ishin mbyllur në fund të vitit shkollor). Kjo gjithashtu e rihap çështjen se kush do t'i përballojë shpenzimet për pushimin e zgjatur të prindërve, veçanërisht duke marrë parasysh që rregullorja aktuale e vë këtë ngarkesë te punëdhënësit deri në 30 ditë pushim pas së cilës e merr qeveria. Sugjerohet që nëse perioda e pushimit për përkujdesje prindërore si shkak i Kovid-19 zgjerohet edhe jashtë gjendjes së jashtëzakonshme, atëherë qeveria ndërhyr duke marrë barrën e mbulimit të pushimit të paguar. Kjo çështje do të përsëritet nëse vendi përballet me një valë të dytë të pandemisë në vjeshtë duke shkaktuar mbylljen e mëtejshme të shkollave.

**Rekomandim:**  
**Vëni në konsideratë hartimin e një mase të ardhshme e cila**

**do të mbulojë koston (apo një pjese të saj) e pushimit të paguar të prindit për përkujdesje ndaj fëmijës shkaku i Kovid-19; apo zgjatni skemën e subvencioneve për kompanitë që do të zëvendësojnë punëtorin gjatë pushimit të tij/saj gjatë pushimit e pagesë; apo bëni adaptim fizik të objekteve parashkollore dhe shkollore (klasa 1 - 4) me qëllim të rihapjes në shator edhe në rast se rreziqet ndaj shëndetit të mos jenë larguar në atë kohë. risks are not deemed sufficiently curbed at that time.**

Siç u përmend në seksionin 3.1, fëmijëve në objektet parashkollore që vijnë nga familje me një prind, si dhe fëmijëve të tjerë nga familje të cenueshme u janë mundësuar pagesa të ulura apo qasje pa pagesë në çerdhe, përfshirë edhe ushqim pa pagesë. Gjithashtu, kostot e ushqimeve në shkollat fillore për fëmijët që janë pranues të asistencës minimale të përgjithshme i mbulon komuna. Mbyllja s shkollave gjatë pandemisë i ka futur fëmijët dhe amvisëritë në një rrezik më të madh të mungesës së ushqimit.

**Rekomandim:**  
**Vazhdoni të drejtën për ushqim në shkollë për fëmijët e varfër gjatë periudhës së zgjatjes së mbylljes së shkollave.**

Një dispozitë e këtillë duhet të pasqyrohet në Ligjet përkatëse (e që janë Ligji për Mbrojtjen Sociale, Ligji për Mbrojtjen e Fëmijëve, Ligji për Arsimin Fillor), dhe të funksionalizohet nga komunitat dhe shkollat. E drejta duhet të përfshijë një politikë sistematike afatgjatë, sesa mbështetje të tipit të projekteve ose ndihmave humanitare gjatë krizës. Përvojat nëpër botë na mësojnë strategji të ndryshme në këtë aspekt. Stacione ushqimesh “merr dhe shko”, dërgesa ushqimesh në vendet e ndalesës së autobusëve të shkollës apo në shtëpitë e fëmijëve, partneriteti publik-privat në zonat rurale që ofrojnë pako ushqimore të qëndrueshme janë masa të ndryshme që janë përdorur për fëmijët me të ardhura të ulëta gjatë Kovid-19 në SHBA (Dunn et al. 2020), derisa në Mbretërinë e Bashkuar, vauçerët për ushqim prej £15 kanë qenë të ndara nga shkollat për familjet të cilat i plotësonin kushtet për ushqime nga shkolla.

## 6.2. FORCIMI I PËRPJEKJEVE PËR TË LUFTUAR VARFËRINË TE FËMIJËT

Pavarësisht nga cenueshmëria dhe sfidat e mëdha të shkaktuara nga pandemia Kovid-19, kriza hapi mundësi për të diskutuar mbi mekanizmat për mbështetje më të gatshme sociale dhe mbrojtëse ndaj fëmijëve gjatë kohërave të rreziqeve të rritura dhe të zgjatura sociale dhe ekonomike. Reformat e ndërmarra sociale në Maqedoninë e Veriut më 2019 mundësuan një bazë dhe përgatitje të sistemit të mbrojtjes sociale dhe fëmijëve. Hapën shtesat për fëmijë për më shumë kategori të cenueshme, e zgjeruan mbështetjen duke dhënë shtesa për shkollë dhe krijuan trajtim më të barabartë mes amvisërive të ndryshme në nevojë (Gerovska-Mitev and Carraro, 2019). Megjithatë, kriza dëshmoi se më shumë amvisëri me fëmijë kanë nevojë për mbështetje, sidomos në kushte ku objektet shkollore janë të mbyllura.

Qeveria e Maqedonisë së Veriut i lehtësoi kriteret për të marrë një asistencë të garantuar minimale, që përfshiu një komponentë të nënkuptuar për të mbrojtur edhe ato amvisëri që pranojnë të ardhura joformale. Detyrimet pa këmbëngulje në përmbushje, kërkesat e thjeshtësuara administrative, metodat e larmishme të komunikimit me klientët, duhet të bëhen një



normë e re dhe të vazhdojë pas krizës. Logjika pas masave të mbrojtjes sociale dhe fëmijëve në Maqedoninë e Veriut ka qenë shmangja e mashtrimit, keqpërdorimit dhe varësisë midis klientëve për një kohë të gjatë. Kriza aktuale ofron një mundësi për të zëvendësuar një logjikë të këtillë me substancën e saj themelore të parandalimit të rrezikut, mbrojtjes së rrezikut dhe një mbulim më universal të fëmijëve dhe amvisërive të cenueshme, që e kanë nxitur përgjigjen e qeverisë ndaj krizës

**Rekomandim:**

**Propozoni një prag të dytë për shtesë fëmijërore për ato amvisëri që kanë tre apo më shumë fëmijë dhe përshtatni çdo kusht që lidhet me posedimin e pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme, dhe lidhur me kohëzgjatjen e masës, me amendamentet / ndryshimet në Ligjin për Mbrojtje Sociale të miratuara në mars të vitit 2020.**

**Ne propozojmë këtë prag të dytë si vijon (ndërhyrje në nenin 31 të Ligjit për Mbrojtje të Fëmijëve):**

së shkaktuar nga Kovid-19. Derisa kemi dhënë dëshmi, në seksionin 3.3., që kjo lëvizje politike ka qenë e dobishme për fëmijët, dhe kryesisht për ata që jetojnë në familje të varfra, edhe pse nuk i pasur për qëllim fëmijët. Kjo do të thotë se nuk është bërë ndonjë ndryshim i veçantë që ka për qëllim të zgjerojë qasjen e fëmijëve të paratë, përfshirë mungesën e lehtësimit e kriterëve të të ardhurave dhe pronave që kanë të bëjnë me shtesat e fëmijëve. Ne rekomandojmë ndonjë lëvizje në këtë drejtim.

**- 1,000 denarë për një fëmijë të moshës shkollare; 1,600 denarë për dy fëmijë; 2,000 denarë për tre apo më tepër fëmijë;**

**- 1,200 denarë për një fëmijë të moshës parashkollare; 1,900 MKD denarë për dy fëmijë; 2,400 denarë për tre apo më tepër fëmijë;**

**- 1,600 denarë për dy fëmijë të moshës parashkollare; 2,000 MKD për tre apo më shumë fëmijë të moshës parashkollare.**

**Pasi efektet e Kovid-19 kanë qenë më të mëdha, një dispozitë më të veçantë mund të propozohet për vajza.**



**Tabela 15:** Harxhimet vjetore të planifikuara dhe të plotësuara për shtesat fëmijërore

	Harxhimet e planifikuara për 2019	Harxhimet e simuluar bazuar në rregullat e 2020	Harxhimet e simuluar me kriteret e lehtësuara	Fonde shtesë që nevojiten shkak i Kovid-19
Shtesa për fëmijë (milion denarë)	872.5	702	931	228.9

*Burimi: Kalkulimet e autorit dhe MPMS-së.*

**Tabela 16:** Harxhimet të mundshme vjetore si plotësim i dispozitave për shtesë fëmijërore, sipas numrit të fëmijëve për amvisëri

Numri i fëmijëve në amvisëri	Pjesa e amvisërive	Fonde shtesë për ndryshim të rregullores (mil. denarë)	Ndarja në total i fondeve shtesë
0	62.4%	0	0.0%
1	17.0%	28.9	12.6%
2	14.2%	40.3	17.6%
3	4.5%	108.6	47.4%
4 ose më tepër	1.9%	51.1	22.3%
<b>Totali</b>	<b>100%</b>	<b>228.9</b>	<b>100%</b>

*Burimi: Kalkulimet e autorit.*

**Tabela 15** demonstroi që ndërhyrje e këtyre në rregullore mund të kërkojë edhe 3.7 milion euro shtese për çdo vit, prej të cilave një pjesë është nga rritja e shtesës për fëmijë për rastet me tre ose më tepër fëmijë, ndërsa një pjesë tjetër nga lehtësimi i kriterëve të lidhura me pasuritë si rezultat i të ardhurave të zvogëluara të amvisërive për shkak të Kovid-19. Distribucioni i këtyre fondeve shtesë mes amvisërive bazuar në numrin e fëmijëve është dhënë në Tabelën 16. Tabela sugjeron që ndërhyrja në rregullore është mjaft pro amvisërive me më shumë fëmijë, për shkak se fondet shtesë janë

më të larta në amvisëritë me tre (47.4 për qind) dhe katër fëmijë (22.3 për qind). Një ndërhyrje e tillë zbut më tej efektin që Kovid-19 ushtron mbi fëmijët e varfër, siç vërtetohet nga shifrat e simuluar në **Tabelën 17**. Tabela përbehet nga katër karakteristika që ne i përmendëm në Tabelën 8 dhe Tabelën 9. Efekti i rregullores – nëse janë shtesa të paspecifikuara në bazë gjinore – zvogëlon varfërinë për të dy gjinitë por më shumë për djemtë, derisa funksionon kryesisht njëjtë për të gjitha moshat. Ndërhyrja zvogëlon sadopak shkallën e varfërisë absolute të fëmijëve në linjën e të ardhurave të mesme

**Tabela 17:** Simulimi i strukturës së varfërisë pas Kovid-19, zbutja së masave për shtesë fëmijërore

	Gjinia		Mosha		
	Femër	0-5	0-5	6-14	15-17
	<b>Krahaso me Tabelën 8</b>				
<b>Varfëri relative (nën 60% e të ardhurave mesatare)</b>		33.4%	31.0%	31.6%	37.8%
<b>Varfëri absolute (nën pragun e të ardhurave shumë të ulëta)</b>	2.2%	2.5%	1.3%	2.9%	1.8%
<b>Varfëri absolute (nën pragun e të ardhurave të mesme të sipërme)</b>	10.8%	11.6%	9.4%	12.3%	12.0%
	<b>Numri i fëmijëve në amvisëri</b>		<b>Mesatarja e arsimimit të të rriturve</b>		
	2 apo më pak	3 apo më shumë	Filloren ose më pak	Të mesmen	Të lartë ose më tepër
	<b>Krahaso me Tabelën 9</b>				
<b>Varfëri relative (nën 60% e të ardhurave mesatare)</b>		49.4%	70.1%	31.9%	0.9%
<b>Varfëri absolute (nën pragun e të ardhurave shumë të ulëta)</b>	1.1%	4.8%	7.3%	2.0%	0.0%
<b>Varfëri absolute (nën pragun e të ardhurave të mesme të sipërme)</b>	8.4%	17.0%	29.3%	9.8%	0.0%
<i>Burimi: Kalkulimet e autorit.</i>					

më të larta, në rastet e amvisërive me tre ose më shumë fëmijë. Kjo është e pritshme duke pasur parasysh që pragu i dytë shtesës u propozua për të synuar më shumë amvisëritë e tilla. Meqenëse kjo gjendje ndoshta lidhet me mbizotërim e arsimimit të ulët të anëtarëve të rritur në amvisëri, niveli i varfërisë absolute zvogëlohet gjithashtu brenda këtij grupi.

Një opsion afatgjatë që mund të konsiderohet – kur efektet e Kovid-19 dobësohen – mund të përfshijë një propozim të një garancie universale të fëmijëve (GUF), duke tërhequr të hyrat aktuale dhe kushtëzimet në bazë të pronës për shtesa fëmijërore, dhe për pranuesit e asistencës minimale të përgjithshme zgjerim të shtesës fëmijërore

**Tabela 18:** Harxhimet vjetore të simuluar dhe shtesë që nevojiten për prezantimin e garancisë universale të fëmijëve (GUF)

	Harxhimet e planifikuara për 2019	Harxhimet e simuluar bazuar në rregullat e 2020	Harxhimet e simuluar me GUF	Fonde shtesë që nevojiten për shkak të GUF-së
<b>Shtesa për fëmijë (milion denarë)</b>	872.5	702	4,048	3,346.3
<i>Burimi: Kalkulimet e autorit dhe MPMS-së.</i>				

**Tabela 19:** Reduktimi i sasisë së shërbimeve sipas llojit të kujdesit shëndetësor, llojit të pronësisë së ofruesit (të shërbimeve) dhe moshës

Numri i fëmijëve në amvisëri	Pjesa e amvisërive	Fonde shtesë për ndryshim të rregullores (mil. denarë)	Ndarja në total i fondeve shtesë
<b>0</b>	62.4%	0	0.0%
<b>1</b>	17.0%	1,654.9	49.5%
<b>2</b>	14.2%	1,112.1	33.2%
<b>3</b>	4.5%	400.8	12.0%
<b>4 ose më tepër</b>	1.9%	178.5	5.3%
<b>Totali</b>	<b>100%</b>	<b>3,346.3</b>	<b>100%</b>
<i>Burimi: Kalkulimet e autorit.</i>			

derisa të mbarojë asistencën (përfshirë edhe subvencionimin e energjisë), kështu shtesa për arsimim dhe shtesa për fëmijë arrin nivelin e një rroge minimale. Një orvatje e tillë duhet të kombinohet me ndërhyrje brenda sistemit të taksave për të qenë në gjendje të mobilizohen fonde për financimin e tij. Shihni diskutimin në **Kutinë 4**. Kjo është veçanërisht e rëndësishme pasi kostoja e saj fillestare diferenciale vlerësohet diku rreth 54.4 milion euro

(Tabela 18). Universaliteti nënkupton që shpërndarja e fondeve shtesë është mjaft proporcionale kur krahasohet me pjesën e amvisërive sipas numrit të fëmijëve (**Tabela 19**).

GUF do të rezultojë me ulje më të thellë të varfërisë së fëmijëve (**Tabela 20**). Skema e kështillë jo vetëm që do të parandalojë efektet negative të Covid-19 por edhe do të reduktojë shifrat e varfërisë përgjatë të gjitha linjave krahasuar me nivelet para Covid-19.

**Tabela 20:** Simulimet e varfërisë së garancisë universale të fëmijëve pas Covid-19

	Gjinia		Moshë		
	Mashkull	Femër	0-5	6-14	15-17
	<b>Krahaso me Tabelën 8</b>				
<b>Varfëri relative (nën 60% e të ardhurave mesatare)</b>		30.4%	27.1%	28.0%	36.1%
<b>Varfëri absolute (nën pragun e të ardhurave shumë të ulëta)</b>	2.2%	2.0%	1.1%	2.8%	2.1%
<b>Varfëri absolute (nën pragun e të ardhurave të mesme të sipërme)</b>	8.0%	9.9%	7.8%	10.1%	8.4%
	Numri i fëmijëve në amvisëri		Mesatarja e arsimimit të të rriturve		
	2 apo më pak	3 apo më shumë	Filloren ose më pak	Të mesmen	Të lartë ose më tepër
	<b>Krahaso me Tabelën 9</b>				
<b>Varfëri relative (nën 60% e të ardhurave mesatare)</b>		45.6%	61.9%	28.9%	0.9%
<b>Varfëri absolute (nën pragun e të ardhurave shumë të ulëta)</b>	0.8%	4.7%	6.2%	1.8%	0.0%
<b>Varfëri absolute (nën pragun e të ardhurave të mesme të sipërme)</b>	5.3%	16.2%	19.5%	7.2%	0.0%
<i>Burimi: Kalkulimet e autorit.</i>					


Qeveria mund të konsiderojë mundësi të tjera politikash me qëllim mbrojtjen e familjeve. Këto mund të përfshijnë, për shembull, subvencione që jepen përnjëherë për kostot e shërbimeve, përfshirë kostot e qirasë, për ata që mund të dëshmojnë se të ardhurat e tyre të amvisërisë kanë rënë për më shumë se 60 për qind gjatë prillit dhe majit të 2020, në krahasim me mesataren

e 2019, dhe të cilët janë akoma mbi pragjet e ndihmës minimale të garantuar.

#### **BOX 4: UNIVERSAL CHILD GUARANTEE (UCG) AS A LONG-TERM OPTION**

At the European Union (EU) level, the initiative for a child guarantee called for by the European Parliament in 2015, seeks to “ensure that every child in Europe at risk of poverty or social exclusion has access to: free healthcare, free education, free early childhood education and care, decent housing and adequate nutrition.” Frazer, Guio and Marlier (2020) explored the child guarantee and provided arguments for its added value for the children living in precarious family situations; children residing in institutions; children of recent migrants and refugees; as well as children with disabilities and other children with special needs.

At the level of EU member states, Austria, Estonia, Finland, Lithuania and Germany have implemented a universal child benefit. In 2018 in Lithuania, it replaced the child tax allowance by providing a benefit paid to all children from birth until the age of 18, and until 21 for those following a general education program. Estimates found that such a policy would have the largest effect on poverty among families with three or more children, though that it will also reduce the risk of poverty within the 0-17 age group, as well as among the single-parent families (Lazutka, Poviliunas and Zalimiene, 2019).



### 6.3. SIGURIMI I VAZHDIMIT TË PROCESIT MËSIMOR

Qeveria nxiti një reagim disi të shpejtë, megjithëse të pa balancuar të sistemit arsimor për mbyllje fizike të shkollave dhe institucioneve parashkollore. Përgjigja më e mirë e mundshme dhe afatgjate është që të mendohet përsëri nga aspekti i planifikimit, implementimit dhe vlerësimit të mësimin digjital/në distancë. Kjo duhet të përfshijë krijimin e një platforme digjitale që do të ngërthen funksione të ndryshme që do t'i ofronin mbështetje mësimdhënies dhe mësimnxënies. Kjo nënkupton një sistem të integruar që do të mundësonte mbështetje për të gjithë fëmijët dhe nxënësit pa marrë parasysh aftësitë, gjendjen socio-ekonomike dhe moshën e tyre.

**Rekomandime:**  
**Adaptoni kornizën ligjore dhe adoptoni një strategji për mësim në distancë dhe mësimdhënie online. Bëni përgatitjet për përdorim të teknologjisë në shtëpi. Bëni një plan për përdorim të laptopëve apo tabletave**

**të cilat fëmijët dhe stafi mësimdhënës mund t'i huazojnë nga shkollat apo institucionet e tjera publike dhe që mund t'i shfrytëzojnë në shtëpi me qëllim të përfshihen në mësimin digjital/në distancë. Forconi kapacitetet sistemore për menaxhimin e të dhënave dhe përdoruesve veçanërisht brenda sistemit EMIS.**

Korniza e re/rregulluar ligjore duhet të mundësojë një bazë të gjerë mbi të cilën aktivitete të veçanta mund të vendosen dhe duhet të mundësojë fleksibilitet të mjaftueshëm për veprime në të ardhmen dhe adaptime në rrethana të veçanta. Strategjia për mësim digjital/në distancë mund të përfshijë përdorimin e mësimin digjital brenda kurikulës së rregullt dhe të mundësojë një plan veprimi për implementim me afate të qarta dhe këshilla për implementim për të gjithë ata që janë të përfshirë. Strategjia gjithashtu duhet të lë vend edhe për 'mësimin e përzier' – një kombinim i mësimin digjital dhe atij fizik/tradicional, dhe në të cilën mësimi ndahet mes shkollës/çerdhës dhe shtëpisë.

**Rekomandim:**  
**Krijoni hapësira të sigurt  
brenda shkollave dhe  
objekteve parashkollore,  
të pajisura me teknologji  
të nevojshme për mësim  
digjital/në distancë.**

Këto hapësira mund të përdoren si nga mësuesit ashtu edhe nga nxënësit për t'ç pasur qasje në materialet shkollore, platformat mësimore dhe të komunikojnë me njëri tjetrin në situata të qasjes së kufizuar në teknologji në shtëpi. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet teknologjive ndihmuese brenda këtyre hapësirave. Në nivelin parashkollor, hapësira të këtilla mund të funksionojnë edhe gjatë gjendjes së jashtëzakonshme, që mund të sigurojnë mbështetje për familjet që kanë nevojë për kujdes urgjent për fëmijët. Ato gjithashtu mund të shërbejnë si qendra këshilluese dhe burime për materiale për t'i ndihmuar prindërit të stimulojnë mësimin e hershëm të fëmijët.

**Rekomandime:**  
**Jepuni mësuesve  
mundësi për zhvillim  
profesional në aspektin  
e integritit të mësimin  
digjital brenda orëve**

**të rëndomta si  
dhe në rrethana të  
jashtëzakonshme.  
Mundësoni mbështetje  
të vazhdueshme  
ndaj mësuesve në  
implementimin e  
mësimin digjital.  
Përgatitni një plan për  
mësimin korrigjues që  
do të duhet kur nxënësit  
të kthehen me prezencë  
fizike nëpër shkolla.  
Mendoni përsëri  
kurikulën dhe planet  
mësimore me  
qëllim që t'u jepni  
mësimdhënësve më  
shumë fleksibilitet nga  
aspekti i implementimit.**

Kurikula e rregulluar mund të nxjerr në pah rezultatet e të nxënësve dhe ndërtimin e aftësive kritike sesa materialin e mbuluar në mësimdhënie. Derisa shëndeti emocional dhe ai mendor po bëhen gjithnjë e më të rëndësishme, kurikula mund të integrojë edhe tema për shëndetësi dhe mirëqenie. Kjo do të sigurojë, ndër të tjera, që nxënësit dhe prindërit të jenë të mbështetur gjatë mësimin në ambientet e shtëpisë sa i përket shëndetit mendor. Kjo mund të marrë



formën e materialeve që postohen në internet ose grupet lokale për mbështetje që po organizohen.


**Rekomandime:**

**Bëni një databazë të fëmijëve që janë të cenusshëm në nivel shkollë.**

**Përgatitni një plan për asistencë arsimore për ata që kanë nevojë kur shkollat rihapen, si për shembull fëmijët që janë në rrezik të lënies së shkollës, apo atyre që po kalojnë në një nivel tjetër të arsimit. Përfshini shërbimet lokale për mbrojtjen e fëmijëve dhe shërbimet e mbrojtjes sociale në përgatitjen e këtyre planeve.**

Databaza mund të përfshijë informacione në lidhje me gjendjen socio-ekonomike të fëmijëve si dhe të dhëna në lidhje me mundësitë e mbështetjes së prindërve dhe udhëzime. Të dhënat duhet të mbahen të fshehta dhe të përdoren vetëm qëllime të ndihmesës së mësimi dhe për të ndihmuar arritjen e fëmijës në të gjitha rrethanat. Të dhënat duhet rregullisht të përditësohen me të dhënat

e përcjelljes në lidhje me përparimin dhe arritjen e nxënësve derisa ata lëvizin lartë nga niveli parashkollor përmes arsimit fillor në atë të mesëm. Të dhënat e tilla do të ndihmonin që shkollat të identifikonin nxënësit dhe prindërit që kanë nevojë për mbështetje të shpejtë për shkak se rrethanat e tyre ndryshojnë (kalimi në varfëri, ose për shkak të ndonjë vdekjeje). Të dhënat gjithashtu do të ishin shumë të dobishme kur do t'u grumbullonin në nivel kombëtar, e që do të ishin të dobishme për të ndikuar përgjigjet me politika që do të synonin grupet që rrezikojnë të mos funksionojnë, siç janë fëmijët romë.



#### 6.4. ZBUTJA E PROBLEMEVE SHËNDETËSORE TË RËNDËSISHME PËR FËMIJËT

Ne identifikuar një hendek mes shërbimeve shëndetësore të duhura dhe ato të mundësuar nga popullata gjatë shpërthimit të Kovid-19. Megjithatë, reduktimi ka qenë pak më i ulët sa i përket shërbimeve që u janë dhënë fëmijëve, e cila, në rrethanat aktuale, mund të konsiderohet si pozitive. Prapë se prapë, rreziku i reduktimit të dhënies së kujdesit shëndetësor është ende kanosës. Pandemia aktuale solli përsëri në vëmendje burimet e pakta njerëzore, veçanërisht atyre të epidemiologëve dhe specialistëve të sëmundjeve infektive dhe stafit mbështetës (infirmierë, teknikë laboratorësh) në vend. Zhvillime të këtyra mund të kenë efekte në zhvillimin aktual të fëmijëve, por gjithashtu të ndikojnë në ndryshimet afatgjate fiziologjike, psikologjike dhe epigjenetike që ndodhin në mitër dhe gjatë zhvillimit të hershëm. Efekte të tilla afatgjate të pandemisë mund të bashkohen me rreziqet e krizës së vazhdueshme ekonomike dhe me rritjen e pabarazive përtej izolimit dhe mbylljes.

Pavarësisht përpjekjes para Kovid-19 të autoriteteve në Maqedoninë e Veriut që të përmirësojnë shëndetin e fëmijëve dhe atë të nënave shtatzëna dhe nënave me foshnja të porsalindura, pandemia megjithatë Kovid-19 krijoi pengesa në aspektin e mungesës/reduktimit të stafit profesional. Këto rekomandime mund t'i minimizojnë efektet e jashtme negative të pandemisë ndaj fëmijëve.

#### *Rekomandime:*

**Menaxhimi i krizës shëndetësore dhe ekonomike shkaku i Kovid-19 duhet të ndodhë në të njëjtën kohë. Qeveria duhet të adoptojë menjëherë një plan veprimi dhe të fillojë zbatimin e masave për përmirësimin e shëndetit të popullatës, i cili është përkeqësuar për shkak të mbylljes së sistemit shëndetësor.**

**Sigurimi i qasjes në kujdesin rutinor gjatë kujdesit para lindjeve dhe pas lindjeve si dhe shërbimeve parandaluese dhe mjekuese për fëmijë duhet të jetë prioritet.**

Ministria e Shëndetësisë duhet të koordinojë gjinekologët dhe mjekët pediatër në të gjitha nivelet e sistemit shëndetësor për t'u siguruar që nuk ka vonesa në lidhje me këto shërbime.

Ekziston një nevojë për të parandaluar vonesat në qasje të kujdesit spitalor dhe për të rritur sigurimin e një kujdesi të koordinuar me cilësi të lartë nga ofruesit e kujdesit shëndetësor. Ministria e Shëndetësisë duhet urgjentisht të mundësojë që popullata të fillojë të marrë të gjitha shërbimet shëndetësore të nevojshme në të gjitha qendrat shëndetësore, duke bërë kontrollet Kovid-19 para shtrimit në spital.

Duhet patjetër që të rritet ndërgjegjësimi mes prindërve se rreziqet nga vonesat në marrjen e kujdesit spitalor në gjendje urgjente mund të jenë shumë më të larta sesa ato të Kovid-19. Kampanjat publike mund të jenë efektive në edukimin dhe ndërgjegjësimin e prindërve.

Veprimet lehtësuese duhet të ndërmerren me qëllim mbështetjen e zhvillimit të hershëm të fëmijërisë dhe atë të mëvonshëm në fushën e shëndetit mendor për fëmijët si një paketë mbështetëse familjare. Ministria e Shëndetësisë duhet të theksojë politikat dhe veprimet në fushën e shëndetit mendor në periudhën e rimëkëmbjes pas Kovid-19.

Sapo të kalojë pandemia, vendi duhet të rifreskojë kërkesën për kujdes shëndetësor dhe vaksinim rutinor, si dhe të rritë kontrollet preventive të fëmijët me qëllim që të frenojë sa është e mundur rreziqet që vijnë nga anulimi i kujdesit shëndetësor gjatë periudhës së Kovid-19.

## 7. REFERENCAT

AECOM (2019) Тематска евалуација на ЕУ поддршката за ромските заедници и социјално мапирање на Ромите. Извештај за социјално мапирање. Скопје: AECOM International Development Europe SL.

Avissati, F., Echazarra, A., Givord, P. and Schwabe, M. (2019) [Results from PISA 2018 Country note North Macedonia](#).

Bogoevska, N., Bornarova, S, Gerovska-Mitev, M. (2019) Social Protection in Macedonia: Regulation and Practice (in Macedonian language), Skopje: Ministry of Labour and Social Policy.

Brooks, S.K., Webster, R.K., Smith, L.E. Woodland, L., Wessely, S., Greenberg, N. and Rubin, G.J. (2020) The Psychological Impact of Quarantine and How to Reduce It: Rapid Review of the Evidence. *The Lancet*, 395(10227), p. 912-920.

Byrne, K. (2020) An Analysis of the Situation of Women and Children in the Republic of North Macedonia: Executive Summary. Skopje: UNICEF.

Cerna, L. (2020) Coronavirus School Closures: What Do They Mean for Student Equity and Inclusion? *OECD Education and Skills Today*.

Dong, Y., X. Mo and Y. Hu (2020) Epidemiological Characteristics of 2143 Pediatric Patients with 2019 Coronavirus Disease in China. *Journal: Pediatrics Citation*.

Dorn, E., Hancock, B., Sarakatsannis, J. and Viruleg, A. (2020) Covid-19 and Student Learning in the United States: the Hurt That Could Last a Lifetime. Washington DC, McKinsey.

Elder Jr., G.H. (1999) *Children of the Great Depression: Social Change in Life Experience*. Westview Press.

European Commission (2018) Recommended Annual Instruction Time in Full-time Compulsory Education in Europe – 2017/18.

European Commission (2019) [North Macedonia 2019 Report](#).

[Finance Think \(2020\) The Quality of Life: “The Economic Effects of the Corona-Crisis”](#) [online]. Skopje: Finance Think. Issue 3. [Accessed 03 June 2020].

Frazer, H., Guio, A.C. and Marlier, E. (eds) (2020) Feasibility Study for a Child Guarantee: Final Report, Feasibility Study for a Child Guarantee (FSCG), Brussels: European Commission.

Gerovska Mitev, M. (2010) The Well-being of Children and Young People in Difficult Economic Times. Skopje: UNICEF.

Gerovska Mitev, M. (2020) Adaptation of Social and Child Protection Cash Benefits in North Macedonia in Response to Covid-19. ESPN Flash Report, Brussels: European Commission.

Gerovska Mitev, M. and Carraro, L. (2018) Child Poverty and Child Income Support: Reform Scenario in Macedonia. Paper presented at the International Workshop Addressing Inclusion among Children & Adolescents Living in Poverty: Progress towards Achieving the SDGs, organized by the Equity for Children of the New School, Comparative Research Programme on Poverty and SOS Children Villages International, 11-12 October 2018, New York: [link](#)

Gudbjartsson, D.F., Helgason, A., Jonnson, H., et al. (2020) Early Spread of SARS-CoV-2 in the Icelandic Population. medRxiv 2020.10.1101/2020.03.26.20044446.

Hollenweger, J. and Martinuzzi, A. (2015) Assessment of Capacity of Services Provided by Health, Education and Social Sectors for Inclusion of Children with Disabilities. Skopje: UNICEF.

ILO/EBRD (2020) Covid-19 and the World of Work. North Macedonia- Rapid Assessment of the Employment Impacts and Policy Responses. Geneva: International Labor Organization.

Inchley, J., Currie, D., Budisavljevic, S., Torsheim, T., Jåstad, A., Cosma, A., et al., (editors) (2020). Spotlight on Adolescent Health and Well-being. Findings from the 2017/2018 Health Behaviour in School-aged Children (HBSC) Survey in Europe and Canada: International Report. Volume 2: Key Data. Copenhagen: WHO Regional Office for Europe.

IPH (2019) Извештај за реализација на програмата за задолжителна имунизација на населението во Република Македонија во 2018 година. Скопје: Институт за јавно здравје.

Lazutka, R., Poviliunas, A. and Zalimiene, L. (2019) Lithuania Introduces a Universal Child Benefit to Tackle Child Poverty. ESPN Flash Report 2019/06, Brussels: European Commission.

Lazzerini, M., Barbi, E., Apicella, A., Marchetti, F., Cardinale, F. and Trobia, G. (2020) Delayed Access or Provision of Care in Italy Resulting from Fear of COVID-19. *The Lancet. Child and Adolescent Health*, 4(5), p.e10-e11.

McCarthy, A. (2020) [COVID-19 and Children](#) | Harvard Medical School (accessed on 08 June 2020).

Mickovska-Raleva, A., Tomovska Misoska, A., Hristova Zaevska, O., Cherepnalkovska, S. and Kostikj Ivanovikj, V. (2017) From Numbers to Practice – Identification and Analysis of the Indicators Related to the Quality of the Teaching Process in the Primary Education in Macedonia. Skopje: Finance Think Policy Study.

Milevska Kostova, N., Chichevalieva, S., Ponce, N.A., van Ginneken, E. and Winkelmann, J. (2017) The Former Yugoslav Republic of Macedonia Health System Review. *Health Systems in Transition*, 19(3), p.1-160.

Ministry of Finance (2020) Supplementary Budget of North Macedonia, 2020. Skopje, MF.

Motiejūnaitė-Schulmeister, A. and Crosier, D. (2020) [How Is COVID-19 Affecting Schools in Europe?](#)

OECD (2019) [Changing the Odds for Vulnerable Children: Building Opportunities and Resilience](#), OECD Publishing, Paris.

OECD (2019a) OECD Reviews of Evaluation and Assessment in Education: North Macedonia, OECD Reviews of Evaluation and Assessment in Education. Paris: OECD Publishing.

OECD (2019b) PISA 2018 Results (Volume II): Where All Students Can Succeed. Paris: OECD Publishing.

OECD (2019c) Program for International Student Assessment (PISA). Results from PISA 2018. Paris: OECD Publishing.

OECD (2020a) Combatting COVID-19's Effect on Children. OECD Publishing, Paris, [link](#).

OECD (2020b) COVID-19: Protecting People and Societies. Tackling the Coronavirus (COVID-19): Contributing to a Global Effort, OECD Publishing, Paris, [link](#).

OECD/ILO (2019) Tackling Vulnerability in the Informal Economy, Development Centre Studies, OECD Publishing, Paris, [link](#).

Ombudsman of the Republic of Macedonia (2016) Towards Inclusive Education: Report of the Conducted Research Regarding Inclusion of Children with Disabilities in Regular Primary Education. Skopje: UNICEF.

Parnardzieva-Zmejкова, M. & V. Dimkovski, (2018) Analysis of the Public Spending on Health Care of Children in the Country. Finance Think Policy Studies 2018-12/21, Finance Think- Economic Research and Policy Institute.

Petreski, B. and Petreski, M. (2018) Analysis of the Public Spending on Education and on Social Protection of Children in the Country. Finance Think Policy Study No. 20.

Petreski, M. (2020) Beyond Income Inequality in North Macedonia: An Overview. Finance Think Policy Studies 2020-04/27, Finance Think- Economic Research and Policy Institute.

Petreski, M. and Mojsoska-Blazevski, N. (2017) Overhaul of the Social Assistance System in Macedonia: Simulating the Effects of Introducing Guaranteed Minimum Income (GMI) scheme. Finance Think Policy Study No. 11.

Pew Research Center (2020) The Psychological Toll COVID-19 May be Taking on Americans”, Pew Research Center. Available [online](#), (accessed on 9 June 2020).

Reimers, F.M. and Schleier, A. (2020) A framework to Guide an Education Response to the COVID-19 Pandemic of 2020.

Resource Center for Parents of Children with Special Needs (n.d.) [Бариери за образовна инклузија на деца со посебни потреби: Извештај и анализа по спроведено истражување.](#)

Roberton, T., Carter, E.D., Chou, V.B., Stegmuller, A., Jackson, B.D., Tam, Y., Sawadogo-Lewis, T., Walker, N. (2020) Early Estimates of the Indirect Effects of the Coronavirus Pandemic on Maternal and Child Mortality in Low- and Middle-Income Countries. Available at SSRN: [link](#)

Saez, E. (2010) Do Taxpayers Bunch at Kink Points? American Economic Journal: Economic Policy, 2(3): 180–212.

[School Education Gateway \(2020\) Survey on Online and Distance Learning – Results.](#)



Shonkoff, J.P., Garner, A.S., Siegel, B.S., Dobbins, M.I., Earls, M.F., McGuinn, L., ... Wood, D. L. (2012) The Lifelong Effects of Early Childhood Adversity and Toxic Stress. *Pediatrics*, 129, p.e232– e246.

State Education Inspectorate (2014) Indicators for Quality of the School Work. Available at: [link](#).

State Statistical Office (2019) Social Welfare for Children, Juveniles and Adults in 2018, Skopje: State Statistical Office.

State Statistical Office (2020) Monthly Statistical Bulletin (May 2020 and June 2020 edition), Skopje: State Statistical Office.

Torche F. (2011) The effect of maternal stress on birth outcomes: exploiting a natural experiment. *Demography*, 48(4), p.1473-149.

UNDP (2018) [Roma at a glance: The Former Yugoslav Republic of Macedonia](#).

United Nations (2020) Policy Brief: [The Impact of COVID-19 on children](#).

Verity, R., Okell, L.C., Dorigatti, I., Winskill, P., Whittaker, C., Imai, N., Cuomo-Dannenburg, G., Thompson, H., Walker, P.G.T, Fu, H., Dighe, A., Griffin, J.T., Baguelin, M., Bhatia, S., Boonyasiri, A., Cori, A., Cucunubá, Z., FitzJohn, R., Gaythorpe, K., Green, W., Hamlet, A., Hinsley, W., Laydon, D., Nedjati-Gilani, G., Riley, S., van Elsland, S., Volz, E., Wang, H., Wang, Y., Xi, X., Donnelly, C.A., Ghani, A.C., Ferguson, N.M. (2020) Estimates of the severity of coronavirus disease 2019: a model-based analysis. *The Lancet Infectious Diseases*, 30, S1473-3099.

WHO (2019) European health for all database (HFA-DB) WHO/ Europe available at: [link](#).

WHO (2020a) COVID-19: Operational guidance for maintaining essential health services during an outbreak Interim guidance. Geneva: World Health Organization.

WHO (2020b) Guiding principles for immunization activities during the COVID-19 pandemic Interim guidance. Geneva: World Health Organization.

WHO (2020c) WHO report on health behaviors of 11–15-year-olds in Europe reveals more adolescents are reporting mental health concerns. Geneva: World Health Organization.

World Bank (2020) [Three principles to support teacher effectiveness during COVID-19.](#)

Yoshikawa, H., Wuermli, A.J., Britto, P.R., Dreyer, B., Leckman, J.F., Lye, S.J., Ponguta, L.A., Richter, L.M. and Stein, A. (2020) Effects of the Global COVID-19 Pandemic on Early Childhood Development: Short- and Long-Term Risks and Mitigating Program and Policy Actions. The Journal of Pediatrics, forthcoming.

Zimmermann, P. and N. Curtis (2020) Coronavirus Infections in Children Including COVID-19. The Pediatric Infectious Disease Journal, p. 1.

Организација за Економска Соработка и Развој (2019). Преглед на ОЕЦД за евалуацијата и оценувањето во образованието во Северна Македонија: оценка и препораки. Скопје: УНИЦЕФ, 2019.

